

**PELLUMB  
KULLA**

8JH-32

K 98

**Këshilla  
për  
fëmijë  
nga 5  
deri 55  
vjeç**

*Tregime e skica*



84H-32

K 98.

# Pëllumb Kulla

Këshilla  
për  
fëmijë  
nga 5  
deri 55  
vjeç



Tregime e skica

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## *Këshilla për fëmijët e moshave 5 deri 55 vjeç*

Kolegë e kolege kanë trajtuar nëpër leksione mirërritjen e fëmijëve që nga lindja e deri në moshën 5-vjeçare.

Këshillat që do të jap unë, kanë të bëjnë me kujdesin dhe mirërritjen e fëmijëve nga mosha 5 deri 55 vjeç!...

Fëmijët e moshave 5 deri 55 vjeç janë edhe më delikatë. Në këtë periudhë formohet karakteri, fillon klasa e parë, mbrohen diplomat... Në këto mosha fëmija përdor gjerësish fjalën, e zoteron fjalën, luan me fjalën, e ha fjalën (dhe s'i bën përshtypje), mëson fjalë të reja (dhe harron të vjetrat), e zgjeron fjalorin që nga fjala «babì» e deri te shprehja «plaç në vend!», të cilën ne duhet ta kuptojmë në tërë kuadrin e saj kompleks...

## Lodrat

Lodrat e fëmijëve të moshave 5 deri 55 vjeç janë të shumëllojshme. Fëmijët e këtyre moshave kanë qejf të lozin me kuaj druri, me top e shpata, kaladibrancë, shah dhe domino. Është thënë që deri në pesë vjeç fëmijët i kanë shumë për zemër kazmat dhe lopatat plastike. Më pas, kur rriten, disa fëmijë kazmat dhe lopatat e vërteta nuk i shohin dot me sy. Bëhen nervozë, i shtyjnë, përplasin këmbët dhe trokasin nëpër zyra...

Një bebe katërvjeçare, që qante kur ia shkullnin nga duart enët e kuzhinës, ato dhurata të dashura nga pakaja e Vtitit të Ri, njëzet vjet më vonë i lë pjatat stivë, të palara, në lavapjatë. Bebja, tani njëzetkatërvjeçare, nuk i do më këto lodra. Ua lë për t'i larë mamasë ose vjehrës, duke kujtar se këto lodra i kanë qejf ato...

Zbavitje për fëmijët bëhen shpesh dhe shëtitjet nëpër bulevarde. Për këto shëtitje fëmijët zakonisht përgatiten vetë përpara pasqyrës. Krihen me kujdes, lajnë dhëmbët dhe, sipas gjinisë, shkumosin e heqin mjekrat, ose heqin me piskatore vetullat e qumështit. Pastaj dalin e vërdallosen orë të tëra, duke parë majtas e djathtas për të gjetur shokun ose shoqen e zemrës, që janë lodrat më me telashe nga të tëra lodrat e tjera!

Po i shkrepi për këto lloj lodrash, fëmija humb gjumin, hutohet, rri afër dritares, nuk ka oreks, mban pasqyrë me vete e shikohet fshehu-

razi (si i dytë!), qan, grindet, psherëtin çdo tri minuta, rri vonë, shkruan letra, i gris, i shkruan prapë...

Ne njobim klinikisht rastin e një fëmije-vajzë, bebe. Ka njëzet e dy vjet që vazhdon zhirot, po lodrën e zemrës nuk po e gjen dot akoma!...

### *Sëmundjet që duan kujdes në këto moshë*

*Mosbindja:* Vjen një moshë kur fëmija nuk do të bindet. Kjo sëmundje bie në sy kur fëmija rri shtrirë, lexon a dëgjon radion dhe magnetofonin e nuk ngrihet të vejë, fjala vjen, në dyqan a të sjellë brenda drutë që ka shkarkuar makina. Në këtë rast këshillohet urtësi, dy-tri thirrje, pak ironi dhe thumba të lehtë. Edhe kur këto mbi foshnjën nuk bëjnë efekt, mjekësia botërore bashkohet në përfundimin që drutë, detyrimisht, do t'i futë brenda nëna e foshnjës, babai i foshnjës ose të dy së bashku...

*Rakitizmi:* Nëna shqetësohet kur fëmija nuk zë gjirin e nuk pi. Por po aq, bile më tepër, duhet të shqetësohet dhe kur fëmija pi... raki!...

Rakia, — po e shpjegojmë, se me siguri nga shumë lexues nuk njihet, — është një lëng pa ngjyrë, si ujë, kur e tund, mban zinxhir...

Me rritjen e fëmijës, dëshira për këtë lëng shtohet. Fëmijëve 50 apo 55-vjeçarë këtë lëng, nganjëherë ua gjen në xhepin e brendshëm, në disa shishe me dy faqe, që quhen faqore.

*Shenjat:* Kur pi, fëmija mban erë, mjegullon syrin, flet budallallëqe dhe e lë nënën pa gju-

më, si atëherë kur ishte lidhur kopanec e nuk pinte gji...

*Sëmundjet e zemrës:* Sëmundja më e rrezikshme është ajo që kap foshnjat e martuara, kur këto dëgjojnë vetëm ç'u thotë nusja. (Nusja është një nga ato lodra me telashe që përmendëm në kapitullin më lart.)

Kjo sëmundje shfaqet me shenja nervozizmi ndaj prindërve dhe me ledhatime të tepruara për nusen. Foshnja grindet... Nuk i pëlqen gjella e mamasë... Për lodrën e tij përdor fjalët «engjell», «zemër», «drita ime», (në varësi nga ndriçimi), «vdeksha për ty»... Dhe çdo muaj bën lutje përi strehim të veçantë, (dhomë e kuzhinë), që janë dy lodra të tjera, në një lagje më tej.

Sëmundja e këtyre fëmijëve zhvillohet deri atje, sa, pasi marrin shtëpi më vete, nuk çajnë më kokën për ata që ua bënë këtë kokë...! I lënë pa ndihma, nuk i pyesin për hallet që kanë dhe jorrallë lidhen kryekëput me ata që u kanë bërë kokën lodrave të tyre të preferuara, «engjëjve», «zemrave», «dritave», për të cilat «janë gati të vdesin». (Deri më sot raste vdekjesh nuk kemi.)

Kjo sëmundje ka shumë mënyra për t'u trajtuar. Shpresojmë që këtu të ndihmojnë këshillat e shoqërisë dhe, pse jo, edhe këto këshilla, që do t'i vazhdojmë në disa leksione e seanca të mëpastajme. Sot po i përfundoj duke ju uruar:  
**RRITNI FËMIJË TË MBARË! PAÇI FËMIJË TË SHËNDETSHËM NË MOSHAT 5 DERI 55 VJEÇ!**

**1984**

## *Lyerja e stolave në park*

Ditën e premte bojaxhijntë e dekorit të qytetit, lyen me bojë të freskët stolat e parkut të pyllëzuar.

Boja nuk ishte tharë aspak, kur një çift të rinjsh, duke shkelur mbi qilimin e fletëve të zverdhura nga vjeshta, iu afrua stolit të parë.

Bojaxhijntë, që po lyenin stolat e fundit në majë të kodrës, e ndien: tabelat paralajmëruese që kishin vënë, nuk do t'i lexonte njeri as në mes të ditës. Ata ulerinë në kor:

— Eeeeeej!

Po djali dhe vajza u ulën. I pleksën njëzet gishtat e duarve, afruan dhe mbështetën lehtë kokat me njëri-tjetrin dhe u fundosën në lumturinë e tyre.

\* \* \*

Po atë mbrëmje, në shtëpi aty rrëth orës njëmbëdhjetë e gjysmë, Goni, përgjegjësja e re-

partit të pastrimit kimik, po bënte gati makinën larëse automatike dhe po fuste aty çarçafë, këmishë e peceta, që do të lahesin gjatë natës. Të nesërmen Gonit nuk do t'i mbetej veç t'i ndente në tela e të nisej e qetë në punë.

Në apartament kishte rënë qetësia. Pirron dhe fëmijët i kishte zënë gjumi.

Goni u fut në dhomën ku flinin të tre çunat dhe u nxori nga xhepat shamitë e hundëve. Pastaj kaloi në dhomëzën ku flinte Melita. Melita ishte zbuluar dhe Goni ia ngriti përsëri batanijet deri në mjekër. «U rrit si pa u vënë re», mendoi nëna dhe e puthi me ëmbëlsi. Kërkoi në pardësynë e vajzës shaminë, po befas vëmendjen ia tërhoqi një pako e mbështjellë bukur, në xhepin e majtë. E nxori pakon dhe e shpështolli. Aty brenda ishte një shall i hollë mëndafshi dhe figurina e një daullexhiu prej allcie. Dhuratën e shoqëronte një kartuç i lustruar, ku ishte shkruar: *Nuk u ndodha në 20-vjetorin tënd. Urime! Të puth... V.*»

Gonit sikur i ra rrufeja. E mbuloi kartuçin me turp dhe vështroi përqark.

E bija flinte qetë. Ajo buzëqeshte në gjumë.

Goni kontrolloi më me ngulm xhepat e pardësysë, por e papritura tjetër e paralizoi fare: E tërë pjesa e pasme e pardësysë, nga shpatullat deri në fund, ishte e ndotur me vija të trasha horizontale! Vajza, me siguri, ishte ulur e mbështetur në ndonjë stol të porsalyer.

Pa e mbledhur akoma veten, doli rrëmbimthi nga dhoma e Melitës, u fut në dhomën e vet

dhe iu afrua krevatit ku flinte i shoqi, Pirroja.

— Pirro! Pirro!

— Hë!

Pirroja u zgjua dhe, pa e përbledhur veten, u gjend në këmbë. E shoqja i zgjati kartuçin. Pirroja e lexi tri herë. Katër. Pastaj, gjunjë-prerë u ul në buzë të krevatit dhe mbuloi fytyrën me duar. I ngatërrroi gishtat nëpër flokë dhe Goniit iu duk se do t'i shkulte nga rrënjet.

— Obobo! Boobo! — ia bëri një copë herë babai. Pastaj u ngrit me vërtik dhe u sul në dhomëzën e Melitës.

Melita vazhdonte të flinte. Përmbi komodinë, një libër kishte mbetur i hapur. Pirroja e mori nëpër duar dhe e ktheu nga kapakët: «Dashuria e Mimozës».

Burrë e grua u panë sy ndër sy. Për herë të parë do të përballonin një telash të një lloji të ri, të pandeshur ndonjëherë. Goni e mori të shoqin për dore dhe e shpuri te pardësyja e varur.

— Shiko! — i tha me zë të ulët.

Shenjat ishin aty. Shirita paralelë boje. Nga shpatullat deri poshtë. Vajza atë mbrëmje ishte ulur me dikë në park. Ata u kujtuan që ajo kishte ardhur në shtëpi pasi qe errur, kishte thënë «mirëmbërëma» që nga korridori dhe, pasi ishte zhveshur, kishte hyrë në kuzhinë.

E kaluan gjithë natën pa gjumë. Pirroja mbildhej kruspull, ngrihej ndizte abazhurin, lexonte

kartuçin, pinte cigare dhe e nxirrte tymin tok me pshërétimat.

— Ne jemi qorra! — tha pas një heshtjeje të gjatë. — Ah, do të vinte kjo ditë, moj, do të vinte! Mosha e saj...

Goni ishte shtrirë përbri e pazhveshur. Bisédën e mbajti gjallë ajo, derisa u zbardh.

— Po ta ndiente fajin, nuk do ta linte pardësynë ashtu... Ta zëmë se nuk e ka vënë re... Ama, kur të vejë ta veshë nesër, do ta shohë. Po ta fshehë, ne do ta mbérthejmë e do t'i kërkojmë hesap... Po nuk e fshehu, do të na e shpjegojë e ne do të habitemi se ç'budallenj paskemi qenë që vuajtëm sonte kaq shumë!

— Ee, nga ai krah fli ti! — shfrynte Pirroja.

— Vajza u bë njëzet vjeçë! — vazhdonte e shoqja. — Mbase na fsheh ndonjë gjë që ne mund të mos e dimë. Por ama budallaçkë nuk e kemi. Këtë e dimë. Nuk do t'i linte blanat ashtu, përturp!... Kushedi, kushedi!

I shoqi i ndizte cigaret njérën pas tjetrës.

— Po daullexhiu?

— Daullexhiu... — përtpej Goni.

— Ai daullexhiu i vë kapakun! — turfullonte Pirroja. — Kush do të jetë ky V.? Pale të jetë ndonjë horr, zanatçi i këtyre punëve! Të rruat, pastaj!... More, po të tjerët kanë nga pesë dhe s'vuajnë hiç. Ne, një të vetme, e nuk e ruajtëm dot nga kolera.

Goni vërtitej dhe e mbante me shpresë.

— Kushedi, kushedi... Nesër, nuk është çudi

të qeshim me veten për ç'hoqëm sonte... Ne mendojmë mynxyra, kur fap!... Të gjitha këto mund të mos kenë asnje të keqe. Flemë, flemë...

Por asnjeri nuk fjeti. Në orën pesë ata e ndien kur u ngrit Melita. Në kuzhinë u dëgjua radioja, në lavamanin e banjës kutitë e furçave të dhëmbëve.

— Po mund të jetë edhe ndonjë djalë i mirë ky V-ja! — tha papritur Goni.

— Pika gruas! Se për atë të mirin ndenjëm pa gjumë ne! — shfryu nën zë Pirroja. — Ah, këto mosha!...

Dhe u ngritën.

Melita po përgatitej për punë. Që nga altoparlanti i radios dilte një zë i ëmbël vajze:

*O dashuri, dashuri, dashuri, daaa-shuuu-ri!  
D dashuri, zog pranveror,  
me krahë të bardhë je!*

«Ah, krahë të bardhë shumë!» mendoi Goni dhe nxitoi të mbyllte radion, po, kur u dha në kuzhinë, Pirroja e kishte mbyllur më parë. Sytë e burrit ishin të fryrë nga pagjumësia.

Goni bëri gati ushqimin që do të merrnin me vete. Melita u fut në dhomëzën e saj. «Tani i vjen radha pardësysë!» mendonin veç e veç, burrë e grua.

Melita doli. Kishte veshur një xhakavento të lehtë.

— Mami, ma merr, të lutem, me vete pardë-

synë. Atje në repartin tënd e pastroni me kujdes. E ndota dje në punë.

— Në punë?!

— Stolat e uzinës ishin lyer. Unë nuk i pashe, — tha pa të keq vajza.

Goni e pa të shoqin në sy dhe u fut me nxitëm në të ndarën e së bijës. Pastaj doli që andej me pardësynë në dorë. Daullexhiu rëndonte në xhepin e majtë.

— Mos ke harruar gjë nëpër xhepa? — pyeti ashtu si pa të keq Goni.

— Oh, po, — u kujtua Melita. E tha si të ishte pafajësia vetë. «Pa i mësuar këto dredhiçka, asnje nuk i hyn valles», mendoi nëna e rraskapitür. — Kam një dhuratë për ditëlindjen. Ma dha mbrëmë Vasilika. Vëre mbi komodinë. Ditën e mirë!

Vajza u zhduk përtej portës dhe Goni buzëqeshi e gliruar.

— Vasilika?!! — pyeti Pirroja me dyshim.

— Vërtet, — tha Goni duke i ardhur turp për të gjitha vuajtjet. — Vasilika nuk ishte në festën e ditëlindjes. — Dhe mori frymë e lehtësuar. Por i shoqi nuk ishte lehtësuar aspak. Ai përplasi portën dhe zbriti shkallët për të vajtur në zyrë.

\*

\* \* \*

Atë mëngjes në repartin e pastrimit kimik vërshuan palltot e pardësytye e çifteve, që një natë më parë, të hutuar e pa kujdes, ishin ulur

pranë e pranë njëri-tjetrit nëpër stolat e porsa-lyer të parkut të madh.

Goni u paraqit në punë me një vonesë të pazakontë për të. Si përgjegjëse, ajo vinte gjithmonë e para. Gjithë ai lehtësim që pati në shtëpi, iu zhduk porsa pa vargun e nënave që kishin zënë radhën për të lënë për pastrim rrrobat e djemve dhe të vajzave, që mbrëmjen e kaluar, fshehurazi, në park, kishin bërë dashuri.

Gratë që punonin me Gonin, e kishin hapur repartin dhe kishin prerë me dhjetëra fatura. Përgjegjësja fshiu nga kujtesa shfajësimet e së bijës dhe u tërbua nga zemërimi. E gjithë kjo situatë groteske, që shoqeve të punës i ndillte gaz, asaj i shkaktonte një boshllëk në stomak. «E kam ndotur në punë», i pati thënë e bija. Që të gjitha klientet që shtyheshin në banak, pa u velur aspak nga fjalët që kishin thënë më parë shoqet e tyre, përsëritnin të njëjtën gjë.

— A më pastrohet dot? E kam të çupës. Ma ka ndotur në punë.

— Dhe ai imi në punë. Atje në shkollë, djali qe ulur në një stol. E kam mësues fizkulture.

— Sikur t'i ketë mësuar i njëjti njeri! — i pëshpëriti Fatmira në vesh përgjegjëses, ndërsa kjo po futej matanë banakut. — E kupton se ç'ka ndodhur? Dje janë lyer stolat e parkut.

Përgjegjësja kaloi buzëvarur, hapi dollapin e vet, veshi mantelin dhe plasi aty rrjetën, ku pati futur pardësynë e së bijës. Pastaj e mbylli dillapin me kyç.

Palltot e ndotura me vija paralele të stolave ishin varur në hekur. Fatmira vazhdonte të futuronte.

— Të kujt e ke? — pyeste Fatmira me një djallëzi të fshehur.

— Të çupës.

— Ku e ka llangosur?

— Në punë.

— Po ti?

— Të djalit.

— Në punë dhe djali yt?

— Në punë. Në punë, për bela!

T'i dëgjoje ato gratë e moshuara para banakut, do të besoje se në tërë botën ishte shpallur fushata e bojatisjes së stolave për çlodhje.

Goni i vështronë si e përhumbur. Të mos kishte vetë atë rrjetën e fshehur në dollap, do të qeshte. Po si mund të qeshte?! Shikonte radhën e grave dhe mundohej të gjente se cilat nga ato, së afërmi, do të bëheshin krushka me njëra-tjetren. Sa kafe e fjalë të embla do të shkëmbenin bashkë! Kurse tanë nuk njiheshin, por shtynin shoshoqen me padurim. Po ajo vetë, Goni, me cilën do të pinte kafe?

Përpara përgjegjëses, një fantazi e tillë e kishte pushtuar Behijen. Ajo i merrte rrobat nga banaku dhe, pasi ua kalonte supet nëpër varëse, i shpinte matanë perdes. I përqaste vijat dhe bojnë e i veçonte me kujdes dy e nga dy. Pastaj i vendoste pranë e pranë në hekurin e gjatë.

Kur grumbulli i klientëve pati firuar dhe

punonjësit e repartit mbetën vetëm, plasi gazi. Behija hapi perden me një gërvimë të gjatë dhe zbuloi tërë pamjen: tridhjetë e ca pallto, xhupa e pardësy të varura, pa jetë, çift e çift e tek e tek, prisnin që t'u hiqeshin damkat që kishin marrë një natë më parë.

— Dashuria nuk bën as edhe një ditë pushim!

— kukurisi Rita.

Behija u afrua pranë hekurit dhe shpalosi përpara shoqeve zbulimet e saj. Të akuzuarit mungonin. Por emrat ishin aty, nëpër ca fatura të mbërthyera me gjilpëra me kokë.

— Inxhinieri ynë paska qenë me vajzën e këtij pensionistit që kemi sipër dyqanit tonë... Ja, vijat njësoj. Vija të holla. Stoli paska qenë me riga prej hekuri. Inxhinieri paska qenë ulur nga e djathta, ajo nga e majta. Në pardësynë e inxhinierit vijat ngushtohen këtu dhe po me atë largësi vazhdojnë e ngushtohen në pallton e çupës.

Behija po shfaqte sot aftësitë analitike të një hetuesejë të vërtetë.

— Ky mekaniku i kinemasë, Dhori, qenka ulur me këtë librashitetën, qenka ulur në një stol të drunjtë. Me dhoga të gjera. Ai e ka mbajtur këtë...

— Behija lexoi në faturë emrin e vajzës, — ... Vita Aleksin, nga krahu i djathjtë. Në fillim kanë qenë të qetë, pastaj qenkan rrëmbyer pak. Të rrëmbyerit i kanë vijat e para të qarta, pastaj kanë njolla të trazuara.

— Hë, moj budallaqe, se ata janë të fejuar, — e përbajti Fatmira.

— Të fejuar?! — Behija i shtyu varëset më tej. — Të fejuarit nuk kanë interes.

Pardësytë rrinin varur e zhubrosur pa jetën dhe pa ashkun që gjallëronte brenda tyre një natë më parë. Sikurse mbrëmë, ato rrinin pranë e pranë. Veç krahët e tyre, tani bosh, nuk kishin forcë të pushtonin, të tërhiqnin. Sikur i pengonte turpi, që i kishin nxjerrë këtu në mes të ditës, përpara syve të grave të repartit të pastrimit kimik. Të tallura, të përqeshura, pa asnje mundësi mbrojtjeje, pa mundur dot të fshiheshin apo të arratiseshin që andej, ato prisnin, ashtu në grumbull, përfundimet e hetimeve që pati bërë Behija.

Në këtë lojë nuk merrte pjesë vetëm përgjegjësja. Ajo i kishte sytë të enjtur dhe ishte pa qejf. Në një rast tjetër shoqet e saj do të punonin në heshtje, siç po vepronte ajo, po zbulimi i çifteve, që bënин jetën e fshehur të parqeve, i kishte tërhequr fort me magjinë e tij. Apatia e Gonit nuk i pengonte dot thashethemet e tyre. Reptësinë shefja sot e kishte lënë në shtëpi. Do të mjaftonte një «shikoni punën, shoqe!» dhe Rita, Behija e Fatmira do të ulnin kokat mbi hekur a mbi solucion. Po përgjegjësja vazhdonte të punonte në heshtje. Dërdëritja e Behijes i cingëriste nervat, por, pa e dhënë veten, e ndiqte me interes. Atje nga fundi i hekurit ishin disa pallto djemsh, që nuk ishin bërë dot çift. Mos vallë ndonjë prej tyre kishte shirita nga katër gisht, bojë jeshile, me paralelin e tretë më të

hapur? Ku i dihej? Goni do të gjente rastin e do t'i përqaste vetë me ato njollat që kishte aty në dollap.

— Albës, Albës nuk po ia gjej dot bandillin. Nuk po e gjej dot me cilin ka marrë ajër të freskët mbrëmë! — hante inat me veten Behija.

— Mbase ka qenë me të shoqin?


— Po do t'i kish sjellë të dyja tok!

Logjika e Behijes përsëri nuk lë asnje të çarë. Alba punon në kozmetikë. Ajo u kalon çdo ditë para vitrinës, e lyer dhe e stërlyer. Ecën duke u tundur, pa kthyer kokën e pa i përshëndetur, me gjithëse përfshihen në të njëjtën ndërmarrje. Tani gratë e pastrimit kimik kanë një kënaqësi të vëçantë që kanë gjetur shtegun e fshehtësirave të saj.

— Nuk ka turp! Skroma!

Në mendjen e Gonit dyshimi për Meliten u ul përsëri këmbëkryq. Ishte qetësuar shumë shpejt me ato që i pati thënë e bija. Po pa shiko se ç'i kishte dërguar parku i madh i qytetit! Ishin me bollëk dëshmitë e qarta të dashurive. Kishte në ato vraga, përbajtje, lirizëm, kthjellësi dhe paturpësi.

Aty rreth orës njëmbëdhjetë ajo nuk duroi më dhe i dëboi shoqet. Deshi të mbetej e vetme. I ngarkoi që të tria me ca detyra larg repartit dhe, apo ato dolën, nxori pardësynë e së bijës dhe iu afrua palltove të vetmuara, që Behija nuk i kishte giftosur dot. Pardësyja e njëfarë Van gjeli e tërhoqi menjëherë.



— Vë-Vë-Vangjel! — u kujtua dhe u bë meit.  
Ajo i kishte shiritat njësoj, por ndryshonte boja.

— Na marrsh të keqen, more Vangjel! — tha me krenari Goni.

Pati mësuar mjaft nga përvoja e Behijes dhe u fut edhe vetë në brazdën e hetimeve. Palltot pa shoqe ishin pesë dhe secilës Goni i afrohej me frikë. Pasi dhe pardësyja e fundit nuk u përqas dot, nëna e Melitës, për çudi, nuk u qetësua aspak.

«Bobo! — tha me vete. — Po kemi fuqi ne të rrimë kështu në ankth?»

Siguria do ta torturonte, po pasiguria do ta vriste fare.

Një grua rrreth të tridhjetepesave solli një golf të trashë dhe pantallonat e të shoqit. Shiritat e njohur të stolave zbritnin natyrshëm nga golfi në pantallona. Gruaja kishte një fytyrë të ëmbël dhe një zë të kthjellët, të këndshëm për t'u dëgjuar.

— I ka ndotur në punë, — tha gruaja.

— Në punë?! — pyeti Goni ashtu siç bënte Fatmira.

— Në punë. E kam shumë të hutuar tim shoq. Ju lutem, kujdesuni që të mos i mbetet asnje gjurmë.

Gonin e rrëmbeu si padashur loja e Behijes. I vari rrobat në hekur dhe i përqasi pranë palltos së Albës së kozmetikës, që kishte mbetur e vetme. Nuk kishte pikë diskutimi: i shoqi i kësaj

gruaje të mirë, ai horr i fshehur, pa kokë që ta pështyje e pa këmbë që t'ia shkurtoje, takohej ndyras me gruan e një tjetri. Me atë pisputhen, që çdo mëngjes tundte vithet para gjithë vitrinave, rrugës për në repartin kozmetik.

Iu mor mendja dhe u mbështet.

— C'patët? — pyeti gruaja e mirë me atë zërin e këndshëm.

— Asgjë, — tha Goni, — asgjë, moj motra ime. Jam pa gjumë.

«Si nuk hapet dheu t'i përpunjë këta!» foli me vete Goni duke prerë faturën. Ia zgjati dhe i mori paratë duke e vështruar me keqardhje fytirën e bukur të gruas. Në ballin ku duhej të kishte furtunë e shkrepitma, nuk dukej as edhe një re.

Përtej xhamit, figura e gruas u këmbye me atë të Pirros.

Goni, me një lëvizje të nxituar, tërroqi perden dhe i fshehu të tëra rrobat e llangosura me bojë. Nuk deshi që i shoqi t'i vinte re.

Pirroja ishte bërë me djersë.

— Ka njeri brenda? — pyeti ai duke bërë me kokë për nga thellësia e repartit.

— Jo, — ia ktheu Goni e zemra nisi t'i rrihte fort.

— Vajta në uzinën e Melitës. Nuk m'u ndenj... I kishin lyer vërtet stolat atje, — tha burri, duke e thjeshtësuar me zor të madh këtë fakt, që e kishte bërë të lumtur.

Ama Pirroja nuk dinte gjë për parkun. Goni

ia pati zili. Pirroja nuk dinte për ato tridhjetë e ca palltot matanë perdes. Ai nuk dinte se duheshin matur paralelet, nuancat e bojës, qëndrimet e qeta apo të rrëmbyera, vijat e qarta apo të trazuara. Me një fjalë, ai nuk kishte idenë për shkollën që kishte bërë e shoqja këto dy-tri orë. Ajo, megjithatë, i buzëqeshi.

— E shikon? A të thashë, Pirro?

Ai mblodhi supet e bëri një lëvizje shfajë-suese me dorë.

— Sidoqoftë, — tha duke ndezur një cigare, — mosha e saj... Tani e tutje është për t'u pasur ky merak.

Goni e përçolli të shoqin. Qetësinë nuk po e fitonte, por ama ishte e kënaqur që parku i uzinës i kishte dalë në mbrojtje së bijës. Goni nuk do ta shtynte më tej këtë punë. Ja, e shumta, sa për ta mbyllur, do të pyeste dhe Vasilikën për punën e atij daullexhiut. Po Vasilika me siguri do t'i dilte për zot dhuratës. Do t'i dilte, se ia kishte dhuruar vërtet. Pastaj, edhe sikur të mos ia kishte dhuruar, nuk do ta linte në baltë Meliten. Po mirë: përse nuk kishte shënuar emrin e plotë, po kishte katranosur aty vetëm një V? Se, fare mirë, ajo V-ja mund të jetë ndonjë Viktor ose Vasfi... Veledin... Po, edhe Valentin mund të jetë!...

Në një çast i erdhi turp që po mendonte kështu. Goni, vajzën e kishte të mirë, të bindur e të përmbajtur. Po nuk do të ecte tërë jetën e lidhur për dore me prindërit. Do të mendonte dhe

vetë. Do të merrte vendime, do të zgjidhte... Ja, Goni e pati dashur Pirron e nuk kish gabuar. Tani, befas, që të dy, burrë e grua, dyshonin në sinqeritetin e vajzës, e verifikonin, e ruanin. Si dy prapanikë. Pa edhe mund të da... të da... të dashuronte. Po me ç'i dëgjonin veshët! Ja, ishin ca si ky i zoti i golfit, që të futnin të dridhurat.

Gonit i kërceu damari i ballit. U värsul matanë perdes dhe kerkoi me sy pallton e Albës dhe leckat e atij bandillit. I kishte vënë vetë pranë e pranë. I përfshiu dhe i përplasi përdhe. Ato ranë shuk mbi njëra-tjetrën. Gruaja filloi t'i shkelte me këmbë. I shkelte e nuk u ngopej.

Ishin të përdalat e bukëshkelurit ata që ua ngrysniq iellin e ndjenjave vajzave dhe djemve të rindj. Ishte tradhtia ajo që e bënte aq të qmuar virtytin e besnikërisë. Ishin cipëplasurit ata që mbanin me frymë prapanikët.

— Na! Na! Na! — i ngjishte me këmbë Goni ato rroba, që para disa orëve shtrëngonin njëra-tjetrën. Mëngët e golfit zgjateshin e kapërtheheshin nën sjetullat e palltos. Pantallonat e zbërtthyera i plekseshin përgjegjëses nëpër këmbë. Për një çast, paçet e burrit të panjohur ia lidhën nyjat e këmbëve dhe gruaja u mbajt në banak që të mos rrëzohej.

— Qofshi mallkuar! — u zbrazi Goni dhe u raleckave me shkerm.

Tani sikur u qetësua disi. U ul në karrige

dhe priti të vinin shoqet. Kishin gjithë atë punë për të bërë. Tani edhe në ditët që do të vinin, ajo, sa herë gjente kohë, rrinte e sillte ndër mend emra që fillonin me gërmën V: Vladimir, Vasiliaq, Vehap, Vehip...

**1987**

## *Nga blloku i shënimave*

Kur të humb kapelja, në fillim është mirë  
të shikosh se mos e ke në kokë.

— Çudi, o babi, këtu, te lavamani i banjës,  
jam më e gjatë. Te lavamani i kuzhinës, nuk e  
kuptoj, jam më e shkurtër!...

— Shoku Mane, djali juaj më vjen në klasë  
çdo ditë me vonesë.

— Si ka mundësi, moj shoqja mësuese?! Ai  
niset shpejt.

— Nuk bën detyrat...

— Shoqja mësuese, tani vërtet po habitem.

— ... Vjen me këpucë të pafshira.

— Këpucët?! Po ai... Më falni, ju jeni më-  
suesja e djalit të madh, apo e të voglit?...

— Djalin e kam portier me ekipin e qytetit.  
Të dielen që kaloi, pas ndeshjes, tifozët ma sollën  
deri në shtëpi duke e brohoritur. E mbanin në  
krahë, e hidhnin përpjetë, e kalëronin përmbi  
shpinat e tyre...

— Dhe ty, zemra mal!

— Hiç fare! Kam frikë se të dielën që vjen do të më thyejnë xhamat e shtëpisë.

Burri im nganjëherë thotë se pi për të harruar, por asnijëherë nuk harron për të pirë.

Gjитони им киште трідхjetë вjet që мësonte frëngjisht. Ia dinte vlerën gjuhës së huaj dhe трідхjetë вjet s'bënte gjë tjetër veç hapte metodën dhe përsërise: «Lëve-vu! Aseje-vu!»

Pardje, gjитони vdiq. (Sa e rëndë qenka vdekja nëpër shënimet humoristike! E rëndë, e lehtë, ai vdiq!)

Isha në paradhomën e tij, kur doli doktori.

— Nuk zgjat më shumë se dy orë, — tha ai duke larë duart me sapun.

Më pas, nga dhoma e të sëmurit doli dhe e shoqja.

— I hapi sytë, — tha ajo.

— T'i japim një lugë kos, — propozoi dikush.

— Jo, — ia bëri gruaja me zë të mbytur nga vaji, teksa fshinte hundët, — kërkon metodën e frëngjishtes...

Nga këto pijet freskuese, mua më pëlqen vetëm rakia.

Dimri erdhi. Zuri e ftohta. Kaldaja duhet riparuar. Qymyr nuk kemi dhe disa xhamat duhen zëvendësuar. Dimri na zuri papritur, si të thuash,

pabesisht. Na zuri pabesisht, tamam siç na zuri vjet, siç na zuri parvjet, si na ka zënë vazhdimisht që kur mbaj mend unë...

Një dialog të dashuruarish në stacionin e trenit:

— Ke dalë të më presësh, Sokol?! Unë nuk të lajmërova se kür do të vija. Si e gjete ti?!

Kam metodën time.

— E si qenka kjo metodë?

— Asnjë metodë, moj budallaçka ime e vogël. Thjesht e dija që këto ditë do të vije.

— Po si qëlloi që dole të presësh tamam këtë tren? Na u lidhën mendimet së largu? Apo rastisi?

— Asnjë rastësi, Arta... Kam një javë që dal e pres çdo tren.

Paratë e mia i prishim tok me Taqon. Ndodh kështu: Ai më ngatërron ca punë që më hapin një telash të madh e më dëshpërojnë pa masë. Marr Taqon dhe pi për dëshpërimin. Pastaj përmbledh forcat dhe i zgjidh telashet që më hap Taqoja. E marr përsëri Taqon e pimë tok meqë u zgjidh ky hall i madh.

A e dini se fustanet e bardha që lëshohen me qira për nuset, tani janë të zgjeruara në bel, ngaqë disa nuseve po u rrinë shumë ngushtë?

Dhe një çudi e mëpastajme: Fëmijët në bark të nënës tani rrinë veç tre-katër muaj. Ne, më

parë, me sa më kujtohet, kemi pasë ndenjur më shumë!...

Jam i lodhur se kam udhëtuar gjithë ditën. Telegrami im, me të cilin kërkoja të dilnin të më prisnin, arriti pasi kisha vajtur unë. Por unë nuk mërzitem, se kjo nuk tregon që shërbimi postar është i ngadalshëm por që transporti i udhëtarëve bëhet shumë i shpejtë.

Albana e vogël ra të flinte në krahët e gjyshit dhe pa ëndërr: Gjyshi, veshur me të bardha, shiste akullore!...

Në sallën ku shfaqej komedia kishte aq shumë qetësi, sa dëgjohej se si qeshte mbyturazi e shoqja e autorit.

## *Pyetjet*

Gjyshi Xhako ecën përpara. Genti e ndjek dhjetë hapa më pas, buzëvarur, i pakënaqur. Gjyshi ndalet dhe kthehet të presë nippin gjashtëvjeçar. Ndalet gjyshi, ndalet dhe nipi.

Nip e gjysh janë grindur. Të shikosh vetullat e buzët e djalit, të krijohet përshtypja se nuk do të pajtohen më. Gjyshi Xhako kthehet dhe vazhdon rrugën. Rifillon të çapitet dhe Genti.

Xhakoja heq kapelën e bardhë dhe fshin djeriset. Shumë kureshtarë këta fëmijët e sotëm! Pyesin, pyesin! Të gjitha duan t'i dinë. Pastaj, seç bëjnë ca pyetje që nuk di se ç'përgjigje t'u japoesh. Ti kujton se mbarove punë, ata kanë gati një pyetje tjetër. Ja, një ditë Xhakoja i shpjegoi Gentit se njeriu më parë ishte majmun, pastaj u bë njeri. Dhe këtë ia tha me autoritetin e një plaku që i di mirë teoritë shkencore të zhvillimit të racës njerëzore. Por aty për aty Genti i bëri atë pyetjen e pamëshirshme:

— Po tani, majmunët pse nuk bëhen njerëz?

Xhakoja vështroi përreth se mos i vinin në ndihmë, pastaj, pa ia bërë syri tër, u përgjigj se kjo tani nuk ndodhte më, ngaqë ishte ndaluar me urdhëresë të posaçme.

Në darkë Genti ia drejtoi këtë pyetje të atit dhe Xhakoja bëri sikur nuk dëgjoi.

Për afro dhjetë ditë Genti nuk vajti ta pyeste gjyshin për asgjë. Vetëm mbrëmë ra fjala për bezlerët që i pinin gjakun fukarasë dhe gjyshi Xhako nisi t'i tregonte se si jetonin bezlerët në mes të të mirave. Nuk u mjaftua me këtë, por, që Genti ta shikonte me sytë e vet historinë, e mori dhe e shpuri te sarajet e Sinan beut, ngrehinë që kanë mbetur më këmbë edhe sot. Kushedi ç'priste Genti! Sarajet iu dukën katrahurë! Me ato shkallë të ngushta, me ato korridore të errëta, me ato dritare të vogla. Sarajet nuk kishin asgjë të bukur.

— Në këto shtëpi jetonin bezlerët?!

— Ja, këtu! — tha gjyshi, tërë qejf që ia kishte plotësuar dëshirën nipçes.

Po fytyra e nipit dëftente mërzi, mosbesim, zhgënjim.

— Ik, o gjysh, ik. Ti kërkon të tallesh.

Dhe ishin larguar nga sarajet të zemëruar. Gjyshi përpara e nipi pas.

Të lodhur, të rraskapitur, po kthehen prapë në shtëpi. Xhakoja futet në parkun që ndodhet përpara pallatit të tyre e ulet në një stol. Po Genti përsëri nuk i afrohet dhe ulet në një stol tjeter.

— Kur s'mora Albanën! — shfryu Xhakoja, që të dëgjonte fëmija.

Genti nuk i përgjigjet.

— Për qejfin e zotërisë sate bëmë gjithë këtë rrugë! Kujton se më kish marrë malli pér sarajet e beut?

Nipi bën sikur nuk e dëgjon.

— Kaq. Sinan beun nuk e nxjerr dot nga varri. Sarajet kanë mbetur, ato të tregova!

— Pooo... Më gënjeve, — ia kthen së fundi Genti.

Xhakoja ngrihet i zemëruar dhe i vete nипит aty ku ёshtë.

— Pa shiko, djalë i prapë! Gënjen gjyshi?!

— Nuk më gënjeve, por as të vërtetët nuk më tregove. Ti the që beu rronte njëqind herë më mirë. Ama, shtëpi! Ku pallati ynë, uhuu...!

— Avash ti, avash!... S'kemi pasur këto pallate ne atëherë. Ne rronim nëpër kasolle.

Dhe Xhakoja e kupton se ku ka çaluar shpjegimi i tij.

— Duhej të të tregoja më parë kasollet. Më fal!

— Nuk të fal!

Po zemërimi i fëmijës nuk vazhdon gjatë. Genti ngrihet nga stoli dhe vete i zë dorën plakut.

— Hajde më shpjer, më trego kasollet.

Gjyshi gëzohet që u pajtuan, po kërkesa e re e tremb.

— Oho... Kasolle nuk gjen një pér nishan!

— Prapë po tallesh?

— Jo, jo... Për fjalë të nderit!

Djali këtë radhë e beson dhe i ulet në prehër.

— E si kanë qenë kasollet?

Kështu po. Tani Xhakoja mund të tregojë orë të tëra.

— Kasollet kanë qenë ca shtëpi të vogla. Shtëpi u thënçin! I bënim me gardhe dhe pastaj u hidhnik sipër një dorë baltë. Nga lart i mbulonim me bar ose me kashtë.

— Sipër barit ua hidhnit çimenton?

— Çfarë çimento, mor bir! Bar, o, bar, vëtëm bar!

— Nuk ju fundosej këmba kur hypnit lart në çati?

Genti fillon të bëhet përsëri i mërzitshëm.

— E ç'punë kishim në çati ne?

— Po si ia bën fit për të rregulluar antenat?

Oho! Ç'do gjë duhet nisur nga e para! Xhakoja mundohet të ruajë qetësinë.

— Ku kish antena atëherë, mor shpirt i gjyshit!

— Punonte televizori pa antenë?

— Mos më çmend, Genti! Ne nuk kishim bukë, ti thua televizorë!

Vogëlushit i duket e çuditshme se si mund të mungojë buka.

— Nuk kishit bukë?! Po ku e shtronit gjalpin dhe mjaltin? — vërvit pyetjen tjetër.

Jo po kështu nuk ka se si të tregojë njeriu! Kjo është e padurueshme! Xhakoja për të dhjetën herë nxjerr e fshin djersët. Uh!

— Kam faj unë, që të tregoj ty!

— Mirë, mos më trego. Më mirë ngri duart dhe dorëzohu. — E, pasi i kthen kurrizin plakut, shton: — Do t'i lутем бabit të m'i tregojë. Kur nuk di të tregosh! Hë!

Oh, Xhakoja nuk mund ta durojë dot këtë.

— Kush nuk di të tregojë?

— Ti.

— Unë di, po ti... Të lë ti?

Gjysh e nip i kanë kthyer kurrizin njëri-tjetrit. Tani janë prishur për fare. Plaku nxjerr nga xhepi sahatin dhe e kurdis qetë-qetë e pastaj, që t'i tregojë Gentit se nuk e ka mendjen tek ai, thotë me zë të lartë:

— Si nuk erdhi kjo Albana nga kopshti!

Albana është motra e vogël e Gentit. Po djali, pa kthyer kokën, ankohet me zë të lartë, njësoj siç bëri plaku ca më parë:

— Si nuk erdhi babi nga puna!

Xhakoja shkon më tej, kërkon t'i ndezë fëmi-jës xhelozinë:

— Albana është vajzë e mirë.

Genti është akoma më i pamëshirshëm.

— Të pëlqen Albana se është qulle. Ajo nuk di të pyesë, ti nuk di të tregosh, e jeni të dy njësoj.

Xhakos i kërcen damari i ballit, po pastaj, befas, çuditërisht, zbutet. Fundi i fundit është e kotë që të mërzitet. Pyetjet janë e drejta e moshës.

— Hajde, hajde, mos më çudit... Unë e kam

ca zor, se ti të ngatërron me njëqind pyetje një-herësh... Po, fundja, pyet, nuk nxehem më.

— Nxehesh.

— Jo, jo, — thotë gjyshi. — Fjalë burrash.

Ja, toke!

I tokin duart. Xhakoja e merr përsëri djalin në prehër.

— Dëgjo, shpirt i gjyshit, ne atëherë nuk kishim asgjë nga këto që kemi sot. As shtëpi, as katandi...

— Kujt i thonë katandi?

— Prit... Nuk kishim q'të sheh syri sot. O po fare! Bukë, hiç, ilaçe, jo e jo. Gjilpëra si këto, jooo! Ku gjeje?!!!

— S'kishit gjilpëra? Lum si ju!

Plaku vë buzën në gaz.

— Lum, lum, po, kur nuk i ke, eh, q'vuan! Gjilpëra jo, doktorë jo. Ku ta gjeje doktorin. Duhej të veje në Tiranë. Shkonim me gomarë e me kuaj... Ec e ec... Po niseshim shpejt...

— Pse, nisej shumë shpejt treni i parë atëherë?

— Ohu! Ku kish atëherë tren të parë e të dytë!

— Punonte vetëm i treti?

E po gjyshi nuk mundet më. Kot që merret me këtë punë.

— U dorëzova, Genti. Dëgjon? Nuk e mbaj dot fjalën. U nxeha.

— Unë të thashë, o gjysh, po ti...

Dhe nipi shkon të lozë nëpër udhishtat e parkut.

S'ka faj djali! — flet Xhakoja me vete. — Ky kujton se tërë këto të mira kanë qenë kështu gjithnjë. Nuk e di ky se këto janë vënë me gjak e me djersë. Po, ama, edhe unë! Plak matuf! Shpjere në muze! Pse është muzeu?! Aty i ka të tëra: të djeshmen dhe të sotmen, realitetin dhe... dhe baba Qemon»...

Po, si shumë pleq, dhe gjyshi ynë i shfaq mendimet me zë dhe Genti e ka gati pyetjen e radhës:

— O gjysh! Ky Qemoja kë ka pasur baba?...

1981

## *Ditë që kujtoj e ditë që harroj*

Duhej të kishte dalë më shpejt, ose së paku të kthehej ca më parë se të fillonte të pikte dielli. Po xha Tares i pëlqejnë pa masë paraditet e të dielave, kur rrugët e qytetit denden me njerëz që nuk nguten. Ata mbajnë në duar ca rrjeta të mbushura me zarzavate e heraherës ndalin çapin për t'u hedhur nga një sy gazetave që kanë blerë nëpër qoshkat e posaçme. Plaku gazetën e tij e palos me kujdes dhe e zhyt pjesërisht, derisa ajo të cikë fundin e xhepit të xhaketës. Nis ta lexojë vetëm pasi ka ngrënë drekë e është shtrirë në krevat dhe i jep fund pastaj duke pirë kafen pas gjumit.

Xha Tarja hapi me kujdes apartamentin e tij në katin e pestë. Në shtëpi asgjë nuk pipëtinte. Televizori ishte i ndezur e megjithatë edhe që andej nuk ndihej asnje zhurmë. Filmi atë çast

nuk kishte as zë e as muzikë. Në një varkë, një vajzë e pashme, me një fustan të strepsur, rrinte shtrirë e një djale i përkëdhelte flokët.

Përballë ekranit, mbështetur mbi jastëkët e kanapesë, plaka.

— Hë, Xheko, po shikon filma me dashuri, ëh?

Po plaka e mirë nuk ktheu përgjigje. Flinte. Flinte me grep në dorë, përkulur kokën e bardhë me atë fytyrë të ëmbël, ku i qe harruar një buzagaz i lehtë.

— Eh, do macja të pijë uthull! — u tall xha Tarja duke u çliruar nga rrobat.

Hoqi çorapet dhe flladiti pllazet dhe kërcinjtë e këmbëve në çezmën e banjës. Pastaj u fut në kuzhinë në majë të gishtave. Ata në televizor po putheshin. Xhekoja flinte.

— Të shpëtoi më e bukura, Xheko. E prite, e prite e nuk durove dot.

Në aneks ai pa tavën e korentit, që nusja kishte gatitur për pleqtë para se të nisej për në plazh. Ua kishte bërë dhe sallatën dhe ua kishte lënë vetëm për kripë. Patën ikur të gjithë: djali, nusja dhe fëmijët, që e donin aq shumë detin.

— Tare, ti je?

Xhekoja qe zgjuar.

— Jo, jo. Tarja s'ka ardhur akoma. Unë jam hajduti. Por nuk do të vjedh. Vetëm një kafe do të bëj. Do ti?

— S'ka ca që piva.

Tarja vuri xhezven në prizë, pastaj mënjanoi perden. Plaka dremiste akoma.

- Kur erdhe? — pyeti ashtu, përgjumësh.
- Ja, s'kam pesë minuta.
- Kalin e fute në ahur?
- ?!... Po ku ta lija, jashtë.
- Ia hoqe samarin?
- Shpejt akoma. Është i dirsur.

Heraherës, si papritur, llafet e plakës çapra-shiteshin për shkak të sklerozës. Djali dhe nusja nervozoheshin. Atyre u vinte keq për nënën dhe me zor mundoheshin ta sillnin në rrugë të mbarë trurin e saj që, si në një film të çakërdisur, qepte njërin pas tjetrit, pa radhë e rregull, mijëra e mijëra vegime. Në kujtesën e Xhekës rrënjetë e zëna pesëdhjetë-gjashtëdhjetë vjet më parë lëshonin befas bisqe të brishta, që nuk mbanin gjatë.

Po Tarja nuk mërzitej. Mbase ngaqë e njihte më afër pleqërinë. Mbase, mbase ngaqë e donte shoqen e tij më shumë nga çdokush tjetër.

— Ç'janë këto që thua, moj nënë? — dëshpërohej Nazifi, i biri. — Nuk jemi më në fshat tani. Njëzet e ca vjet ikur. Eja në vete!

— Lëre, o, lëre t'i thotë. Ç'prishi? Ja kështu vijnë ca nga ca të gjitha! — i thoshte Tarja për ta shfajësuar plakën. — Le të flasë. Se mos po na thyen xhamat!

Dhe vetë ia kthente ashtu si e hapte muhabetin ajo. Fshatçë-fshatçë! Qytetarçë-qytetarçë! Ajo zinte në gojë çupërinë e saj, ai pas avazit! Asaj i feksnin vitet kur punonin në kooperativë, ai bilbil! Për kryetarë e brigadierë, këtu e tri-

dhjetë vjet më parë, Tares i dukej më mirë kështu. Kot ngrysej e hidhërohej i biri.

— Mbylle televizorin, Tare! — tha Xhekoja.

«Erdhën dhitë», murmuriti plaku dhe iu bind së shoqes. Pastaj zbrazi kafen dhe u ul në kolltuk.

— Si dole në këtë vapë, ti qofsh! Apo kishe kapellën? Pyet dielli për kapellë! Kushedi sa do të përvëlohen ata në plazh...

«Mirë, Xheko, mirë. Këtu mbaje vijën», ia bëri me vete, i kënaqur, xha Tarja.

— I shite kollaj qepët? — u zhyt plaka me një kërcim dyzet e ca vjet thellë.

— Kollaj fare. Tre lekë okën. Mbatha dhe kalin te nallbani e nxitova për këtu, mos më mbetej filmi pa parë.

— Nevruzin e pe nëpër pazar?

Nevrizi ishte vëllai i saj, vdekur që në pesëdhjetën.

— S'ma zuri syri. Kish shumë pazarakë.

— Italianët s'ju dolën t'ju prisnin udhën?

— Na dolën gjermanët. Po nuk u mori luga ujë. U thamë që jemi nga kooperativa e bashkuar dhe jemi në kohë fushate. Na lanë, ç'do bënin.

Dhe Tarja nisi ta rrufiste kafen duke qeshur. E shoqja u mbështet më mirë e fjeti përsëri.

Plaku la filxhanin dhe nxitoi t'i rregullonte jastëkun. E mbështeti Xhekon me ëmbëlsi dhe u ul edhe një herë pranë filxhanit.

Xha Tarja ishte i bindur se tani e donte sho-

qen e tij dhjetëfish më shumë se më parë. Kjo ishte një dashuri e veçantë, pa zhurmë e pa dallgë, po megjithatë tepër e madhe. Kishin jetuar tok me të zeza e të bardha.

Po kjo Xhekoja, që tani, më tri-katër ditë e bën Taren të qeshë, nuk kishte qenë gjithnjë kështu, jo! Ku!... Atëherë...

\* \* \*

... Vinte dimri dhe kalonte. Shkrinte dëbora e ngrohej moti, gjethëronin pemët, jeshilonte bari, daldisnin lulet...

Kalonte viti në një vargan ditësh pa emra, pa data, pa javë e pa muaj. Dëbora na thoshte është dimër, bilbili na sillte beharin, duajt e grurit thoshin korrik e, kur zverdhte misërishta, trokiste vjeshta...

Atë ditë bënte vapë dhe më ishin tharë hundët. Vjeshta akoma nuk na pati ardhur. Hodha tutje shatin, me një gisht rrëmbeva shtambën dhe u nisa për në burim. Lumin e kalova pa i përveshur pantallonat dhe u futa në korije.

Te burimi xhanxin! Patëm vënë aty një tjegull, që zgjatej dhe e hidhte ujin e ftohtë si çezmë. Po, si dukej, tjegullën e kishin lëvizur e tani uji varej poshtë, nën të, duke lëpirë barin e baltën. E shpura tjegullën në vend, prita ujin të kthjellej dhe ula kokën nën çurgun e tij. Uji

ishte i ftohtë, shumë i ftohtë. Kur ngrita kokën, rrëkeja më kullonte nga flokët, nga veshët, nga sytë dhe pastaj më rrëshqiste poshtë gjoksit. Kështu më jepte një lehtësirë të këndshme.

Ashtu, turbull-turbull, me sytë të veshur nga rrëkeja, pashë Xhekon. Po vinte me dy gjyma në duar. Vëllai, që i kishin dhënë si trim pas vetes, ishte fare i vogël. Më thertë mua, në e pati kuptuar porosinë ai! Se ai të motrën ma nisi mua dhe vetë rendte andej-këtej, nëpër korije, për të gjetur ku fshiheshin gjinkallat.

Pa nxjerrë këmbët nga uji, unë u ula në ledhin e burimit e prita çupën.

Vura re që ajo rrudhi vetullat dhe që larg, ia nguli sytë burimit. Vetëm burimit.

Nuk më njatjetoi. Këtë unë e prisja dhe nuk e prisha terezinë. Por as syrin nuk po ia ndaja. Ajo lëshoi gjymat përmbi ledhin tjetër dhe nuk ia hiqte që nuk ia hiqte sytë burimit. Mundohej të më bënte një me ç'kisha rreth e rrotull. Rreth e rrotull kisha driza.

Por unë nuk isha drizë.

— Mirëdita, Xheko!

S'më dha përgjigje. Ama unë e kisha mbërthyer në sy. Unë atë, ajo burimin. Burimi, nga ana e tij, po avazin, rridhëtë siç kishte rrjedhur kushedi që kur.

Xhekoja e ndiente veten ca ngushtë. Lëvizi gjymat nga vendi dhe ua rrotulloi veshët që të binin nga unë. Pastaj ua vërtiti veshët nga vetja.

Kjo mua nuk më sëkëldiste. Megjithatë më hipi të psherëtija. Psherëtiva.

Ajo vendosi të mos priste më dhe rrëmbeu njërin nga gjymat për ta vënë aty kù uji binte nga gjuha prej tjegulle.

Por unë isha më i shpejtë dhe zgjata atje shtambën time. Ajo u tërroq. Unë kisha radhën. E shpëlava shtambën nëntë herë me radhë dhe isha i bindur që nuk e kisha shpëlarë mirë, prandaj vendosa ta shpëlaja dhe nëntë herë të tjera.

Pasi derdha ujin e shpëlarjes së fundit, unë e vura grykën e enës nën gjuhën e tjegullës, por e vura ama lëre mos e pyet. Ashtu si e vura unë, duhej të vinte mesi i natës, pa të mbushej.

Xhekoja ma bleu mendjen dhe i ngriti sytë mbi mua. Vetullat i ishin bërë kosore. M'u duk sikur do të hidhej të më shqyente.

— Kërkon të tallesh tani? — më tha.

— Jo, pse? — ia ktheva.

— Hm!... Mos më bëj të ta marr shtambën e të ta hedh tutje.

Ishë e tmerrshme ajo Xhekoja. Të gjithë e dinin se mend e pati rrahur Laken që seç kishte dashur t'i thoshte. Dhe sa bënte e rrahura e saj! Të ikje nga fshati më mirë.

Unë qesha. Dhe e shtyva grykën e shtambës më brenda, që ajo të kishte mundësi të mbushej pak më shpejt, si të thuash, aty afër perëndimit të diellit.

Por ajo nuk priti hiç. Kërceu brenda, në pëllgun përpara burimit dhe ma mbushi shtambën

sa të numëroje dhjetë. Pastaj ma lëshoi aty pranë  
dhe vuri të mbushte gjymat e saj.

Më pëlqente ajo çupë. Më pëlqente shumë.

— A u mendove për atë që të thashë njëditë-  
zaj? — e pyeta.

Ajo nuk m'u përgjigj menjëherë.

— Nuk kam' përsë të mendohem. Përgjigjen ta  
kam dhënë.

— Ti ma ktheve aty për aty. Unë përgjigjen  
e dua të menduar.

— Ishte e menduar dhe fort mirë bile. Ja ku  
po ta them edhe një herë: shiko punën tënde,  
more djalë!

— Timen po shikoj, se mos po të kërkoj nuse  
për tim vëlla.

Ajo vuri nën tjegull gjymin tjetër.

— Është akoma shpejt për ty të kërkosh nuse.  
Vardisu edhe ca prapa Refkës, pastaj kujtohu.

E dija që këtu ishte tërë inati dhe nuk iu  
përgjigja. Ajo nxori përpara gjoksin e bëshëm, i  
tërhoqi në grykë çipat e shamisë dhe e ndau atë  
nga vetullat.

— Apo jo? Tërë thonë që u trete duke vajtur  
pas saj.

Gjymi qe mbushur dhe uji i rridhte anëve.  
Unë u shfajësova.

— Ç'të them? Kjo ka ndodhur përpara se të  
vija re sa e bukur ishe bërë ti. Por ama ca gjëra  
duhen parë më urtë: Ti e njeh Refkën, apo jo?

— Më gjej ndonjë që nuk e njeh?

— Ashtu... Domethënë e di se si e lëshon

ajo rripin, duke pritur t'ia shkelin. Atëherë duhet ta kuptosh se jo unë, por ajo ma hodhi laku e më vërdallosi ca kohë pas. Unë jam tepër i padjallëzuar. U gënjeva.

— C'na the tan!

— Më plaçin sytë, ashtu është! Unë të dua ty. Unë dua të martohem me ty.

— Léri, léri llafet...

— Do të dërgoj tim atë në shtëpinë tuaj. Të të kërkojë ty. Shpresoj që xha Lemja të mos ketë ndonjë kundërshtim.

— Xha Lemja do të pyesë të bijën.

— E po zgjidhur: pastaj ti do t'i thuash po.

— Uh, shakaxhiu! Nga e sheh ti këtë, more djalë!

— Ta këndoja në sy.

Ajo i bëri përsëri vetullat kosore dhe sytë iu ndezën flakë. Më pëlqente. Unë nuk e kuptoja se si do të jetoja dot pa të.

— Ditke të këndosh? Ku ke mësuar? Në sytë e Refkës?

Unë mblođha supet.

— Po sikur unë, tyt eti t'i them jo? — u zgjat më tej ajo.

— Atëherë do të vij vetë. Po the përsëri jo, do të vij të nesërmen. Nuk do të lodhem. Çdo mëngjes do të marr shatin e, kur të nisem për në fushë, do të them: Pa të kthehem pak nga shtëpia e xha Lemes. Do të trokas te porta e do të pyes: Si u gdhitë, more? A këmi gjë të re? Prapë jo?! Hajd mirupjekshim nesër! Dhe kështu, mote me radhë.

Vështrimi i vajzës qe zbutur. Dhe ajo e kishte hapur syrin e mendjes mbi kohën që do të vinte.

— Do të humbasësh të ritë tënd kot.

— Jo, moj, jo shumë.

— Pse, vallë?

— Se do të pranosh shpejt.

— Ashtu? E nga e di ti këtë?

— Ta këndoja në sy.

Ajo u bë egërsirë. Diç deshi të thoshte, por unë nuk e lashë ta hapte gojën. Gjoksin e ndieja të gjerë dhe fjalët më rridhnin lehtë. Nuk i kërkoja, nuk vrisja mendjen t'i gjeja. E kisha gojën plot, syrin plot dhe zemrën plot. Prandaj vazhdoava:

— Do të pranosh shpejt, sepse do të bindesh shpejt. Ngaqë jam djalë i mirë. Jam i fuqishëm si ka. Jam zemërbardhë dhe të dua shumë.

Ajo po e linte gjymin të derdhej.

— Nuk çuditem, se e kisha kuptuar që të pëlqen shumë vetja... Kjo duket... Ti nuk mund të duash tjetër, veç vetes.

— Gabohesh, të dua ty.

— Veten, veten tënde.

— Ta zësh hollë-hollë, ke të drejtë. Dua veten, gjersa bie në dashuri me një çupë kaq të mirë. Po të mos e doja veten, do të bija në dashuri me një tjetër.

— Me Refkën, për shembull.

— Po, tamam, me Refkën.

Heshtëm që të dy. Ajo më vështroi për një çast, pastaj tundi kokën. Ishte zbutur fare. Por u kujtua e rrëmbeu gjymat.

— Qenke bilbil, — tha dhe iu ngjit përpjetë bregut. — Po këndo për ato që të dëgjojnë.

Këngë bilbili, ma quajti. Por unë e kisha nga shpirti. E megjithatë s'vonoi e ma dëgjoi ajo.

Një jetë të tërë u deshëm me ashk e zjarr. E me këtë zjarr sollëm në drithë plot fëmijë e nipër, që na duan e i duam. E na shohin me sy të ngrohtë. Pa vënë re cenet e pleqërisë, që nuk i kemi në dorë. Pa nganjëherë i mërzitim, nganjëherë i lodhim dhe i mundojmë. Por ata na duan e me siguri do t'i harrojnë. Këto edhe ne duam t'i harrojmë. E nga tërë kjo jetë e gjatë, me gaz e me furtunë, do të na zgjedhin aty ku duan, në atë çast e në atë vit që duan ata të na mbajnë mend. Pa do të kujtojnë e rikujtojnë më të bukurat punë që bëmë e më të urtat fjalë që thamë.



E xha Tarja i ngriti nënë Xhekës një cullufe të argjendtë mbi rrudhat e bucura, me një kujdes të madh, që të mos ia trazonte gjumin.

1986

## *Po ato që thamë dje?!*

E kishte këtë të mirë Sili Dishnica, për çdo porosi që merrte andej nga drejtoria e kantierit, e sidomos nga drejtoria e përgjithshme, na mbildhëtë të gjithë sa punonim në objekt.

Atëherë ta dëgjoje përgjegjësin tonë. «Pesëminutëshi i mëngjesit» nuk zgjaste më, si zakonisht, njëzet, apo tridhjetë minuta. Edhe dyzet!

— T'i kemi të tërë si Sili! — do të thotë ndonjëri. — Ku ma gjen ti të drejtën të përgojosh një njeri që i sjell të ngrohta, taze, porositë e drejtorisë?!

Por edhe unë përgjigjen e kam në majë të gjuhës: Sili sjell të sotmet dhe harron të djeshmet!...

\*

\* \* \*

Ja... Një mëngjes na mblodhi e na vështronëtë në sy, pa folur. Buza nuk i queshte fare, dhe

ne vrisnim mendjen se mos kishim bërë ndonjë gabim të pandreqshëm në zbatimin e projektit të ndërtesës.

— Uluni! — na tha duke na treguar me kokë stolat dhe tullat ku uleshim çdo mëngjes. — Zini vend, se nuk do të ndahemi mirë sot.

E, ndërsa ne uleshim, ai, me kokën përpjetë, shëtiste sytë nga vinçi te skelat, nga skelat te vinçi. Mblidhje buzët me qortim, tundte kokën e pshërëtinte.

— Kanë ardhur të gjithë?

Kishin ardhur. Me një lëvizje të kokës, Sili na ftoi të shikonim përpjetë.

— Nuk ju bie gjë në sy? — na pyeti të gjithë.

Ne shikonim skelat, kovat e dërrasat dhe vrisnim mendjen për vërejtjen që mund t'i kishin hequr Silit një ditë më parë në drejtorinë e kanterit.

— Hë, more shokë, nuk shikoni?!

— S'po shohim gjë, — i thamë.

— Nuk shihni ju, po shoh unë! — gjëmoi Sili.

— Se nuk shihni aty ku duhet! Pa vini re sa dobët jemi me sigurimin teknik! Po aq ju bën juve!... Se çekanët e drejtorisë bien mbi mua! S'ka ku të vejë më! Punojmë me tulla, me skela e me kate e në drejtim të sigurimit teknik jemi si mos më keq!

Dhoksa jonë, që s'rri dot pa folur, tha gati-gati me të qeshur:

— Për kokën tënde, përgjegjës, se na ngrive gjakun! Ne thamë obobo ç'ka ndodhur!...

Kaq kërkonte Sili.

— Pse, mos pret zotrote që të ndodhë, pa të mblidhemi?! Kot na thirrën dje?

— Kot nuk ju thirrën, — nisi prapë Dhoksa, — po ti sikur vjen këtu për herë të parë!... Ehu, sa herë e kemi ngritur ne!

— Nuk dua llafe! Dua përgjigje konkrete! Ja, ti, shoqja Dhoksë, që më flet ezber, punon në kat të pestë, ëh? Vetë, ç'ke bërë? Me se je siguruar! Hiç s'je siguruar! Do të biesh ndonjë ditë e do të marrësh më qafë veten dhe mua... Dhe mاشاللە، me atë peshë që më ke, rrezik të na zësh poshtë dhe nja dy a tre nga ata shokët që mbushin kovat e llaçit.

Ata të llaçit matën Dhoksën me sy. Sili vazhdoi:

— Mbërthe tri-katër dërrasa atje në skeleri, prapa kurrizit. Dërrasa ka plot. Bëje gardh, ballkon bëje!

Pastaj Sili e zhvendosi kritikën nga Dhoksa te të gjithë ne të tjerët, që deri tanë nuk e kishim vënë ujin në zjarr.

Dhe atë ditë i lamë të gjitha punët e tjera. Çak e çuk, për sigurimin teknik.

Pa vajtur dreka, Sili vari parullat që kishte porositur. Këtej nga punonim ne, nuk dukeshin, po që nga bulevardi, andej nga ana e drejtorisë, kalimtarët e ndalnin çapin dhe lexonin me zë:

SHIKONI ATY KU SHKELNI! RUAJ VETEN,  
RUAJ SHOKUN! TULLAT QË BIEN, KU BIEN?  
KUJDESI TË VIJË NË RRITJE, SIPAS KATEVE!

## GOZHDË ME MAJË TË MOS LËMË ASNJË. T'I SHTYPIM!

Të tëra këto rrodhën nga mbledhja e atij mëngjesi, që zor se do të harrohej.

Po në kish njeri që e harroi atë, ishte Sili vetë...

\*

\* \* \*

Një ditë ai na gjeti të mbledhur dhe, pa na pyetur si ishim e qysh ishim, filloi:

— Dje ne, përgjegjësit e objekteve, drejtorët e inxhinierët e kantiereve, shefat e makinerive, ku ishim e ku s'ishim, na mblodhën në drejtori. Të ishit e të dëgjonit ç'u tha aty për kursimin e shfrytëzimin e rezervave të brendshme. Për këtë problem tri orë foli vetëm drejtori i përgjithshëm.

Dhe Sili tundte kokën.

— Ore, tamam sikur fliste për objektin tonë! Po ku na shpie mushka, more shokë!

Nuk iu ndenj prapë Dhoksës:

— S'ka ku të na shpjerë, shoku Sili. Unë përvete asaj mushke nuk i kam hipur. Kursimin e kam merak, kurse rezervat...

— Mjaft ti, Dhoksë, mjaft! Lëmë të flas unë. Kështu kursejmë edhe kohën. Hm! U këpûte ti duke shfrytëzuar rezervat!... Ja, më thuaj, ç'janë tërë ato dërrasa që më ke mbërthyer në skelë, prapa kurrizit?

Ne shqyem sytë.

— Janë ato të sigurimit teknik, de!

— Ashtu?! Po nuk e di ti që dërrasa është lëndë deficitar? Jo, po nuk do t'ia dish ti! O lele koka ime, thua ti! Po duhet të thuash, o lele koka jonë! Kështu të thuash! Hiqi! Mos të t'i shoh më!

Dhoksa mori zjarr.

— Demek ti nuk do t'ia dish pér mua?! Po unë mund të bie nga kati i pestë, more!

— Oh, ja! Re ti dhe s'të pa njeri! — shfryu Sili. — Kursim, shoqe, kursim! Këtu më djeg mua. Më djeg është pak... Më përvëlon!

Me të mbaruar mbledhja, u thirr piktori pér parullat, që do t'i bënин jehonë kësaj fushate të re që shpalli Sili. Nga ajo faqja e ndërtesës pér-ballë drejtorisë ishin varur parullat e sigurimit teknik e ato nuk linin asnjë pëllëmbë vend. Këttej nga punonim ne, dritaret e drejtorit nuk shikonin e kot që të vareshin. U gjet rruga: parullave të para iu dha një bojë përsipër e mbi to u shkruan thirrjet e reja pér kursimin e shfrytëzimin e rezervave.

Ditë me radhë Šili na vërtitej mbi kokë me merak të madh.

— Mblidhni ato copat e eternitet. Do t'i futim në punë. Ç'është kjo tullë e harruar?! Kush e ka shpuar këtë thesin e qimentos? Unë, o i gjej, o vdes!

Në një nga këto ditë na u rrëzua Dhoksa. Nuk u vra fare, se ra nga kati i parë, po kjo

ngjarje bëri bujë, sepse Dhoksa u qorrollis përmbi një pirg me pllaka eterniti.

— Na theve copat e eternitit, që mezi po i mbledhim që t'i shfrytëzojmë! — i ulëriti Sili.

— Do t'i paguash, shoqe!

Paçka se qeshnim me fushatën e përqendruar të përgjegjësit, ne bëmë goxha punë. Në sheshin e objektit tanë mund të shikoje pirgje me tulla gjysmake, stiva me tubo eterniti që duheshin riparuar, togje me gozhdë të shtrembra që donin fare pak mundim që të ndreqeshin e të futeshin përsëri në punë. Sili këto ua tregonte plot krenari atyre që vinin nga drejtoria, duke ua llogaritur me laps vlerën në të holla, leverdinë. Kur ishte vetëm, u sillej pirgjeve rrëth e rrëth e i përkëdhelte me sy...

\* \* \*

Po ato nuk arritën të futeshin në punë.

Një ditë prej ditësh gozhdët e shtrembra, tha-sët e lëndët e dëmtuara Sili i ngarkoi në një kamion e dha urdhër të dërgoheshin në hedhurinat e qytetit.

Ishte dita kur punuam një udhëzim që fliste për domosdoshmërinë e pastrimit të territoreve të objekteve, për rregullin, pastërtinë dhe higjienën.

Atë mëngjes Sili na e tundte kopjen e udhëzimit sikur të na kishte zënë në faj:

— E kuptoni sé si kërkohet mbajtja e territorit? E shikoni se me ç'forcë ngrihet problemi i estetikës, i rregullit e i pastërtisë? Po s'do mend që do të ngrihet, se ne territorin tonë e kemi për faqe të zezë! Ç'nuk gjen këtu te ne?! Pirgje me gozhdë të shëmtuara, tulla që të kallin kru-pën, thasë çimentoje të zhübrosur...

— Janë ato që grumbulluam si rezer...

— E di... Iku ajo punë. E bëmë kur duhej. Sot flitet pér rregull e higjenë. E dini si e dua objektin? E dua vend klimaterik! — Këtu Sili mori flakë. — Na futen makinat me rrota të palara!

— T'u shtrojmë te porta lecka që të fshijnë gomat, pa të hyjnë! — propozoi Dhoksa si grua pastërtore.

— Lecka mbasse jo, — kundërshtoi lehtë përgjegjësi, — po zorrën e ujit ja ku e kanë! Le t'i lajnjë! Që ta kemi pastër e bukur këtu!... Ju të vini të veshur, të krehur, të rruar... More dhe furçat e dhëmbëve t'i merrni me vete, s'them jo...

\*

\* \* \*

Nuk më kujtohet mirë, po kishin kaluar dy-triditë nga shpallja e kësaj fushatë pér pastrimin, kur ne hoqëm Silin.

E hoqëm nga detyra e përgjegjësit, duke e

kritikuar paq për fushatomaninë e sidomos për stilin e tij burokratik.

E bukura është se atë ditë, as nga byroja, as nga organizata profesionale, as nga drejtoria nuk na qe punuar ndonjë material për luftën kundër burokratizmit.

Ne e hoqëm.

Do të jetë çuditur Sili!...

**1980**

## *Një kërkesë e zjarrtë*

Asaf Lala, nëpunës i sektorit të planit, kishte po ato ankesa që ka ajri, që mban gjallë një botë të tërë e asnjeri nuk e sheh e nuk e zë në gojë.

Atë natë, sado që u përpoq të ngrihej me kujdes që të mos e zgjonte të shoqen, nuk ia doli mbanë. Ajo i hapi sytë sa po e ndjeu krebatin bosh.

— Safe!

— Hë.

— U ngrite?

Asafi nuk iu përgjigj.

— Sa vajti ora?

— Mesi i natës ka kaluar. Fli!

— Po ti?

— Mua më bie në kokë bëzbëzi i frigoriferit.

Dhe Asafi doli në korridor. Mori e bëri një limonadë, pastaj kaloi në dhomën e pritjes. Nxori nga sirtari i bufesë një letër e, ashtu siç qe, në brekë, shkroi kërkesën:

Kérkoj tē largohem nga Drejtoria e Përgjithshme dhe tē kaloj në një nga ndërmarrjet në varësi tē saj...

Dhe as e ndjeu që prapa tij, zbathur e ashtu në këmishë tē natës, e shoqja po ia lexonte germë pér germë, boja pa iu tharë.

Kur e përmblodhi se ç'po përgatitej tē bënte i shoqi, ajo nuk duroi:

— Ti... mos u çmende?! Prandaj vërtitesh e s'të zë gjumi?

— Do tē largohem që andej, grua. Nuk do tē rri as edhe një minutë!...

\* \* \*

Kushedi se kur do t'i kishte ardhur koha asaj letre!

Shtytje e shkas që tē shkruhej që atë natë u bë ca orë më parë një bisedë në bufenë e vogël, ku nëpunësit, zakonisht në këmbë, rrëth tryezave tē ngushta, hanë mëngjes e pinë kafe.

Asafi i gjeti shokët duke përshëndoshur Leskon. Pa e zgjatur, Leskoja i njatjetoi tē tërë e nxitoi tē dilte, sepse jashtë po e priste makina ndezur.

— Çudi si na iku ky djalë! — tha Ligori.

— Këtu nuk ishte vend pér tē, — ia ktheu Nazifi. — U mërzit e pikë. Është më mirë me ekspeditat.

Ligorit iu duk e pabesueshme.

— Habitem si e lëshuan nga dora këta të drejtorisë. Punë e madhe se u mërzit!

Asafi përplasi filxhanin dhe buzëqeshi me ironi.

— Në ka njeri që është mërzitur në këtë punë, jam unë. Kam tetëmbëdhjetë vjet këtu. Po kush do t'ia dijë? Të kërkojnë punën e s'të pyesin shumë si ma ke qejfin.

Nazifi iu kthye Asafit:

— E si thua ti, shoku Safe? Pse e lanë Leskon të ikte?

Safja ngriti sytë në tavan i skandalizuar. «Si mund të jetë njeriu kaq i trashë!»

— E lanë se nuk u prishte punë, more mik. Ja shpjegimi. Se nuk vlente një grosh.

— E ke gabim, — ia priti Ligori, — e tregojnë të zotin.

— Lëre, more, ç'tregojnë. Ne po shohim, ti thua tregojnë!

Nazifi ngulte këmbë.

— Leskoja mbaroi studimet shkëlqyer!

— Hajde se po e besoj, — pranoi Asafi. — Po këtu ç'béri? Për drejtorinë tonë Leskoja ishte një kuadër që, si të ikte, si të rrinte, puna as ndreqeje as prishej.

Pastaj iu kthye Ligorit:

— Pa provo të kërkosh largimin zotrote. S'të lë njeri.

— Jo, more, — uli kokën Ligori. — Nuk është ashtu.

— Ashtu është edhe pikë! — mori flakë Asaf

Lala. — Pse nuk më lënë mua e tjetrin e tjetrin?... Kuadrin me vlerë nuk e lëshon njeri. Po të vini re, ka njerëz këtu që të sëmuren nuk ia lejojnë vetes! Se e dinë që bëjnë dëm... U duket sikur po dezertojnë.

Dy të tjerët, me takt, u munduan ta kundërshtronin, po Safja ishte i téri në flakë.

— Njerëz që nuk dinë ç'është leja e zakonshme...

— E, a derëzi, se çdo vit e kanë bërë!... Jati, pér shembull...

— E kam bërë, po si e kam bërë? Edhe kur vete ndonjëherë në kamp, ngrysem e gdhihem pranë telefonit, që të jap këtu ndonjë këshillë. Të bëj ndonjë sqarim... Se mos çalojë puna. Vetëmohimi nuk ka brirë. Se jemi të tillë, pa i kemi bërë vend vetes!

Dhe Safja nuk mbahej më.

— U mërzit Leskoja e bre-bre-bre!... Të ishte veç me dëshirë, unë do të kisha ikur i pari. E sot s'do ta pinim bashkë këtë kafe e s'do ta hapnim këtë muhabet. Hëm! Pa merr guximin t'u thuash shefave «Lëreni Safen të largohet!». Të të zënë me grushte!

— O, o, o... — ia bëri Nazifi.

— Ja kështu si të them unë! Dhe unë prandaj rri. Lënë Leskon, po mua më thonë: «Sakën se hap gojën!»

— Ke provuar ta kërkosh largimin?

— Pesë herë, — thirri Sefja, që, edhe pse gënjenjtë, iu mbushën sytë me lot të singertë.

Nazifi mblodhi supet.

— Kushedi si kanë qenë rrethanat më parë, pa tani ka kuadro plot. Nuk ka njeri të pazëvendësueshëm!

— Zëvendësohen ca si Leskoja!

— Dhe Asafët, dhe Asafët, — ia pati Nazifi pa mëshirë.

\*

\* \* \*

Ja, pas një bisede të tillë e përgatiti kërkesën Safja. Po kuptohet, nuk ishin llafet e këmbyera në bufe ato që e shtynë Asafin deri në atë pikë. Ai kishte ca inate me shefin e porsaemëruar të seksionit. Bile-bile kishte ca dufe të pazbrazura për drejtorin e përgjithshëm. Shumë rrallë e zinin në gojë Safen ata. Të thoshe se tani e tutje kishin vendosur t'u krihnin bishtërat çunakëve me pulovra e me dy xhepa prapa bythës, nuk e thoshe dot. Se në analizën vjetore ngul e shkul xha Llazon!... E bënë hero!... Po Safen, xhanëm, ku e futnin Safen? Safja rronte, e ata sikur nuk e dinin. Nëpër mbledhje nuk e kishte zakon të diskutonte... Ja, çoku hidhte ndonjë llaf nga vendi, po ato s'para ngrinin peshë. Afër mendsh, në presidiume nuk e vinin. Dhe në tabelat e nderit gjithë-gjithë e kishin nxjerrë a s'e kishin nxjerrë dy-tri herë. Po që Safja rronte, e sidomos punonte për bukuri, ata e dinin mirë. Ja, para dy

ditësh, i sollën dosjen e sektorit të Plloqës. Ia solllën atij. Nuk ia dhanë as xha Llazos e as ndonjë çunaku me pulovër e me xhepa atje prapa... Hë, e dinin sa punë kish Plloça! Ndaj dhe ai dy ditë rrreshth nuk e zuri me dorë dosjen.

Jo, jo, nuk ishte Nazifi shkaktar për bërjen e dorëzimin e kërkesës. Kjo Asafit i pati ardhur ndër mend sa herë që ndonjë nga kolegët largohej, e shokët, ashtu si për Leskon, thoshin me keqardhje: «Ishte i mirë, na prishi punë.»

Herë-herë Safes i hipte inati aq shumë, sa kishte dëshirë të shtrohej në spital, që puna të çalonte, që të kuptohej se q'ishte Safe Lala për seksionin e planit. Bile, thellë-thellë, — por ama këtë ai ia thoshte vetëm vetes, — Safes i vinte një dëshirë fëmijnore që... të vdiste. Po, po. Të vdiste, vetëm sa të dëgjonte fjalën e rastit, që me siguri do të ishte prekëse, djalli ta marrë (!) tronditëse.

Por pastaj kjo i dukej një ide e marrë. Se, po të vdiste, nuk do ta dëgjonte dot fjalimin e, po të qe në gjendje ta dëgjonte, domethënë se nuk kishte vdekur... Po pa vdekur nuk e merrnjeri mundimin të të bëjë fjalim, e kështu... Varg situatash të prapa, që nuk i pajton dot.

Kërkesën për largimin ama mund ta bënte. Që ta shihte shefin të sillej vërdallë në merak, që ta detyronte drejtorin t'i lutej për të hequr dorë, që të zienin zyrat e në bufe të mos kishte muhabet tjetër... Fundja të fillonte ca marrëdhënie të reja në një vend të ri... Asaf Lalën kudo do ta prisnin krahëhapur...

\* \* \*

Dy ditë pas dorëzimit të kërkesës, Safen e thirri drejtori i përgjithshëm.

Shoku Bektash e priti Safen në këmbë. E përqafoi dhe e ftoi të uleshin në kolltukë. Pastaj i zgjati një «Arbëria», e ndezën të dy dhe përnjë çast po pinin cigaret në heshtje.

- Si i kë nga shtëpia? — pyeti drejtori.
- Mirë, çka, — u përgjigj Safja.

Dikush e thirri Bektashin në telefon dhe biseda u ndërpren. Kur lëshoi telefonin, Bektashi erdhi e u ul edhe më afër Safes. Duke buzëqeshur, i vuri pëllëmbën mbi gju dhe i tha, me një psherëtimë të lehtë:

- Po si kështu, more Safe?!
- Ja kështu, — ia bëri Safja.

Dhe psherëtinë së bashku.

- Po na ikën, eh?

Safes sikur i ra tavani.

- Urdhëro? — pyeti Asafi i goditur.

- Po na ikën, them, eh?

- Kush?

- Ti, de... Lexova kërkesën tënde. Ma përcollën ata të kuadrit dhe, të them të drejtën, sesi më erdhi. Ja dhe Safja ka dëshirë që të largohet, të lëvizë, thashë me vete.

Safja s'po e thithë më cigaren. Hiri kishte vajtur dy gisht.

- Dhe ju... do të më lini?!

Shoku Bektash ishte një natyrë e butë, me gojë të ëmbël e llaf të matur. Safja ndjeu mbi sup pëllëmbën e tij dashamirëse.

— Nuk duam të të pengojmë... Të kemi pasur shok të mirë e punëtor.

— Dhe... do të më lini?!

Bektashi po e shikonte i topitur.

— Nuk të kuptoj, Safe.

— S'ka ndonjë zor pér ta kuptuar, shoku Bektash. Po ju pyes: ju jeni gati... si t'ju them... pa ju dridhur qerpiku do të më lini që të iki?!

Bektashi ia hodhi sytë tryezës dhe u ngrit tërësisht i hutuar.

— Po... më fal, — tha duke marrë nga tryeza letrën me shkrimin e Asafit. — A e ke bërë ti këtë kërkesë?

— Unë.

Bektashi po e ndiente veten ngushtë. Asafi shtypi me inat cigaren në tavllë dhe u ngrit në këmbë.

— Atë kërkesë e kam bërë unë. Me këto duar. Kupton, shoku Bektash? — dhe zgjaste të dyja duart me pëllëmbët lart e me të dhjetë gishtërinjtë e çakarritur.

— Jo, tani, të them të drejtën, nuk po kuptoj asgjë, — pranoi drejtori.

Safja i vajti pranë.

— Unë e humba arsyen. Kupton? U çmenda... Harrova interesat e punës... Ose nuk i harrova, xhanëm, po nuk desha t'i përfillja. Ose më keq akoma, desha t'i dëmto. Ju do të më lejoni?

— T'i dëmtosh? Jo. Në asnje mënyrë!

— Po atëherë ç'po mateni të bëni?

Bektashi buzëqeshi.

— Po ja, si thua ti? Si të veprojmë?

Safja, duke marrë zemër nga toni dashamirës i drejtorit, ia tha prerë:

— Si të veproni, gjejeni vetë! — Dhe, duke mos u ngopur me kaq, vazhdoi: — Unë, po të isha në vendin tuaj, do të thosha: «Ne, ore Safe, s'të lëmë të ikësh, sikur ta bësh dhëmbin kaq! Se të kemi kolonë! Se na ke ardhur këtu me pantallona të shkurtra. Pa të dirsur faqja. Se vezën tënde s'na e bën dot njeri!»

Bektashi nuk e përbante dot më Safen.

— Avash ti, Safe, avash!

— Ç'avash! Unë jam shumë i ofenduar!

— Po unë nuk të kuptoj tani, — ia ktheu Bektashi, që po e ruante ende gjakftohtësinë. — Ti ke apo nuk ke dëshirë të largohesh?

— Ore, po unë po vë re gatishmërinë tuaj!

Shoku Bektash u ngrys në fytyrë.

— Shiko, shoku Asaf, ne kemi shumë punëra e nuk do të merremi me lodra tani.

Toni i drejtorit të përgjithshëm ishte i prerë dhe flakët e Safes u fashiten njëherësh. Ai po e vështronte Bektashin me ca sy të përhumbur.

— E ke shkruar ti këtë kérkesë?

— Unë.

— Atëherë pse merr përsipër të na mësosh si të gjykojmë?

Safja u gëlltit.

— Jo, po...

— Ti ulerin sikur po tē pushojmë. Sikur po tē lë njeri pa bukë. Do tē ikësh që këtej, do tē shkosh në një vend tjetër. Bile ne tē kemi pasë projektuar nja dy herë tē tē lëviznim vetë që këtej.

Safja nuk po u besonte veshëve.

— Mua?!

— Po, ty!

— E... e pse nuk më keni lëvizur?

— Ku di unë... Projekte janë këto. E nuk do tē përmbyset bota. As pér ty e as pér mua... Vitet e shumta tē punës nuk janë ndonjë meritë, që ta tundim kaq lart. Ne i japim punës, ajo na jep neve... Të duam, por mos na u përkëdhel, Safe!

Dhe Bektashi mori në dorë kërkesën e, largimit e iu drejtua Safes:

— Ç'të bëjmë me këtë?

— Ku di unë.

— A do që tē ta plotësojmë?

Safja mblođhi supet e s'ia ndante sytë Bektashit.

— Apo do që tē ta quajmë sikur nuk na e ke bërë?

Safja mblođhi përsëri supet e pshëretiu:

— Kjo do tē ishte tamam zgjidhja e pjekur,  
— tha.

## *Alma rrjedh nga majmuni*

Tregim i një vajze katërvjeçare

Sot në kopsht, kur po shikonim ca revista me kafshë, edukatorja na tha një gjë që ne nuk e kishim dëgjuar më parë:

— Ne njerëzit rrjedhim nga majmuni!

Mbetëm me gojë hapur. Vështronim edukatoren.

— Po, po, fëmijë të dashur, ne rrjedhim nga majmuni...

— Edukatore, të gjithë? — pyeta unë.

— Pa përjashtim! — tha edukatorja dhe iku e na la vetëm.

Floriani dhe Brikena filluan të qanin. Pastaj filluan të qanin dhe nja dhjetë të tjerë. Ishin që të gjithë nga katër vjeç dhe që të gjithë rridhnin nga majmuni.

Erdhi edukatorja dhe mezi i pushoi.

Ne e lutëm përsëri edukatoren që të na e shpjegonte, por ajo na e preu:

— Pushoni, se ju s'merrni vesh. Është shkencore...

Ne nuk e pyetëm më, se ajo patjetër do të na bërtiste. Dhe një ditë, kur Eriona shkelë barin ku kullotnin disa lopë, edukatorja tha:

— Të dashur fëmijë, Eriona shkeli qumështin!... Se bari bëhet qumësht.

E pyetëm qysh bëhet, ajo bërtiti:

— Mbylleni gojën, se kjo është shkencore...

Po punë e madhe për barin! Mua më mbeti mendja te majmuni! Kur dola nga kopshti, s'mendoja gjë tjetër. Domethënë. dhe xhaxhi Liku, që shet kartolina ngjitur me kopshtin tonë, rridhte nga majmuni. Dhe xhaxhi Stefani, që kishte hipur mbi shkallë e rregullonte antenën, rridhte po nga majmuni.

Ia tregova gjyshes.

— Nuk e di për të tjerët, — tha gjyshja, — po fisi ynë, me ç'mbaj mend unë, jo njëherë! Majmunë nuk kemi pasur ne!

Vrapova te gjyshja tjetër, mami i mamit. Ajo u inatos:

— Majmunë nga raca jonë?! Ç'janë këto marrëzira?! Ne në fis kemi pasur vetëm njerëz të pashëm e me shëndet të plotë.

U gëzova. Sa u gëzova!

Kur erdhi babi nga puna, ia tregova gjithë historinë duke qeshur.

— S'ka gjë për të qeshur, — tha ai, — vërtet

ne rrjedhim nga majmuni, po ti s'ke njoħuri shkencore e nuk e merr vesh. Tani mē lér rehat se jam i lodħur.

Shkova te mami. Ajo po lante nē govatē.

— Do, s'do ti, — mē tha, — ne rrjedhim nga majmuni. Puna na bëri njeri, po hiqmu, se kam akoma punë! Shko fli!

Dhe mē dëboi nga banja.

U shtriva, po nuk flija dot. Dhe kur mē zuri gjumi, u zgjova shpejt. Kot që na e thanë këtë shkencoren. Tani unë nuk e dija se si ishte e vërteta: Rrjedhim apo nuk rrjedhim nga majmuni? Se ca thonë po e ca thonë jo.

Unë vendosa:

E vërteta ēshtë ashtu si thonë gjyshet. Ato janë tē vjetra e dinē mē mirë.

Pra, unë rrjedh nga gjyshet e nga gjyshërit e mi, që janë aq tē mirë e aq tē bukur.

Majmunët... Majmunët, po desħën, le tē pēl-casin nga inati!

1981

## *Mbi shilarësin e fantazisë*

Niko Xuka e ka një èndërr: një shtëpizë-muze. Dhe këtë nuk ia thotë asnjeriu. Ai gjithë e gjithë ka shkruar dy novelat. E megjithatë Niko Xuka e èndërron këtë shtëpizë të thjeshtë muze, si dhu- ratë për ata lexues që do të lindin pas njëqind vjetësh. Dhe bën gjithçka që mund të bëjë një shkrimtar për admiruesit e tij në shekujt e më- pastajmë: nuk humbet asnje vogëlsirë, as pena, as lapsa, as stilografë... Para ca kohësh mëremetoj kalin prej druri, ku qe kolovitur kur ishte fëmijë. Ia ka qejfi të krijojë ca huqe e zakone vetjake, që më vonë ndoshta do të frymëzojnë anekdotat rrëth personit të tij... Kruan kokën me gishtin e vogël e përdor me vend e pa vend fjalën «tamam». Ndërsa me të ecurën nuk është aspak i kënaqur, sepse nuk vulos dot në të veço- rinë e tij.

Atë ditë, posa mbaroi së shkruari, (me tush) një letër për hallën plakë. E mbylli në zarf dhe pa buzëqeshur e përfytyroi se ja, pikërisht këtë

letér, stérnipérit e hallés do t'ia dhuronin me ceremoni muzeut. Pale sikur tē qëllonin maktér! Do t'i kérkonin muzeut paratë e dynjasë!

Sa mbaroi së psherëtituri pér këtë veprim tē felliqur, që mund tē ndodhte, trokiti dera.

Nikoja shkoi e hapi.

— Urdhëroni!

Te porta qëndronin një vajzë dhe një djali. Qëndrimi i tyre tē linte tē kuptoje se apo ishin grindur. Bile dukej sheshit që vajza donte tē largohej. Djali e kishte zënë pér krahu.

— Më falni, — foli djali. — Ju jeni shkrimtari Niko Xuka?

— Tamam. Unë jam. Urdhëroni! — ia bëri i zoti i shtëpisë.

Të dy tē tjerët u futën brenda dhe Nikoja i udhëhoqi në studion e tij.

— Më falni, unë nuk ju njoh. — ia bëri Nikoja, duke u zgjatur cigaret.

Asnjëri nuk mori.

— Unë jam traktorist, — iu bë i njohur djaloshi. — Kjo është e fejuara ime. Ju keni shkruar një novelë pér SMT-në tonë dhe... hm... pér mua,

— Ah, po, tamam! — i ndriti fytyra tē zotit tē shtëpisë dhe mend ua zgjati cigaret pér së dyti.

— Ju jeni ai traktoristi që u futët nëpër zjarr dhe imbyllët rubinetin e cisternës që ishte në rrezik tē pëlciste?

— Po, si urdhëroni, unë ja'm.

— Tamam! Hë, si ju duk novela ime?

— E mirë ishte, shumë e mirë.  
— Tamam... Novela të tilla i pëlqejnë pubblikut. Ju qenkeni, si të thuash, heroi i novelës sime! Ja se si qenkeni!... Për aktin tuaj unë lexova në gazetë. Aty ishte shënuar me hollësi si u turrët nëpër flakë, si i shpëtuat shokët që ishin futur në kabinën aty pranë... Po, po... — dhe nuk ngopej duke e parë. — Ja se si qenkeni! Kështu ju përfytyroja... Më falni, doni nga një gotë liker, apo limonadë?

Këto i tha duke hapur deriçkën e bufesë.

— Faleminderit... Ne do të ikim. Erdhëm vetëm të sqaronim diçka.

— Ooo, pse?!... Unë jam i lumtur që ju takova. Tamam i lumtur! Bile këtë duhet ta kisha bërë përpëra, po nuk pata rastin... Më ndjeni përsëri, kjo shoqja cila është?

— Kjo është e fejuara ime.

— Ah!... Domethënë kjo është mësuesja e shkollës së mbrëmjes!

Vajza e pa djalin me ngulm. Një buzëqeshje, ku përziheshin inat dhe triumf bashkë, tendosi fytyrën e saj.

— Ja, kjo është belaja! — e la për një çast mirësjelljen djali. — Kjo është rrobaqepëse... Ju, në novelë, i kishit shënuar të gjitha saktë: emrin e fshatit ku ndodhet SMT-ja jonë, vendin, orën kur ngjau... E dinit se në ç'klasë jam në shkollën e mbrëmjes.

— Të gjitha këto ishin në gazetë, — shpjegoi Nikoja duke i zgjatur likerin,

— Vërtet, s'kishte asnjë dyshim që flitej përmua. Veçse ju thoshit se unë bëja takime dashurie me mësuesen time të shkollës së mbrëmjes! . . .

— Tamam!

— Hm! . . . — ia bëri nën zë e fejuara.

— Çfarë «tamam»?! — u nxeh djali. — Unë kam të fejuarën time! Ja këtë.

— Me ngadalë, djalosh! Nuk po ta trazon njëri të fejuarën. Unë desha t'u shmangesha shabbaloneve. Ndonjëqjetë mund t'ju shpinte në takim me një traktöriste. Por, më falni, a nuk është mjaft? A nuk na ka lardhur shpirti në majë të hundës me këto dashuritë mbi traktor? Traktoristi pararojë me traktoristën! Brigadieri pararojë me mjetësën e dalluar të viçave! Më falni, rritetës, desha të thosha! . . . Ose, po, po, do të kem dashur të them mjetësen e lopëve. . .

— Po mirë... — deshi të ndërhynte traktoristi.

— . . . Atëherë unë, (e kujt mund t'i shkonte mendja?) . . . vura në relata me mësuesen tuaj, pikërisht! . . . Një gjë që e pazakontë. A keni pyetur se sa mirë e kanë pritur këtë? Një gjë kaq origjinale! — Sipas jush, unë, që jam rrobaqepëse! . . . — foli vajza, që derinë atë çast nuk e pati hapur gojën, pa e shpënë mendimin deri në fund.

Nikoja kroi kokën me gishtin e vogël dhe pshërëtiu.

— Ju duhet të ishit mësuese, dreqi ta marrë! Phë! . . . Mëkat! Do të shkonit shumë mirë! . . .

Nikoja u dëshpërua vërtet.

— Ne dhe kështu shkojmë shumë mirë, — foli çupa.

— Po, po, — e përforcoi shoku i saj, — para se të botohej novela, shkonim për mrekulli! Pastaj, pasi u botua.

Nikoja qe zhytur në mendime dhe nuk ia vuri veshin traktoristit. Djali përfitoi nga rasti.

— U binde tani? — e pyeti të fejuarën me gjëzim.

Ajo e pa përsëri me inat, por me një inat të shuar. Dukej që ishte e kënaqur.

— Atëherë, na falni, — u ngrit djali.

Nikoja u përmend.

— Oh, ju lutem! Prisni dhe pak... Dua t'ju pyes për shumë gjëra. Ky për mua është një rast i çmuar. Më lipsen shumë përjetimet tuaja. Si u sulët nëpër flakë, drejt vdekjes.

— Unë u sula drejt cisternës.

Djali tani e ndiente veten të lehtësuar dhe kishte dëshirë që të bënte muhabet.

— Drejt cisternës, thoni? Tamam, por unë flas me figura. Drejt vdekjes! Po, po, pikërisht drejt vdekjes! Ju nuk mund ta kuptioni këtë.

Nikoja u ngrit më këmbë dhe, i ndezur, nisi të shëtiste nëpër dhomë herë me hapat e shpejtë të Dantonit dhe herë me hapat e avashë të Tolstoi plak.

— More, po a e kuption se ç'do të thotë të shikosh një perde të zjarrtë përpara, të cilën lipset ta kapërcesh?! A e dini se ç'do të thotë ta ndiesh fytyrën të përcëlluar, jo nga flakët,

jooo (!), pór nga afshi i zjarrtë, që pesë metra larg?!

Nikos i shkreptinin sytë.

— Unë u shpreha tamam, drejt vdekjes! Ju ndofta s'mund ta kuptoni se ç'do tē thotë tē dëgjosh shokët e izoluar në kabinë, tē cilët bërtasin nga tmerri, pasi benzina éshtë grumbulluar para derës së tyre duke u zënë fryshtë me... me avujt e saj.

— Më falni, — ndërhyri djaloshi pa e prishur gjakun, — asnjeri nuk bërtiste. Ata donin tē çanin kabinën nga ana tjetër. Disa mundoheshin, ta shuanin zjarrin që brenda, po kjo qe e pamundur, nafta rridhte nga rubineti i cisternës. Duhej mbyllur rubineti. Ja, kaq. Asnjeri nuk bërtiste.

— Ata bërtitnin, cirreshin, këlthitnin! Pikë! Pra, si tē mos them «drejt vdekjes»? Pas gjithë këtyre rrëthanave, në vesh njériut i ushton vetëm këmbanë shpëtimtare: «Rubineti! Rubineti!» Dhe atëherë koka futet në supe, mbyllen sytë dhe...

Nikoja bërtiti me tē gjithë fuqinë:

— Përpara!

Pastaj befas uikthye nga heroi i tij dhe i foli ngadalë:

— Po pastaj, c'ngjau? Si e mbylli t rubinetin? Vazhdoni!

— Pastaj... — nisi qetë njériu që kishte mbyllur rubinetin.

— Jua them me sinqeritet, — nuk e laqtë

vazhdonte Nikoja, duke i rënë miqësishët në shpatulla me një gëzim prej fëmije, — unë e quajfat ardhjen tuaj. Përshtypjet tuaja nga ajo vepër heroike janë një pasuri e vërtetë.

Djalit iu bë qejfi dhe, megjithëse e dinte që më vonë e fejuara do ta tallte, u kapardis pak si hero.

— Po ja...

— Vazhdoni! — i dha zemër shkrimtari. — Nëpër rrugën e zjarrtë a nuk të vjen ndër mend e gjithë fëmijëria? Gëzimet që lëmë pas? Nëna që rri pa gjumë? E fejuara, ja kjo shoqja mësuese, teksa e përfytyron të kërrusur përmbi detyrat që kanë bërë me shkrim nxënësit e mbrëmjes?

— Unë jam rrobaqepëse! — e kujtoi vajza.

— Ah, po. Pra, a nuk ju duket se fati i gjithë shokëve dhe i makinave varej në dorën tuaj?

— Në dorën time?! Të gjithë po luftonin...

— A nuk e ndjeve, — vazhdoi shkrimtari, — se si të vinin nëpër mend lodrat e vegjëlisë, shokët, mësuesit...

— Uh! — i shpëtoi rrobaqepëses së bezdisur ngaqë Nikoja nuk e donte veçse mësuese.

— Rrobaqepësit... — nxitoi Nikoja përt ta kënaqur vajzën, — këngët e djepit...

— Asgjë nuk më erdhi ndër mend atëherë.

— Si është e mundur?! — u hakërrua Nikoja.

— Hej, djalosh, ta dish sa e ngatërruar është ajo grimcë kohë kur ndodhesh nëpër flakë! I tërë trupi digjet si një pishtar i gjallë, shëtitës.

Djali pa sytë e të zotit të shtëpisë që u ndezën përsëri dhe e la të fliste.

— ... Një pishtar i gjallë, i gatuar me lëndë njerëzore. Ai vjen nga gjiri i jetës dhe hyn në një portë të errët, të panjohur, duke lënë prapa fytyrat të dashura. Dhe nuk dihet a do t'i takojë përsëri. A do të kthehet më vallë që andej?

— Do të kthehet se s'bën! — tha me siguri djaloshi.

Por pastaj u kollit. E ndjeu që e kishte zemëruar Nikon. E vuri re se si po e shikonte ai i pakënaqur. Bile diç po matej t'i thoshte. Diçka të rëndë. Diçka fyeze, ndofta.

Dhe ia tha vërtet:

— Përshtypjet tuaja, djalosh, nuk kanë jetë. Jetë të gjallë...

Djalit i erdhi turp dhe uli kokën. Ra një heshtje, po Nikoja e prishi prapë atë:

— Arritët te rubineti që duhej mbyllur. Vazhdoni!

— Po ja, — nisi i druajtur tanimë mysafiri, — rubineti ishte i nxehur, në mos gabohem...

— Nuk gaboheni, — e ndihmoi Nikoja.

— Se edhe harrohen gjërat, — u shfajësua djali.

— Harroni ju, po ne ç'bëjmë? — ia kujtoi shkrimtari, që e dintë përmendsh novelën e tij.

— Rubineti mezi mbyllët. Lëngu vdekjeprurës vazhdon të rrjedhë. Cisterna e nxehur mund të pëlcasë nga çasti në çast. Shokët bërtasin.

— Jo, nuk bërtasin! — për këtë traktoristi nuk lëshonte pe.

— Bërtasin, bërtasin!

— Jo, de! — u bëlli pasjellshëm djali.

— Bërtasin!

— Jo!

Nikos i hipën xhindet.

— Atëherë ata shokët e tü nuk e njohin jetën! Ja kështu!

Xhindet i hipën dhe traktoristit.

— C' thua, more! Si nuk e njohkan jetën ata?!

E fejuara, e cila po e shikonte me kënaqësi përjetimin e Nikos, ndërhyri menjëherë:

— Mos kundërshto, Baçi, na lër ta dëgjojmë. Mua po më ngjethet mishi.

Ai që kishte luftuar me flakët pushoi së kundërshtuari. Nuk kishte ndodhur ashtu si thoshte shkrimtari, por, meqë asaj i pëlgente...

— Na e vazhdo më tej, shoku Niko!

Nikoja nuk priti që ta lutnin më. Ai tani ishte në mes të flakëve.

— Shokët bërtasin. Gjuhët e egra të zjarrit të lëpijnë fytyrën, duart, gjoksin... Dhe ti ecën me këmbëngulje. Pastaj, pasi mbyllët rrjedha e benzinës...

— Traktorët punojnë me naftë, — i pëshpëriti në vesh së fejuarës traktoristi,

Por ajo ia mbylli gojën me pëllëmbën e saj të vogël dhe nuk ia ndau sytë shkrimtarit.

— Atë që mbetet, e merrni me mend vetë,

— vazhdoi Nikoja. — Benzina shuhet... Shokët shpëtojnë... Fitore!... Asnjë nuk flet. Diku ako-

ma dalin ca avuj... Më tej mjekohen ca Iplagë, pa zhurmë, pa ahe e pa rohe... — Paska qenë e tmerrshme vërtet! — tha vajza.

Shkrimtari ndezi një cigare. E ndiente veten shumë të lodhur.

— Jeta, jeta... — tha ai pa e zgjatur më tej.

Plakosi një heshtje që djali nuk i guxonte ta prishte. Boll kishte prishur punë deri tani. Ama, atë që e mundonte, e pati zgjidhur paq. E fejuara tani s'do ta mundonte më.

— E po na falni, — tha më në fund, duke vendosur të ngrihej.

U ngrit dhe vajza.

— Ju falënderoj për vizitën, — ia bëri i zoti i shtëpisë, duke u ngritur dhe ai. Kur i dha dorën vajzës, u ndal ca më shumë. — Na ndjeni, shoqja arsimtare, se ju lamë pak mënjanë. Po juve, si ju venë punët në shkollën e mbrëmjes? Mbahuni e rreptë me këta! Dhe notat, kur t'i vini...

— Uh! — ia bëri çupa me mllef, ngaqë s'po arrinte dot t'ia hiqte shkrimtarit ngulitjen e vjetër.

Shkrimtari mbeti dhe pa me habi nga djali.

— Kjo nuk është në vete! — e qetësoi traktori. — Kjo kujton se është rrobaqepëse!

Dhe me kënaqësi ia nxori inatin së fejuarës:

— Je mësuese, moj! As mos e diskuto!

Pasi i përcolli, Nikoja ndiente një shije të hidhur në gojë.

— I kemi të thjeshtë njerëzit, — tha më vete.  
— Por jo aq të edukuar. Unë shkrova një goxha tregim për një njeri që hidhet në mes të flakëve, ata nuk morën mundimin as të më thonë të lumtë! Phë!

Por i harroi shpejt. U ul në kanape dhe mendja i fluturoi te slexuesit e dhjetëvjeçarëve të ardhshëm. I fluturoi te shtëpiza-muzë.

1983-1986

## *Futboll, futboll*

Rrugët, bulevardet e parqet zhuzhurijnë: Futboll! Nëpër urbanë, nga e diela deri të shtunën shtyhesh majtas e djathtas e dëgjon: Futboll! Futboll! Në kafenera bëhet klasifikimi, në restorante mënytë shkaraviten me parashikimin e javës që vjen dhe klientët i lexojnë të përziera: Komposto pjeshke, «Besa»-«Tomori», Rragu me patate, «Traktori»-«Vllaznia».

Në lulishten e lagjes sonë, tërhequr në errësirë, një çift i ri më shumë bisedon për të dielën e ndeshjes se për të dielën e dasmës. Te dyqani i bulmetit kritikohen trajnerët; te zarzavatet gjyqtarët. Në repartin e riparimit këpucari godet me çekiç dhe e ka me federatën.

Përgjatë shëtitores fjalët përhapen anash, dhe avullojnë lart. Në ajër, drejt stratosferës, ngjitet zhurma e qytetit. Shkrihen të tëra, bori vetrash dhe copëra fjalësh:

— Uuuu! Ty-të-të! Ofsajt, ke një biletë, kategoria dytyty mirëmbëmajaci, flamurtari, tribu-

na-cë-kovaçi, tytytytka, butragenjofsajt, labinotin  
gemforest panotoleragami, shpirti im, engjëll  
ahmetshqarri!...

Unë nxitoj te berberët. Ka vdekur një i njo-  
huri i babait tim, xha Toli, 96 vjeç. Do ta gdhij  
aty, për nder të të vdekurit. Duhet të rruhem...

Në rrojtore bëhet bisedë e madhe. Flitet për  
rangje të larta: Kush do të dalë kampion? Ber-  
berët me brisqe përveshur: ballë për ballë! Bi-  
sedave u japid zjarr klientë me faqe me shkumë.  
«Partizani»! «Flamurtari»! «Partizani»! «Flamur-  
tari»!

Kur ulem në kolltuk, më kot mundohem ta  
shoh veten në pasqyrë. Ajo është e mbuluar me  
fotografi: «Flamurtari» në Barcelonë! Ferko-port-  
ret! Vasil Ruci-portret!... Vetëm portreti im  
nuk gjen vend ku të pasqyrohet. Lëviz majtas,  
dukem Zijai! Lëviz djathas, Bubeqi!

Berberi im është gjaknxehtë. Ai më shkumos  
gjithë nerva, mjekër, sy, veshë e mustaqe dhe  
thotë se skuadër si Vlora, ta themi hapur, as që  
ka pasur dhe as që do të ketë, pavarësisht nga  
shansi dhe padrejtësitë e arbitrave!

Pastaj ai kujtohet për mua. Më zë hundën me  
dy gishta si pincë, më zbulon sytë, që m'i ka  
plakosur me shkumë, dhe më pyet:

- Ty, or byrazer, të pëlqen sporti?
- Po,-i them, — volejbolli.
- Shih! Volejbolli!!! Sporti, o, sporti! Sport  
vetëm futbolli është!

— Po, — i them me hundën që po ma këput pinca.

— Me kë je? — Dhe ma vë briskun në fyt.

— Me «Flamurtarin», — nxitoj të them unë. Dhe nxitoj, se kam frikë mos vete pas xha Tolit...

E pabesueshme, por edhe te xha Toli rri në ajër makthi i futbollit. Tema e të uruarit futboll vërtitet, vërtitet dhe ulet pa turp, këmbëkryq, mu përpara Qakos, birit të të ndjerit. Dhe nis si me marifet, aty nga mesi i natës, pasi ka heshtur lumi i vizitave.

«Ama ju la si mos më mirë. Iku plaku, buzgaz, 96 vjeç. Të rrojmë të gjithë sa ai!... E pashë, kur ishte hë, para një javë! E pashë xha Tolin, mbahej mirë, more! Kujt i shkonte mendja! Ku po shkon, o xha Toli, e pyes... Ja, po vete të marr teknikun e televizorit, më lëviz herë përpjetë, herë tatëpjetë... Është ajo ndeshja, tha»...

— Plak, plak, po ish qejfli futbolli xha Toli i shkretë!

Opa! Filloi, filloi, filloi.

— Ama «Apolonia» sivjet na bëri të vuajmë ca, — nis njëri.

— Shiko, — hidhet një tjetër, — ne, po u rreshtuam kështu në mbrojtje...

— Nuk ka lezet, — i them njërit aty pranë.

— Qakoja e ka baba... S'vete topi këtu!

— Vete, vete, — më pëshpërit ai. — I bën mirë.  
I humbasim mendjen. Në këso rastesh bën mirë.

Dhe vërsulen të gjithë që t'i humbin mendjen Qakos.

Në orën dy pas mesnate flitet për penalltitë e padrejta.

Ora tre: Përshtypjet e ndeshjeve. Pas kësaj së diele ndeshjet shtyhen. Jo, nuk shtyhen. Shtyhen, shtyhen, mos e diskutoni!

Këtu, i gjori Qako, që deri tani rrinte kokëvarur, i jep fund sherrit:

— Do shtyhen. Kështu po thoshin ata të zyrës së funeraleve. — Dhe pshérëtin. Për të atin, apo për shtyrjen e kampionatit, hajde merre vesh!...  
Vec, ama, mendja i humbi dhe qëllimit iu arrit.

Në orën katër hapet dera dhe hyn xha Toli vetë, i vdekuri. Ka ikur për disa çaste nga dhoma e grave dhe vjen të pyesë nga meraku.

— Djema, dini gjë kush na vjen arbitër këtë të diel?

Çapëloj sytë. E kam nga lodhja. I vdekuri nuk ka lëvizur hiç. Vazhdon të rrije shtrirë aty në mes të grave.

Këtu biseda vazhdon.

Dua të flas, por druhem. Mos ma bëjnë edhe këta si ata djemtë e rinj një javë më parë, kur i gjeta ulur buzë trotuarit, ndërsa ziheshin e grijeshin me zë të lartë për kartelat e verdha.

Atë mbrëmje u hyra në mes dhe i telendisa. «Po ç'bëni, more! Nuk dini të bëni tjetër punë? Po shkoni, more, në një film, në një teatër. Dilni,

more, një ekskursion përgjatë lumit. Mo po luani vetë ndeshje, se ju bëjnë mirë për trurin. Po lexoni, more, një libër!... se nuk dini veç të ndiqni skuadrën e futbollit...»

Në fillim u hutuan, pastaj u shkulën së qeshuri e ma vunë bat-bat: «Yyyy! Prapaniku! Ky qenka prapa botës! I mykuri! Trrr!...»

Shpejtova të largohesha se më vunë teneqenë! Ikja me nxitim e nëpër veshë më fshikullo-nin:

«Yyyy! Dypikëkategokushtari, mardonjaksi, tribunabëvllazmijani, stopshtugol!...»

# *Endje në për arat e të tjerëve*

*Një tufë skica parodike*

Duhet ta keni dëgjuar një rrëfenjë të vjetër popullore për atë Qerosin që kulloste dhentë e agait e agai s'i jepte hakun, s'i jepte bukën.

Qerosi, nga inati, u preu bishtat dhenve e i ndoqi bagëtitë e gjora të iknin ku t'i shpinin këmbët. Bishtat i nguli në një llucë dhe erdhi e i tha të zotit: «Dhentë m'u fundosën në baltë!»

Rendi agai që t'i nxirrte vetë. Zër bishtat, bishtat në dorë.

«Bobo, thërriste agai, m'i përpiu toka!...» Qerosi queshte e fërkonte barkun, se hakun e kishte marrë paq...

Ca me stilin e ca me fjalorin, ja se si mund ta shkruanin këtë rrëfenjë disa emra të mirë-

njohur të letërsisë sonë. **K**është një lloj parodizmi, frys i leximeve të shpeshta dhe të vëmendshme të veprës së tyre, për të cilën kam sidomos shumë dashuri. Kjo ma bën më të shpenguar shakanë dhe teprimin...

### GJON BUZUKU

E ndëh vjetët e shkuomë, Qerosi pat shërbymë endënji zotëni fort të fështirë, me të cillë nukë qëllonjinë endënji gluhe tok.

Tue mos u paguomë, Qerosi u duoh t'ja presenjë enbishtat dhënëve e tua ngulënje ndë balte.

Erdh Qerosi tu zotënia ensëh shkulmi të flokëve, tue thanë:

— Ensëh dashunit t'kullotunit, dhentë u mbëjutënë. E tash u jam enfalëh, zotëni!

Ky i fuondmi, me një të madhe fëdigë, dha pallmënë:

— Qeros, u të përes gluhenë!

Po Qerosi hakunë ia mori, ensah thuhetë, gluhenë ia nxori...

## FAN NOLI

### Introduktë

Këndonjësi duhet të njohë fort mirë këtë histori të lezeçme, që na vjen nga thellësitë medievale.

Tamam këtë përrallë të ilirëve, sikundër besohet, na e merr dhe e përshkruan Shekspiri i famshëm, siç ka bërë ay në plot raste të tjera. Por dramatisti anglez e shtoi, e ujdisi dhe, pa na thënë asgjë të dreqpërdreqtë, na e lë ta heqim vetë konkluzjen.

Dyke e gjetur në një inglishtë të vjetër, m'u desh njëherë ta shqipëronj, pastaj ta lëmonj, që t'i jap formën e fundme.

Nuk m'u ndenj pa e shqipëruar, pasi Qerosi raprezenton personifikatën e individit inoçent e naiv, por dyke pasur një attitudë të avancuar kundër zengjinit sfruttator, rezil e katil, e bën më të konceptuar për këndonjësin kontemporan.

### Shqipëronjësi

#### AKTI 1, SKENA 1

*Natë. Një fushë me baltë.*

*(Hyjnë Qerosi, ca ushtarë me hap ushtarak e trumbeta dhe ca barinj me fyej.)*

QEROSI

Zot, nëm një fyell.

BARIU

Urdhéro, zot!

QEROSI

Zot, një kope, vallë, a e pé?

BARIU

Pérpara e ke, zot,

Një çap të bësh dhe e ke arritur.

A s'ia dëgjon këmborët? (Del)

QEROSI (Vetëm.)

Kopeja qenka afër.

Jorgani i natës do të ma mbulonjë

punën e tmerruar.

Në e vënçë dot pérpara tërë kopenë,

e shtynj drejt baltës që pérpin.

Pastaj thikën nxjerr dhe bishtat ua pres

e i ngul në llom me majat drejt përpjetë.  
Pastaj delet bishteunge i vërvis nga

të hanë e të majmen ca dhe fukarenjtë.  
Aga i lartë, që s'më dhe paratë,  
të tëra do i paguaç këtë natë! (Del duke  
vrapuar.)

*Natë. Sarajet e agait.*

(*Hyjnë Qerosi, pasojës e shërbëtorë.*)

NJË SHËRBËTOR

Kush është atje?

QEROSI

Ca miq të kësaj toke.)

SHËRBËTORI

Mos je Qerosi?

QEROSI

Një copë e tij.

(*Hyn agai.*)

AGAI

Qeros i mirë! Bir! Qëndro e shfaqu!

QEROSI

Imzot i lartë,

S'guxoj të të shoh në sy!

Oh, ç'gjëmë e madhe që ná gjeti!

Oh, se ç'kope e madhe u përmbyt ná llucë!

E cila na përpin me brucë dhe këpucë...

AGAI (Që përposh.)

Oh, ç'vepër e tmerruar!

QEROSI

E di.

Rrëmbemëni e vërvitmëni ná shqotë

e me kamxhik bëmani lëkurën copë.

Përvëlomëni ná përronj me valë prushi.

Kopeja llomin fytafyt e mbushi...

AGAI

Allallah, o rezil e katil, allallah!

(*Hyjnë me rrëmbim zonja, zotërinj, naftër e ca pasonjës.*)

TË GJITHË (Në kor.)

Allallah, allallah!

Shtroni hithër e shtog turfanda!

QEROSI (Mënjanë.)

Lehni, laro, kaba,

buzët vesh më vesh me bakllava!

(*Me të madhe sokëllimë.*)

Të tillë tragjedi s'ka parëjeta,

si kjo që panë delet këmbëlehta!

(*Fyej dhe trumbeta.*)

## SHEVQET MUSARAJ

Ne dhënve u themi cangadhe e do më duheshin dy a tri net të mira dimri që t'ua dëftoja tërë këtë histori.

Vitin s'e mba mënd mirë, po kjo ka ndodhur këtehëna në Mesaplik. Cangadhet ishën të Teme agait, që desh i ra pika kur i vate haberi.

U sul në mes të baltës të shpëton cangadhet që po mbyteshin. Zur bishtat, shkul e këpüt, Lumi që mori qylët! Shkul ai e shkul Hanko Zonja, Hic! Qerosi rrij e bën sehir, e vur dhjamë. Mato Labi, që çeku shkruante që atëherë, e vuri në bejte:

*Teme agait/ S'i ndrit më nuri/ Ka varur buzët/  
Si strehë ahuri./ Dhe Hanko Zonjës/ Aq sa kish  
hije/ I nxin sot balli/ Si fund kusie/ Pa flet e  
çirret/ Thérret, bërtet/ Èsht'mbushur tërë/ Nervo-  
zitet./ Guxon garbuti/ Që të na i mbytë!/ Si nuk  
ka frikë/ I plaçin sytë!/- Lena, moj grua/ Për  
kokën tënde!/ Ai i mbyti/ Ti na shet mënde!.../*

## DRITERO AGOLLI

Kjo histori ka ndodhur vërtet, po ka ndodhur në Devoll. Kronikat le të thonë ç'të duan, po

derisa flitet për baltë, kjo s'lë më dyshim: Baltë ka vetëm Devoll!

Ish në të hyrë të vjeshtës. Korriku i kish pirë lumenjtë po ata u mbushën përsëri e tani pëlciste kungulli nga vetekënaqësia.

Pasi ua preu bishtat me kosorë, Qerosi i vuri shqerrkat përparrë e mori tatëpjetë Devollë.

Kapërceu Qerosi ara, lëmenj, ugare, mullarë, kreshta, gërxhe, plisa, shtigje, sallishte e selishte... Piu duhan me okë, hëngri mollçina dhe eci këshitu dyzet ditë nëpër Devoll.

Pastaj u kthyte i vetëm. I nguli bishtat thellë në baltën e murrme e vajti tek agai qimekashtë.

Kur e pa duke ngrënë, i zjeu gjaku në damarë. I ra me grusht sofrës, sa hodhi përpjetë raki e lugë e i tha agait:

— Tu mbytë shqerrkat, o derr pe derri...

### ISMAIL KADAREJA

Diçka po ndodhë...

Ishte diçka e llahtarshme, diçka në mes të reales e të ireales, diçka aty në kufijtë e legjendës...

Kronikani Evlia Çelebiu e shënon këtë në kronikat e tij në vitin hixhra një mijë e njëqind e dy.

Binte një shi i vjetër...

Në llucën e madhe, këtej Urës me tri Harqe, aty ku kish pasur barakën shoqëria «Lundra e trape», ishin parë mizëri me bishta delesh që dilnin nga balta.

Dikush tha që balta rridhte qumëشت. Dikush tha që qumëشت kishte baltë. Disa thanë që ishte parë Qerosi me thikë në dorë. Disa thanë që ishte parë një thikë që kish në fund të dorezës një Qeros.

**T**hashethemnajë...

Thashetheme tē shumta, që fluturonin mbi kurrise kuajsh, drejt qendrës së perandorisë...

## *Ulja e hundës*

Xhaxhai e pleksi kaq shtruar muhabetin me një bashkëmoshatarin e vet, sa unë u hoqa mënjanë e nisa të lexoja, njërën pas tjetrës, faqet e një libri që kisha marrë me vete.

Në një stacion, treni u ndal dhe në të ndarën tonë na u fut një tip i pispillosur... ç'të të them! Gjatë gjithë rrugës me të, nuk arritëm të kptonim se ç'djall parfum kish hedhur! Ishin ca aroma të rënda që përziheshin pa lezet e të kri-jonin një ndjenjë bezdie.

Tipi u ul menjëherë. Nxori nga çanta një peshqir të trashë, fshiu ndenjësen, mbështetësen, krahësen e shkundi, e palosi, e futi në çantë dhe pastaj çantën e ngjiti në skarën e sipërme. Më pas ngriti pantallonat, duke i zënë me kujdes te gjunjët dhe u ul.

Të gjitha këto i bëri pa u ngutur e pa u bez-disur nga vështrimet tona të vëmendshme.

Qëlloi të ulej pranë xhaxhait dhe tymi i duhanit të tij e bëri të mblidhte hundët.

Kjo nuk i pëlqeu xhaxhait. Unë e kuptova. Që aty xhaxhai filloi të tregonte ca historira me një fjalor pa fre, matanë e më këtë anë kufirit të sjelljes së mirë. Kjo e bënte xha Jorgon të qeshte, kurse të porsaardhurin të bezdisej gjithnjë e më shumë.

Mua xhaxhai po më habiste.

Në stacionin tjetër nuk duroi më. Mori çantën e u transferua në një të ndarë tjetër, ku filloi të fshinte përsëri vendin ku do të ulej.

— Xhaxha, e teprove! — i têrhoqa vërejtjen unë. — E kripe mirë gojën.

— Ja, m'u prish gjiza!

— Turp!...

— Turp unë, apo ai që na qelbi?... Më kishte hedhur një okë livando e pastaj më mblidhë hu-ndët nga duhani im, që është livando mbi tërë, livandot!

— Thua ti!

E nisëm të ziheshim me xhaxhanë, që bënte e ç'bënte e thërriste krah xha Jorgon. Xha Jorgo-ja ia vuri krahun.

— Nganjëherë, more bir, — nisi ai, — më mirë se fjala e përdhosur nuk bën asnjerë. E bukur s'është, nuk të nderon, po asnje tjetër në vend të saj nuk shkon. Kjo sot nuk qe gjë. Ja ç'na ndodhi njëherë...

Këtu e tre vjet të shkuar isha shtruar në spital. Ishim katër veta në dhomë, por e kalonim aq mirë, sa ai gaz, ato shaka e ajo shoqëri na bënин t'i harronim sëmundjet që na kishin sjellë aty. Në dhomën tonë mjekët qëndronin më gjatë. Clodheshin. Qeshnin. Shkëmbenin plot qysyre e thumba.

Ama kishim aty një djalë nja njëzet-njëzete-gjashtë vjeç, Remzi e quanin. Kullonte më këmbë për ne të moshuarit, daç për mua, daç për atë tjetrin. Tafil, Tafil i thoshin atij. Na bënte shërbim kur kishim ndonjë hall e donim të thërritnim infermieret.

Ky Remziu i pati thënë sëmundjes plaç! Tërë ditën e tërë natën buza në gaz i rrinte, i punonte mendja lloj-lloj rrengjesh. Për shkak të tij e të gjallërisë që mbante ai, dhoma jonë ishte kryedhma e pavijonit. Bëj hesap, kur na doli një shok e krevati mbeti bosh, shumë veta bënë përqapje të vendoseshin aty. Po nuk u ndezi.

Atë krevat ishte shkuar që ta zinte Nesti.

Nesti u shtrua dhe na erdhi aty një të shtunë drekëherë.

Më parë se të vinte Nesti, erdhë pararoja. Dy sanitare sollën e na i zunë komodinat me nja dy vandakë libra. Ca libra të trashë e të pazakonshëm. Në shqip e në gjuhë të huaja.

Pastaj hyri infermierja, ishte një goxha vajzë,

që téré ditën kukuriste. Ajo pa librat e tundi kohën duke mbledhur buzët.

— Urdhëroni, — i tha atij që vinte prapa.

Ne, shtrirë nëpër krevate, sytë nga dera! Prisnim shokun e ri.

Nesti hyri. Me pizhame. Iu afroakrevatit, duke e parë dhomën tonë me një symatje të rëndë. Vuri re muret, Tafilin, abazhurët, kavanozat, Remziun, kaloriferët, jastëkët dhe mua. Të téré ishim njësoj pér të. As na përshëndeti fare. Fare, fare, fare!

Me dy gishta të hollë ngriti kuvertën e pa me mosbesim çarçafët. Pastaj ngriti cepat e dyshekëve dhe nuhati erën e dhomës. Tri herë.

Ne e ndiqnim me sy. Pa folur.

Ai provoi butësinë e jastëkut dhe ishkundi krevatin prej hekuri pér të parë mos bënte gërvër. Pastaj u fut nën mbulesat dhe i rregulloi ato rrëth e përqark shalëve. Vetëm pasi i bëri këto, vuri re që ata tre kërcunj, që e ndiqnin me sy, ishim ne. Njerëz. Shokë të dhomës.

— Të merremi vesh, — na tha të trëve, duke ngritur gishtin përpjetë, — unë këtu dua qetësi! Dritën do ta mbaj ndezur. Sa të dua!

Ne nuk flisnim. Mmm — kyçur! Vetëtimthi shkëmbyem nga një vështrim e aq.

— Dhe të mos kemi llafe, — vazhdoi Nesti, — unë nuk do të lejoj që këtu të hyjë e të dalë qeni i kallajxhiut, siç më kanë thënë! S'ka më! S'ka më ha-ha-ha e hu-hu-hu!

Pikë e zezë! As shëndet e as plac s'na tha,

por ierdhi e na vuri ligjet. Na pati qenë dukur, vetja si në shtëpi pushimi e na u bë prapë spitali spital.

E ky Nesti, more vellezër, na kishte qenë një grindavec që shokun nuk ia gjeje. Në tërë spitalin jo e jo, por as në tërë qytetin! Pleksej me mjekët për sëmundjen e tij, qortonte infermieret e sanitaret, kthente nga tri herë gjellën dhe një ditë kérkoi drejtorin e spitalit se ja kishin shkruar me gabime ortografike emrin në kartelën e temperaturës.

Pastaj fillonte e studionte.

— Ne lëviznim në majë të gishtërinjve. Remziu e pati qepur gojën e dukëj si i shushatur. Sikur e kishin qëlluar në kokë me vare. Kur kishte radioja muzikë që i pëlqente atij, s'duhej të bëje gëk! Po të kishim në atë kohë për të bërë ndonjë gjilpërë nga ato që përvëlojnë, duhej të kafshnim jastëkun, se Nesti nuk ta përtonte.

— O mos bëj gëk, o mos bëj gjilpërën, se këto që jepen në radio, janë vepra të pavdekshme.

Por edhe gëk të mos bëje, nuk të linte rehat. Bëri një ditë Remziu një gjilpërë dhe, sa u dëgjuat ju që nuk ishit atje, aq u dëgjuai ai. Kur doli infermierja, djali po fërkonte vendin.

— Është banale kjo që bën ti! — i tha' Nesti Remziut. — Pse e fërkon ashtu? Pak më tepër respekt.

— Më dhemb, — ia sktheu tjetri butë-butë, — Kur më dhemin tulet, unë s'do të fërkoj jastëkun.

— Banale! Banale! — turfulloi Nesti dhe doli nga dhoma.

— Pthu! — e pështyu Remziu gjithë vrer. — Ky për vete sikur s'ka prapanicë fare! Ç'na gjeti ne mëskëtë!

Dy-tri herë në ditë ai dilte në korridor e fliste në telefonin e pavijonit, që e kishim mu pranë derës sonë. Fliste me zë të lartë. Fliste frëngjisht.

Ne shokët e tij të dhomës si s'na pyeti një herë për emrat! Jo e jo! Kur i duhej të merrte e të jepte me ne, Remziut i thoshte «ti, çuni!», mua «ti, shoku i dritares», e Tafilit «ti, i murit».

E ç'ta zgjat. Po ju them se ca si ky Nesti nuk durohen. Se ç'të pështillet një lëmsh këtu në lukth e të vjen, me nder, të vjellësh.

— Mor po cilin francez ka në Francë ky?  
— pyeti një ditë Tafili, kur Nesti vërvëriste në telefon.

— C'Francë? Këtu, or, këtu! — i thamë. — Brenda për brenda. Flet më shokët e tij.

— Ka shumë suva! — shfryu Tafili. — Nuk durohet!

— Na zeherosi, — shfryva unë.  
Remziu po mendohej. Plasi.

— Njeri i fryrë, — tha. — Unë do ta shfryj. Ç'na bën ky shejtan djalë? Se cilin porositi dhe të na i sjellin nga shtëpia një reçel nga një lloj trëndafili që nuk ia di emrin. Këtë reçel Remziut ia përgatiste gjyshja. Mjeke popullore kjo. Reçeli nuk na qenkej hiç i dëmshëm, veç, pasi ta haje, pas një ore të shpëlante barku. Për atë punë qe bërë.

Një mëngjes, kur Nesti po fliste në telefon,  
— avazin ai, frëngjisht, — na erdhi ushqimi. Nesti  
nuk e kishte mbaruar akoma muhabetin, unë e  
Tafili hëngrëm e dolëm të bënim shëtitje.

Pas nja dhjetë minutash na vjen Remziu.

— I këmbeva reçelin, — na tha. — I hoqa atë  
të spitalit e i vura atë të gjyshes.

Ne mbetëm. Sesi na erdhi.

— E hëngri?

— Të gjithë, — tha Remziu dhe mëzi mbante  
të qeshurën.

— Nuk bëre mirë, — i thamë. — Nuk na dë-  
gjove.

Po ç'është e vërteta edhe ne nuk kishim ngu-  
lur këmbë t'ia hiqnim nga mendja këtë shejtan-  
llék. Besa, ne nuk do ta bënim vetë, po zëre se  
e bëmë.

— Ta shikoni pas një ore, — kënaqej Remziu  
akoma pa ndodhur hataja.

— E po fundja çfarë do të arrish? — i them.  
— Ja e hëngri. Ja dhe do ta ngasë barku. Do të  
zërë banjën dhe...

— Ç'banjë! — tha malukati. — Pas një ore, si  
me sustë, të tëra banjat do të jenë të zëna nga  
shokët e mi. Ai që bën poçen, bën edhe vegjën!

Pas një ore Nesti doli. Kaloi rëndë-rëndë para  
nesh, tepër serioz dhe, sikur të ishte kujtar atë  
çast, u kthyë nga banjat. Iu drejtua së parës.  
Zënë. Së dytës. Zënë. Iu vërsul së tretës, së ka-  
trës... Ca çunakë, me mendjen si të Remziut,

u përgjigjeshin që nga brenda trokitjeve me nga një kollë të shtirur.

Mua m'u dhimbë atëherë kur ishte vonë. Nesti i gjorë vuante. Për të qarë hallin! Po, matej të shkonte te pavijoni tjetër, po llogaria e çapeve nuk i dilte.

Ajo që priste Remziu, ngjau para dyerve të zëna, Nesti u mbush.

I pari i vajti Remziu.

— Ç'pate, shoku Nesti? — e pyeti tërë merak.

Në atë kohë të katër banjat u liruan njëherësh dhe shokët e Remziut e rrëthuan Nestin e varfër, që s'po hidhët dot një hap.

— Të thérresim sanitaret! — dha mendje njëri prej tyre.

— Jo, jo, — ia bëri i trembur Nesti, — asnjeri.

— Largohuni! — u tha Remziu shokëve. — Do ta ndihmoj vetë.

E kullandrisi njëfarësoj dhe e shoqëroi për në dhomë. Por amas'mbeti i madh e i vogël pa e parë. E shikonin, kënaqeshin, po nuk i binin në sy. Nesti nuk e dinte se shejtanllëkun e kishin marrë vesh të gjithë, prandaj nuk deshi ta jepte veten. Ekte krah për krah me Remziun e ndalej duke biseduar gjoja për shkencën, për hënën e për yjet.

Sapo e solli Remziu në dhomë, ne u ngritëm, dhe nişem ta ndihmonim.

Mbeti njeri pa na ardhur në dhomë atë ditë? Asnjë. Të gjithë bënин q'bënин dhe hynin. Njëri kërkonte shahun, njëri një brisk, njëri një li-

bër. Dhe pastaj ngushëllonin shokun tonë. I thoshin se jemi njerëz e mund të na ndodhë...

Nestit djersët vuuu...

Dhe hilen ia thanë, më duket. E kuptoi, se dhenjë nga mjekët bërtiti shumë e deshi që ta bënte problem. Po Nesti nuk e zuri në gojë hic.

Kishte qenë ilaç më i saktë. Aty për aty kritika nuk e ndreqte Nestin. As zënka, as llafi i ashpër. Ilaç më të mirë nuk gjeje.

Nesti në telefon foli shqip që atë ditë. Për herë të parë. I prekur nga përkujdesjet tona, edhe pse kishin kaluar dhjetë ditë, ai e ndjeu si detyrë shoqërore të bënte muhabet të shtruar me ne, të na pyeste se ç'kishim edhe prej nga ishim.

— Vërtet, se kam harruar t'ju pyes, — tha,  
— si i keni emrat?

Me Tafilin «e murit» kishin qenë nga një anë dhe shtruan goxha muhabet. Dhe, ju betohem, kishte qenë njeri me vlera ai Nesti.

Por të sëmürët vijnë e ikin. Nesti erdhi më pas e ne e lamë më pas atje, pasi u ndamë me të mirë e bukur, si miq.

Dy javë e ca më prapa, pasi kisha dalë nga spitali, vajta përsëri në pavijon, të vizitoja një mik. Pa vënë këmbën në korridor, dëgjova zérin e Nestit që fliste në telefon. Frëngjisht prapë! E mbajta çapin që të mos e bezdisja. Ai mbylli telefonin e u fut në dhomën e tij, që tani e ndante me shokë të rinj. Kish përplasur derën e po u shkrevej atyre:

*W. u. e. t. i. l. k. h. i.*

— Dua qetësi këtu! Dhe nuk duroj dot ha-ha-ha e hu-hu-hu! Kështu bënин dhe ca individë që kisha këtu më parë. Po m'u desh t'u vija drunë.

Po ai Nesti i parë!... Dukej që i kishte vënë poshtë që të gjithë atje. Thashë njëherë të nxirrja nga dhoma ndonjërin prej tyre e t'i tregoja ilaqin, por... lëre, vendosa, do t'ia gjejnë vetë rëcelin e trëndafilit. Ai reçel e ndyn ca këtë mesele që ju rrëfeva, po jo edhe aq sa mund të duket...

1983

Xhaxhi shkundte çibukun dhe qeshte i kënaqur duke parë jashtë nga dritarja e trenit.

## **Prindër në provë**

Ata që e njojin djalin tim tetëvjeçar, Titin, e marrin me mend se si më pyeti atë natë, kur u ktheva nga mbledhja që bëmë në shkollën e tij.

Kuzhina plot. Aty: nëna ime, babai, vjehrra dhe vjehrra.

— E, ba, u zgjodh komiteti i prindërve?

— U zgjodh, — ia bëra unë.

Qetësi. Në lavapjatë çukiste një pikë e rrallë.

— Ty... të zgjodhën?

Unë s'iuh përgjigja.

— Të zgjodhën, ba?

— Jo, — i thashë unë si fajtor.

Ai më pa me keqardhje dhe unë ula kokën. Në atë çast për të unë isha njeriu më pa vlerë në botë.

Të katër pleqtë, gjyshe dhe gjyshër, m'u hodhën në ndihmë.

— E po nuk zgjidhen të gjithë. Edhe komiteti i

prindérve i duhet Lames! S'u zgjodh Lamja e kushedi ç'humbëm! Hë, hë!...

Po për sytë e Titit unë kisha humbur shumë. Ai mori çantën, më pa dhe një herë si me përcëmim e iku në dhomën tjetër për të bërë detyrat.

Për Titin nuk kishte rëndësi që në punë unë jam kryetar i organizatës profesionale, i komisionit për zgjidhjen e konflikteve, që në lagje jam veprimtar i kalitur... Nuk isha zgjedhur në shkollë, pa vlerë ishin të gjitha të tjerat!...

Të gjithë fajin ma ka ime shoqe. Se nga vete e për Titin që më merr mua si shembull të gjallë. Më quan shembull të punëtorit duarartë, të prindit korrekt, të qytetarit të stëredukuar, që jo vetëm nuk hedh cigaren përdhe, por mbledh edhe fletët që rrëzon vjeshta; të babait ish-kalama, që ka qenë nxënësi më i rregullt, më i pastër e më i zgjuar në mes të gjithëve; që ka qenë shembull i shembujve. I thotë bile se dikur, çdo ditë, kanë pasë qenë nisur me qindra e qindra nxënës në ekskursion, nga Kukësi e nga Saranda, me autobusë, për të më parë mua! E se, gjoja, për herë të parë në historinë e arsimit botëror nota dhjetë ishte pak dhe për mua përdorej nota njëmbëdhjetë!... «Lame, dua që djali të na bëhet i mirë, prandaj t'i zmadhoj vlerat e të bëj si monument në sytë e tij. Dua t'i zgjoj sedrën!» Fol me time shoqe! Po sedra ime?... I shkreti monumenti im, si është katandisur! Ca nga gruaja e ca nga mësuesja e djalit.

Unë nuk di pér ju, or vellezér, po mua më-suesja e djalit më dërgon detyra:

— Me kompensato, — u thotë fëmijëve, — do të bëni një kazmë, një lopatë, një çekan dhe një vapor. Do t'i bëni ju! Ju nuk i bëni dot kurrë, po t'jua bëjnë prindërit. T'i sillni nesër, se do t'ju vë nota...

Prindërit... Sa pér Titin tim, ajo dihet. Nga këta lloj prindërish ai vetëm një ka: Monumentin!... Se ime shoqe nuk ia vërshellen fare.

Pa vete gjej kompensato, sharrë, pa i sharroj, pa s'më bëhen të mira... Po djali qan. Dhe më vete shpirti në majë të hundës...

Të nesërmen djali më hedh në tryezë një flitore me notën e mësueses.

— Na, ba! Gjashtë more.

— Unë apo ti?! — i them, duke mposhtur inatin.

— Ti, ti, — më thotë. — Unë s'bëra gjë. Ti i bëre. Dhe je duarartë! Hm!

— Po Vasoja? — pyes pér fqinjin sipër, që ka vajzën në një klasë me Titin.

— Xhaxhi Vasoja dhjetë!

— Do të ketë ndonjë kompensato të mirë ai, — them nëpër dhëmbë. — Varet nga kompensa-toja...

— E-e-e! Duhet të të vijë një çikë turp! Ti nxënës i njëmbëdhjetës! — më yshë djali. — Sot ke një detyrë tjeter: do të më bësh një metër prej kartoni dhe këtë problemën: Beni hëngri pesë akullore më pak se Tefta, e cila hëngri dy

akullore më shumë se Genci. Sa akullore... —  
dhe vazhdon një xhumbë akulloresh, që të shu-  
ajnë nga bajamet e duan një qerre penicilina.

— Mësuesja tha që të na e bëni ju prindërit,  
se për ne është e vështirë.

Po kjo pikë është! Këtë radhë i futem punës  
seriozisht. Ia kaloj Vasos. Unë nëntë, ai shtatë.  
Titi prapë s'është i kënaqur.

— O ba, — thotë, — sot do të më bësh një orë  
muri dhe tetë fjali me fjalën *lopa*.

— Lopa! — i them i tmerruar. — Unë??

— Ti, po, kush, unë? — ja pret djali. —  
Për prindërit tha mësuesja.

— Po ky është kulmi, more bir! Po unë kam  
punë të tjera. Këto mësueset pse s'japin detyra  
që të mund t'i bëni ju?! Unë kam kryer shkollë  
të lartë. Shkollën fillore e kam të vështirë...

Po pyet djali...

— U trembe, ba?! Eh, se ke qenë dhe nxënës  
i njëmbëdhjetës!

Ah, grua, grua! Ah, moj e uruara mësuese!  
Më turpëruat! Le që s'kam kohë të dal me një  
shok... Kur takoj Vason, ai s'ndalon fare...

— Më lër, — thotë, — kam detyrat.

Ja, po dëgjoj të trokitura nga katër i sipërm.  
Është Vasoja. Ka një raport për të shkruar, i ziu,  
e më thérret për detyrat që na ka dërguar më-  
suesja. Nuk ka kohë e do që t'i kopjojë nga unë...  
Ç'na gjeti!...

## *Sëmund ja e palloit*

Dielli i korrikut qëndronte si i varur mbi kordrat nga ana e perëndimit. Rrezet përvëluese të tij tani vinin të pafuqishme. Megjithatë ai e kishte lënë nxehësinë mbi shtëpitë e qytetit, mbi asfaltin e rrugëve dhe mbi karrigjet metalike të kafes verore, ku ishim ulur atë të diel unë dhe miku im Caci.

— Të është pjekur lëkura e ballit, — më tha Caci.

— Lëre, lëre, më ka djegur mirë dielli, në mes të arës së korrur, — ia ktheva më tepër përt'i treguar se atë paradite kishim qenë kolektivisht për të mbledhur kallinj.

Në bisedë e sipër, drejtori im, që kthehej nga një shërbim jashtë rrethit, iu afrua tryezës sonë. U ngrita, u përqafuam. Pastaj e njoha me Cacin. Drejtori nuk donte të ulej dhe ashtu, në këmbë, më pyeti se si na shkonin punët. Dhe unë, me dy-tri fjalë, i thashë se punët shkonin mirë. Pastaj shtova:

— Sot mblodhëm kallinj, u ndihmuam kooperativistëve.

— Ashtu? Bukur! Pjesëmarrja ishte e mirë?

— Jo keq, — ia ktheva. — Shokët e repartit türk ishin të gjithë, pa përjashtim.

Dukej që drejtorit iu bë qejfi.

— Mblodhët ca? — u interesua më tej.

— Po, si repart them se i mblodhëm nja dhjetë a dymbëdhjetë kuintalë grurë të harruar.

— Vërtet, more?! — për një çast ai ngurroi të besonte, po pastaj shtoi: — Po pse nuk thua ti që... Na paskeni nderuar... na paskeni nderuar, — përsëriti i kënaqur. — T'u themi shokëve ta publikojnë në stendat tona.

Atë çast ndjeva një goditje të fortë në fylellin e këmbës. Ishte këpuca e Cacit, i cili ndër-kohë po e ndiqte me shqetësim të dukshëm bisedën tonë.

— Pa dhe gazetës i duhet dërguar një informacion, — vazhdoi drejtori.

Këtu mora një goditje të dytë nga Caci.

— Ndenjët shumë në fushë? — pyeti përsëri drejtori.

— Deri aty nga ora katér, — iu përgjigja fare natyrshëm dhe nuk e kuptova përse mora goditjen e tretë poshtë tryezës.

Me të ikur drejtori, u ula t'i kërkoja llogari Cacit.

— C'pate ti?! — e pyeta me njëfarë inati.

— C'bëre ashtu, more? — ma ktheu.

— Asgjë. Informova. Raportova.

Caci dukej shumë i shqetësuar.

— Po a je i sigurt pér ato që i the? A janë të gjitha të vërteta?

— Po, sigurisht, mor Caci! Pse, ta ha mendja që unë gënjej? Ja, ta zëmë se s'qenë dymbëdhjetë kuintalë, janë gjashtë! Se mos ai do të shkojë t'i peshojë!

Lëkundja ime sikur e bëri më këmbëngulës Cacin.

— Apapa! Nganjëherë, more mik, ndonjërin e zë një sëmundje e çuditshme dhe fryhet si pa-llo... Ke parë se si i frys pendët pallo? Do të shitet pér më shumë se ç'është. Janë me zaraf, more xhan, këto punë.

Unë po e shikoja me kureshtje.

— Ca vite më parë... — nisi të më tregonte Caci, — të kujtohet? Ca vite më parë punoja në NPSR, e kisha zyrën në atë kodrinën atje, — dhe zgjati dorën pér nga kodrat, matanë të cilave dielli tanë qe fshehur fare,

— E di, — i thashë.

— Isha përgjegjës i administratës. Në atë kohë qe shpallur një fushatë pyllëzimesh. Vend ne kishim sa të duash. Duhej të mbillnim plepa. Po hë t'i mbjellim sot, hë t'i mbjellim nesër... Në myyllje të fushatës mezi u mblodhëm. Hapëm tri gropë e mbollëm tre plepa.

— Sa?

— Tre, or, tre... Një, dy, tre! Turp i madh! Unë vetë nuk kisha asnjë faj, po, kur më pyetën nga qendra e ndërmarrjes, turpi më rëndoi.

«Mbollët?», — më thanë.

«Mbollëm», — u thashë.

«Po sa?»

T'u thosha tre, për nder, sesi më vinte. Mendohesha me telefon në vesh. T'u thosha pesëdhjetë, apo njëqind?

«Nëntëdhjetë e tre!» — u përgjigja përtatë bërë më të besueshme.

Ja, ky ishte raportimi. Umbyll telefoni. Iku sfala.

«E, more, thashë me vete, plepa janë! Bile as plepa, po filiza. Kush do të vijë t'i shohë? Se mos i thashë që prodhuam televizorë e do të më thoshin na i sillni në magazinë! Plepa, plepa! Një zë, dy nuk zënë. Një thahet, një shkulet...»

Kjo qe. Por do ti që atyre sesi u humbi shifra dhe pas disa kohësh më pyetën përsëri... Tërrë ato ditë isha mësuar me nëntëdhjetetreshin dhe më dukej se vërtet kishim mbjellë aq. Prandaj, ngaqë më dukej ashtu, sikur më vinte keq të mos shtoja edhe ca. Nuk kishte gjë më të lehtë. S'e zgjata më. E bëra shifrën pesëqind e nëntëdhjetë e tre! Po nuk mbaroi këtu. Sepse, kur më pyetën nga ministria, e pashë të udhës t'i jepja dhe dy-tri pompa shifrës. Demek hajd, se plepa janë! Dhe për ata tre plepa të gjorë vajti në ministri një goxha shifër. Në aksh kodër etj., etj., u mbollën nëntëqind e nëntëdhjetë e tre plepa! «Na falni që nuk arritëm dot të plotësonim mijën», raportova me keqardhje.

— Uf, more Caci! — ia bëra unë i habitur.

— Qesh ti, qesh, po ç'kam hequr unë më vonë! E kisha harruar fare këtë punë. U tha ajo shifër dhe iku! Fushata fushatë! Ajo qe mbyllur, plepat duhej të ishin rritur... Çne unë të vuaj pesë vjet më vonë! Për ca djaj plepa! Por, siç të thashë, pesë vjet më vonë po zbritja shkallët e ministrisë. Më zë njëri, me syze dielli... Ama gjatë tërë bisedës nuk i hoqi. Sec ishte një, që as e pyeta. U hutova fare. Nuk e kam parë më atë fytyrë. Kush ishte? O ndonjë shakaxhi që më bënte enkas, o ndonjë që interesohet vërtet. Po më futi datën, amë!

«Ju jeni filani?», — më thotë.

«Po», — i them.

«Bukur. Sa plepa keni mbjellë...»

«Hej bela, o bela! Mbahu, Caci, i thashë vetes, se dynjaja bien nga fiku, ti, me sa duket, do besh nga plepi!» Tani t'i thosha shifrën e parë, të dytën apo të tretën?... Po i them të parën, venu-

«Nëntëdhjetë e tre», — thashë tak-fak.

«Në drejtorinë tuaj të përgjithshme keni raportuar se u mbodhën nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, — më tha. — Kjo është mrekulli e vërtetë!»

«E po, mrekulli është!» — ia ktheva unë dhe një e dredhur më zuri peshkun e kurriçit. Duke mbajtur shënimë, ai mërmëriti:

«Kjo është e pabesueshme!»

O bela e plepave, nga më zure këmbët!

«Ta besoni», — i thashë.

«Eshtë e pakrahasueshme! — më tha i mahnitur.

«Jo, krahasojeni, po deshët!» — ë nxita padashur. Kisha hyrë mirë në valle unë.

«Atëherë, aty te ju qenka bërë vërtet një korije gjigante!» — më tha ai.

«Korije, thua ti! — i rashë shkurt, duke i dhënë dorën për t'u ndarë. — Pyll, ore, pyll i vërtetë!»

«Pra, nuk qenkan të kotë ca zëra që thonë se një ekip profesorësh të gjeografisë duan ta përfshijnë në hartën e vendit!»

Këtu më zunë djersët e ftohta. Tre plepat e mi të futeshin në hartën e vendit!

«Dale, — i thashë, — në drejtori nuk e kanë shifren të saktë. Se, helbete, janë vite që ikin këto... Më duket se eshtë pesëqind dhe jo nëntëqind...»

Njeriu me syze u fut në mendime.

«Sa keq! — tha. Nejse, prapë, kërkesën që do të bëjnë ata të fabrikës së shkrepëseve, mund ta përbushni. Ata duan një mijë metra kub druri përfijet.»

Këtu nuk durova më.

«Ore mik, — i thashë, — se huk ta di as emrin. Atyre të drejtorisë së ndërmarrjes u humbi shifra e parë dhe kërkuan përsëri... Ka të ngjarë që pastaj të jem hutuar... Ata ishin nëntëdhjetë e tre. Po, po, nëntëdhjetë e tre...»

Dhe i dhashë dorën për së dyti... Por që pas dëgjova fjalët e tij të thëna me keqardhje:

«Patën fat vetëm fëmijët. Të paktën, do të kënaqen ata.»

Nuk munda të bëja asnje çap më tej.

«Pse, or, aman, — e pyeta që larg, — ç'duan fëmijët?»

«Po, ja, thuhet se aty do të ngrihet një kamp verimi klimaterik. Dhe aq plepa, sa thoni ju, mjaftojnë...»

As iu afrova më. Megjithatë, duke u larguar, e nxora të vërtetën.

«Gjeografinë lëreni rehat, ata të shkrepëseve të bëjnë hall gjetkë e fëmijët të na falin. Doni troç ju? Hapur! Aty ne mbollëm vetëm tre plepa, dhe ata na i hëngrën dhitë!»

Dhe u zhduka. As e pashë e as më pa që atëherë. Po nga ajo kohë vura mend dhe kurrë s'bëj më raporte me lulka... Ja, ti tan po i thoshe drejtorit tënd ca fjalë të mira që e kënaqnin. Mua s'më mbante vendi. Dymbëdhjetë kuintalë! Ta zëmë se është ashtu. Ty do të të thonë: «Të lumtë!» Po ai që i paska harruar ata kallinj nëpër arë, e pranon këtë ai? Si i lënka tjetri sheshit dymbëdhjetë kuintalë grurë?! Pastaj, vërtet punuat deri më katër?

Unë heshtja. Por thellë në ndërgjegje i jepja të drejtë. Se, në fakt, direktën e kisha ngrënë në shtëpi, fiks në orën dy. Sa përsasinë, tanë

isha i bindur që as dy kuintalë nuk bëheshin. I kisha thënë ç'i kisha thënë drejtorit, të tëra vinin nga përqartja e sëmundjes së dikurshme të Cacit, që, me sa dukej, kishtë nisur të më rrezikonte edhe mua...

1975

## SHOQËRIMI DOKTORAT

Shoqërimi i Doktoratit është organizuar aty si:

(Raport)

Shoqërimi i Doktoratit është organizuar aty si:

Doktorat i Shoqëritë së Shëtitës së Sëmundjes së Dëmtit, i cili është organizuar aty si:

Doktorat i Shoqëritë së Shëtitës së Sëmundjes së Dëmtit, i cili është organizuar aty si:

# *Manual për drejtorë teatros*

(Fraza të gatshme për marrëdhëniet me dramaturgët)

### **Kur ai të vjen në zyrë**

- O, mirë se na erdhët, ju prisnim!
- Sa do t'ju telefonoja!
- Ejani, ejani! Drama juaj na ka vënë në lëvizje tërë teatrin!

### **Kur nuk ke pasur kohë t'ia lexosh dramën**

- E fillova që atë ditë, s'më pritej, po vetëm një tablo kam lexuar. Ku të lë puna! Por ama, po qe e tëra në nivelin e tablosë së parë, më lejoni t'ju vë mbi të gjithë dramaturgët që kemi.
- Një kopje kemi. Po e qarkullojmë. Merre me mend, nuk po më bie as mua në dorë! Duket që është me interes.

— Drama më tronditi. Nuk do ta besosh, po nuk vazhdoja dot. Dhe e lashë fare. Takohemi pas dy javësh. Do të më ketë kaluar tronditja.

### Kur ke vendosur që të mos merresh me të

— Drama s'na ngopi.

— Drama fironte nëpër faqe.

— Tingëllon e thatë, ka shumë ujë brenda.

— Ka vetëm një veprim. Të mërzit.

— Ka shumë vende veprimi. Copëzohet.

### — Për temën e ditës

— Tema e ditës është e vështirë. Presim nga ju një dramë me temë historike.

### Për temën historike

— Tema e luftës është rrahu shumë. Publiku mezi pret temën e ditës.

— Drama juaj ka një temë, si të thuash... Kemi vënë me këtë temë. Nuk vëmë më.

— Nga kjo temë nuk kemi vënë e sesi na vjen...

### Kur do që të zbutësh zemërimin e autorit

— Këtë dramë përse nuk e bëni skenar? Do të dilte vërtet një film i rrallë! Fenomenal!

— Ju jeni i vjetër në këtë fushë. E dini sa e vështirë, është dramaturgja. Ju pata thënë që në fillim: shkruani më mirë vjersha.

— Mos u nxiton. As të mos ju priten forcat. Ju jeni i ri. Dramaturgja është rrugë e vështirë. Ama, mos iu ndani, se është e bukur.

— Ju shkruani bukur, ama këtë dramë sikur nuk e keni shkruar ju. Mos keni pasur ndonjë hall? Vërtet, si i keni nga shtëpia?

### Kur do që t'i hapësh punë autorit

— Plase konfliktin që në faqen e parë! A ke mundësi që në kapak?

— Dramën e ke të rëndë. Futi pak humor.

— Pastroje dramën nga komizmat. Ato ta bëjnë dramën të lehtë.

— Bukur që drama zhvillohet në një organizatë grash, po ka një të metë të madhe, ka shumë femra.

— Dashurinë do t'jua heqim. Puthjen nuk e realizojmë dot.

— Atë personazhin negativ si shumë e lë të livadhiisë. Në e vdis sa më shpejt, se mezi durohet. Ja, dhe tani që e kujtoj, më hipën gjaku në kokë. Dalim t'ju jap një kafe?

### Kur e përejell

— Ndreqini këto vërejtje dhe ejani të merrni të tjera.

— Mos u nxitoni në riparimin e dramës. Kemi kohë. Ndërkaq ne po vëmë dramën «Lulja mbi shkëmb». Ajo është e njohur, e kolauduar. Është vënë në pesë teatro.

— Kështu... Mos u druani të trokitni në teatrin tonë. Vërtet drama juaj mbetet jashtë, po për ju dyert janë të hapura.

### Kur ke dëgjuar se do të të heqin si të paaftë

— Shikoni, kur ta sillni veprën, mund të gjeni një drejtor të ri. Prej vitesh po kërkoj të iki. Deri tani nuk më kanë lënë. Më në fund po ma miratojnë kërkesën. Këtu do të çalojë puna, po më shumë u dhimbset shëndeti im. Do të largohem...

1984

— Më sëmundë e njëmbëdhjetë është më i shumtë që  
idh nuk ka një kooperativë që mund t'i përdorë këtë teknologji. Në këtë rast  
nëse nuk ka një kooperativë që mund t'i përdorë këtë teknologji, t'jhej që  
nëse nuk ka një kooperativë që mund t'i përdorë këtë teknologji, t'jhej që  
nëse nuk ka një kooperativë që mund t'i përdorë këtë teknologji, t'jhej që

## *Nuk të njohim, o kryetar*

Aty viti më parë, në një kooperativë bujqësore, në kufi me Rrethin e Fierit, pati ardhur

Aty viti më parë, në një kooperativë bujqësore, në kufi me Rrethin e Fierit, pati ardhur  
në krye të punëve Laver Driza. Laveri pati qenë agronom i një sektori. Sektori kishte bërë emër. Agronomi kishte meritat e tij dhe, siç ndodh rëndom, kooperativistët e vunë Laverin në krye të punëve të tjerë kooperativës. S'kishin si zgjedhnik kryetar më të mirë. E kjo u vu re menjëherë, se kooperativa doli në ballë të shoqeve.

Po e mira s'ka fund... Sot je i mirë ti, unë të shoh ty e bëhem më i mirë. Duar ti e duar unë. Mjete ti e mjete unë. Shkencë bën ti, po bëj edhe unë... Kështu që, pas tre-katër vjetësh, Laverit nuk i vinte mirë kur në rrëth i thoshin të hidhët sytë nga kooperativat përbri.

— Përse kooperativa «Liria» merr rendimente më të larta në pambuk? E pyesni veten?

— E vini re grurin e atyre të Fierit, që keni në kufi? Një është toka. Pse nuk shkonit t'i shih-

ni se si punojnë? Le të jenë rrëth tjetër. Pyetini.  
Do t'jua thonë.

Laveri ulte kokën. Ç'të i thoshte? Inka këto ai  
që drejton: çekanët më të rrëndë mbi të do të  
bien.

Vërtet punën në kooperativë nuk e bën veç  
kryetari, po ama një kryetar i shkathët i bën shokët  
të shkathët. Një kryetar që s'vë gjumë syrit,  
i bën shokët ta gdhijnë.

Kush e pati njohur Laverin vite më parë, ta-  
ni do të vinte rë ndryshime. Nuk ishte më ai ag-  
ronomi i brishtë, që bridhte parcelë më parcelë.  
Në tëmtha flokët i qenë hirosur e pati vënë ca  
bark. Vitet e pararojës e kishin miqësuar me zy-  
rën e planit në qendër të kooperativës. Aty shih-  
te pasqyrat, aty, nga kënaqësia, përpinqte, buzët,  
aty shfrynte inatet... Mblidhte përgjegjësit e sek-  
torëve. I raportonin, U jepte porosi. Lidhej me  
rrethin. Tamam si ai kali i vrahut, që shkel tërë  
grurin përreth dhe avash-avash mblidhet pranë  
strumbullarit, Laveri kishte pushuar së bredhuri  
tërë arat e kooperativës, që mbledhur në zyrat  
e qendrës dhe drejtonte që aty. Telefoni ishte  
shpikje më e fisme se makina. Shoféri i veturës  
flinte tanë orë të tëra në ndënjasen e pasme me  
të katër dyert të hapura për veri

Ama, kur nis të çalojë puna, çekanët fillojnë  
e rrahin të tërë njëherësh. Si me sustë. Nga  
lart, poshtë, anash. Dhe ku s't'i gjejnë gjynahet...

— Shoku kryetar, je mbyllur në guaskë!

— Shoku Laver, nuk po i rri punës mbi kokë!

— Lëviz, Laver, se mbete! në zyrë! Shifrat flasin, po njerëzit kanë gojë dhe veshë.

I dëgjonte e nuk i dëgjonte Laveri këto, por e madhja plasi në një mbledhje të zgjeruar, aty pas fushatës së shirjeve, ku një brigadier, tha në sy të të gjithëve:

— Kemi kryetar, po nuk e shohim të na vijë!

— Avash, ti, Llazo, avash! — ia preu llafin Laveri që nga tryeza. — Fol qetë e mos u nxito. Në sektor ka përgjegjës... pa ka agronom...

— Jo po nuk e ke drejt! — e kundërshtoi brigadieri kryetarin.. — Plehun nuk e shpërdajnë si duhet. Përgjegjësi mbledh të dy supet. Dy supe ka dhe agronomi. I mbledh dhe ai. Na rruat! Kërkojmë kryetarin, thonë që mund ta shohim vitin që vjen...

Në sallë plasi gazi.

Laveri u ngrit me rrëmbim.

— Shoku Llazo! — ia bëri.

Brigadieri qeshi nën buzë dhe uli kokën. Pastaj hodhi shikimin rrëth e qark dhe ia nguli sytë Laverit,

— Më quajnë Gaqo, shoku kryetar! Na urdhëro ndonjëherë të bëjmë dy para, muhabet! — Dhe u ul.

Po mbaheshin dot më të qeshurat? Nuk qeshën vetëm ata të radhës së parë, se u vinte zor. Ama u frynë, ngritën sytë në tavan e kafshuan buzët. C'ishin prapa tyre, nuk mbaheshin. Ata që drejtönin mbledhjen, në të dy anët e Laverit,

ulën kokat, morën nëpër duar kalemat e hiqnin vija...

Nuk e zuri gjumi atë natë Laverin. Të vërtetët e ke përpara, ti mos e prano po të duash.

Të nesërmen vendosi të dilte fushave. Dha ca porosi dhe u nis. Shoferi i vajti prapa, po Laveri i tha të mos lëvizte, se vetura mund të duhej aty për ndonjë punë. E merrte këtë rrugë dhe një çikë si i inatosur me veten:

Ishin ditët kur prashitej misri...

Bëri një copë udhë me qerre. Pastaj një zetor e shpuri në një bostan. Aty hëngri një shalqi të tërë dhe mori përsëri rrugën duke u mbështetur në një shkop prej thane.

Kapercante Laveri kanale, udhë qerresh, përshtendoste majtas e djathas dhe ndalte vetëm aty ku e shihte që duhej ndaluar domosdo. Këmbehej me njerëz që e njatjetonin të pasigurt. Nga pas ndiente shikimin e tyre dhe Laverit i zinte veshi pëshpëritje: «Duhet të jetë kryetari! Ai është, kryetari!»

Lodhja ia kishte rënduar çapin, por inati është inat. Aty nga ora katër e ndjeu veten të këputur. U ngjit në breg të një kanali dhe vështroi përqark. Ngado të zinte syri njerëz që punonin, duke llaftosur me njëri-tjetrin duke kenduar, duke qeshur.

Ca nietra më poshtë, aty matanë kanalit, nja dhjetë a pesëmbëdhjetë veta kishin lënë shatat dhe ishin ulur nën hijen e një kumbulle të vëmuar. Një burrë, me një xhaketë doku në pëqi,

diç u tregonte e ata qeshnin. Laveri vendosi të freskohej pak në kanal e pastaj të ulej me ta. Hoqi këpucët, u freskua dhe i veshi përsëri. Jo, jo, do të vazhdonte udhën. Por atje tej, nën kumbull, muhabeti nuk po merrte fund.

Burrin me xhaketë Laveri nuk e njihet.

«O kujtesë, që na le në baltë! — murmuriti Laveri. — Do të jetë ndonjë Llazo tjetër ky, që përfundon Gaqo!»

Me një kërcim u hodh matanë kanalit dhe iu afrua kumbullës, nën hijen e së cilës valonte muhabeti pér shtatë pale qejfe.

— Mirë se rrini! — u tha jo pa njëfarë ironie.

Njerëzit lëvizën nga vendi dhe po e shikonin me kureshtje.

— Prashitni misër? — i pyeti.

— Misër, — u përgjigjën disa nëpër dhëmbë.

Laveri u përkul dhe ngriti një misër që e kishte prerë shati.

— Më me kujdes! Më me kujdes! — u hoqi vërejtjen mbyturazi. Pastaj përfshiu bishtin e një shati dhe prashiti dy-tri rrënje me shkathtësinë e dikurshme. Asnjeli nuk po lëvizte. Të tërë rrinin grup, të nemitur. Shikonin si të përhumbur Laverin, që e përdorte shatin pér bukurin.

— Po hë, — tha ky më në fund, — nuk mbaruat? Nën hije muhabeti është i ëmbël, po na presin punë të mëdha!

Përsëri nuk lëvizi askush. U ngrit vetëm burri me xhaketë doku. Laverit, ta vrisje, nuk i

kujtohej emri i tij, por, megjithatë, nuk iu ndenj  
dhe ia hoqi një vërejtje:

— Hë, — i tha, — mos i mbaj me shakara!  
Punë, punë!

— Më falni! — i tha burri me xhaketë doku.

— Kush jeni ju?

«Deh, o pikë e zezë, deri ku arrin puna», ia  
bëri Laveri me vete.

— Nuk më njihni?

— Jo, — ia ktheu tjetri.

— Unë jam kryetari! — tha Laveri.

Asnjeri nuk pipëtinte. Burri me xhaketë u  
afrua më shumë.

— Cili kryetar? — pyeti.

— Cili kryetar?! — u çudit Laver Driza.  
Kryetari i kooperativës, more!

Burri me xhaketë në fillim i çapëloj sytë, pas-  
taj me buzëqeshje i tha Laverit:

— Më falni, po kryetar jam unë!

— !!!.

Dielli përvëlonte si saç. Megjithatë nuk ishte  
punë dielli këtu...

Laver Driza, në shëtitjen e tij, pati kapërcy-  
er me kohë kufijtë e kooperativës së tyre dhe  
pati hyrë në rreth tjetër, në kooperativën e  
Fierit...

## *A ta pranoj humbjen?*

Ata që më kanë dalë ballë, herë pas here,  
në rrugën e jetës sime, kanë qenë lloj-lloj...  
Them se i kam përballuar pa ma bërë syri tërrr...

Si ta pranoj, që tani, kur thinjat kanë nisur  
të më përzbardhin tëmthat, këtë kundërshtar të  
ri të mos di ku ta zë, që... që t'ia zdredh fillin?!

— A thua ky, sado pa rëndësi në dukje, është  
një rast tepër i vështirë për t'u përballuar?!

Kundërshtari im, nuk dua t'ju habit apo të  
bëj efekte... kundërshtari im është... gjashtë vjeç!  
Shkurt i thërresin Goni dhe banon në pallatin  
përballë.

Në të vërtetë, konfliktin ne e kemi nëpërmjet  
një të treti, nëpërmjet djalit tim, Mimit... Unë  
ndeshjet e përditshme i kam me djalin tim, por  
ama, prapa Mimit pesëvjeçar unë ndiej dorën,  
frymën, pushtetin dhe autoritetin e Gonit, që është  
një vit më i madh... E Mimi im i respekton më  
të moshuarit. Kaq e ka marrë nga unë ai!...

Dhe ky Goni ka një autoritet, more vellezër, ka një autoritet... për t'ia pasur zili. Mbi të gjithë fëmijët e pallatit. Jo vetëm mbi tim bir, joooo!... Si e ka arritur?! Nuk e di. Mbase ka përfituar nga ajo, që shpesh ne, burrë e grua, nuk bëjmë më shoqëri me djalin tonë, siç bënim dikur. Për vizitë, shëtitje e sebep dalim pa djalin... A mbase na tërheqin pak si shumë librat e gazetat, mbase na mbërthen pak më të tepërt televizori me programet e tij dhe nuk na mbetet vëmendje për Mimin... Këtu diku duhet të jetë çelësi. Ama, një gjë është e qartë: po i erdhë djalit që nga dritarja thirrja e Gonit, ai të fluturon nga gjunjët, të lë pjatën, të lë çokollatën dhe vrapon te komandanti dhe edukatori i tij. Kjo gjë mua më tërbon, por jam i pafuqishëm. Pa provo t'ia mbyllësh portën një pesëvjeçari që ulërin dhe përplas këmbët... Hë, hë!... Unë nuk jam i zoti për këtë. Po se mos jam i zoti për të tjerat! Djali e nxjerr këmishën përmbi pantalona se kështu e mban Goni dhe e fut vetëm kur e fut Goni...

Do të ishte e keqe e vogël, nëse Goni do të më kundërshtonte vetëm në fushën e modës. Ai më kundërshton në fushën e shkencës: Unë, tim biri, i tre goja një ditë se shiu shkaktohet si rezultat i kondensimit të avullit... Im bir qeshi me të madhe dhe tha se Goni e shpjegon më qartë... Shkurt, shiu bie ngaqë ka frikë prej bubullimave dhe për këtë Mimi nuk kishte pikë dyshimi!...

Shoku i djalit tim më kundërshton edhe në

shumë fusha të tjetra, që ofshin këto ekonomike, kulturoro-artistike, sportive. Mbi të tjetra ai më ka kufizuar fushën e ndjenjave familjare..., Më ka rrëmbyer djalin, ma ka pushtuar, ma ka nënshtruar.

Unë këtë kundërshtar e urrej, e... e... Nuk e di se si ta heq qafe. Vuaj... Dhe im i bir nuk do t'ia dijë për vuajtjet e mia, është i pamëshirshëm...

I bëra një ditë thirrje. I kujtova Mimit ndjenjat reciproke të atit e të birit dhe i thashë solemnisht:

— Në fund të fundit, të kam bërë kokën...  
— Po trupin kush ma ka bërë? — më ndërpree ai kureshtar.

Nuk iu përgjigja se humbisja solemnitetin dhe situatën dramatike.

— Të kam bërë kokën, — nisi përsëri nga e para, — zgjidh: O me mua, o me Gonin!

— Me Gonin! — tha im i bir dhe i vazhdoi të bënte fluska sapuni me kallam.

Një ditë Gonin e gjeta të kapardisur në shtëpinë time. Ky ishte kulmi! Më vinte në shtëpi!

U mata të hapja derën dhe të ulërija: «Ja-shtë! Dhe këtu mund të hysh vetëm mbi kufomën time!» Por ime shoqe më shpjegoi thjesht se e kishte ftuar ajo vetë dhe ai kishte hyrë pa vësh-tirësi, aq më tepër që te pragu kusoma ime mun-gonte. Njëherë mendova të mos pranoja të ulesha me të në tryezën e bisedimeve, por ime shoqe përsëri më sqaroi, se Mimi ynë, si zakonisht, nuk

hante zarzavatet dhe, meqë autoriteti im nuk pinte ujë, kishte provuar të përdorte atë të Gonit. (Pas asaj të djalit, Goni po fiton edhe simpatinë e sime shoqeje.)

Erdhën pjatat me mashurka... Ne ua kishim ngulur sytë fëmijëve. Mimi, me lugë në dorë, shihte Gonin, duke pritur urdhrin e tij. Goni mbushi lugën dhe e futi në gojë. Goni përtipej e ne s'pipëtinim. Gjykimi i tij ishte vendimtar.

— Të mira, — tha më në fund Goni. — Ha, Mimi!

Dhe Mimi, pa një pa dy, futi lugën në gjellë e nisi të hante! Nisi të hante atë gjellë që nuk e kishte pranuar tridhjetë herë, edhe kur ne me pjatë e ndiqnim prapa nëpër shkallë e tutje, deri në këndin e lodrave. Ja, mjaftoi vetëm një fjalë e këtij njeriu që kam përpara e që më ka sjellë aq shqetësimë.

Ai ha në tryezën time e nuk e kuption që unë e quaj kundërshtar, rival... Ai më sheh me sytë e tij të pastër dhe më thotë mua, kundërshtarit:

— Xhaxhi, të vë poshtë vetesh një jastëk, she nuk arrij dot në pjatë.

Sjellim dy jastëkë. Dy fëmijët hanë të patrzuar... Unë me Gonin përtypemi ballë për ballë dhe shihemi sy ndër sy. E më duket sikur ai, nga çasti në çast, do të më thotë:

— Xhaxhi, mosh u mërxhit, po ti nga edukimi i fëmijëve sh'passhke haber fare!...

## *Dicka e rendësishme*

Jashtë, tej xhamave të sallës ku ndodhen kabinat telefoniqe, bie dëborë.

— Direkt me Tropojën! Kabina gjashtë!

Një vajzë me pantallona stofi, me një pallto me push ngjyrëbezhë, ngrihet nga stoli, shkëputet nga dy shoqet që e patën vënë në mes dhe i afrohet banakut të kabinistës.

— Më falni, unë nuk dua Tropojën, por Kamin, — sqaron vajza. — Ekspeditën!

— Sapo të dalë Tropoja, kërkoje vetë Kamin, — udhëzon kabinistja.

Vajza nxiton për në kabinën gjashtë.

Duhet të jetë studente si edhe dy vajzat e tjera. Ato janë ngritur nga vendi dhe i afrohen derikës së kabinës, brenda së cilës, e ndriçuar nga një llambëz që lëshon një dritë të butë, shoqja e tyre i lutet Kamit ta lidhë me ekspeditën e me shokun e saj, gjeolog, me sa duket.

Pa kaluar një gjysmë minute, dera e kabinës

hapet duke kërcitur dhe nga brenda vajza diç u thotë shoqeve.

Ato alarmohen.

— Nuk dëgjohet mirë, — i ankohet njëra prej tyre kabinistes.

— Kontrolloni pak linjën, — lutet tjetra.

Kabinistja, së cilës mbrëmja e ngarkuar i jep një pamje të lodhur, merr pa qejf telefonin dhe lëviz pareshtur çelësin.

— Pa flisni tani! — ua kthen pas pak vajzave.

Vajzat hapin kabinën dhe përcjellin fjalët e kabinistes.

— Fol tani, Elsa!

— Alo!... Alo!... — vjen i shkëputur zëri i Elsës.

Qielli jashtë shkund dëborë me flokë të mëdhënëj. Ata bien e zbardhin sheshe, trotuare, çatira, tarraca e antena. Ata me siguri këcas po hedhin përmbi Kam një shtresë të re, të butë, mbi të cilën, pas pak, një gjeolog do të lërë dhjetëra gjurmë, besnikërisht të njëjta, nga vendi i telefonit në fjetore. E floknaja do t'i rimbushë ca e nga ca, më parë shputat e pastaj thembrat.

Këtu, tej xhamave të sallës, copëzat fluturake shndritin nga reflekset e neonëve dhe fenerët e takutive, që kalojnë pa zhurmë përparrë stacionit të PTT-së.

Në krye të dy minutave, vajza që quhet Elsa del e pakënaqur nga kabina dhe, duke lënë derën hapur, i afrohet bënakut.

— Pothuajse nuk po flas fare. Unë e dëgjoj qartë, kurse ai hiç.

Dy vajzat e tjera, më të mërakosura se ajo, e kanë ndjekur pas.

— Pa provoni kabinë tjetër, — u thotë kabinetja. — Shkoni te treshi.

Ato vërsulen drejt kabinës numër tre. Elsa futet brenda, kurse dy të tjerat, që jashtë, mbështetin kokat mbi katrorin e xhamit të derës e presin. Ato nuk dinë si e qysh t'ia bëjnë që afshi i fjalëve të shoqes të mbetet aty në kabinëzën me pesë nga të gjashtë faqet e brendshme të veshura me damask. Por edhe në daltë, të mbetet e të shuhet patjetër deri në kufijtë e dëgjimit të tyre. Biseda që po bën Elsa në kabinën telefonike me numër tre është e rëndësishme dhe ato drithërojnë tok me të. Por janë jashtë e nuk u mbetet veç të vigjilojnë si roja të kujdesshme. Ashtu bëjnë ato edhe në muajt e verës, në plazh, kur në grup nga katër a nga pesë presin përpara derës së ndonjë kabine ditore shoqen që aty brenda po zhvesh fustanin për të veshur kostumin e banjës.

Veçse ca nga dëshira për t'u dëgjuar e ca nga puthitja e dobët e kanatit të derës, fjalët e vajzës tanë vijnë pothuaj të plota në sallonin e pritjes. Ajo e pyet se kur do të vijë, i flet për lektionet, për dëborën që po bie... Po për shkak të linjës së vështirësuar është e detyruar t'ia përsritë nga dy dhe nga tri herë fjalët e saj.

— Dje pasië mamanë tënde... Mamanë!... Ma-ma-në!... Eeee! Në dyqanin e frutave. Po merrte portokalle. Ajo nuk më njeh dhe unë i

vajta fare pranë... Fare-fare-fare afër! Ngjitur!... E ndihmova duke i mbajtur grykën e çantës... Grykën e çantës!... Fu-fu-fu!... Ç'telefon!... Grykën-grykën! Që të hidhte portok... Gry-kën!... Ka çanta grykë?... Atë ia hapa unë! Me duart e mia!... Ajo më tha: Rrofsh, moj bijë! Pa më njohur... Rrofsh, moj bijë!... Ooooo... q'më gjeti me këtë telefon sonte! Rrofsh!... Folja «me rrojtë»... mënyra dëshirore... veta e dytë... njëjës!

Vajza në kabinë bërtet fort. Fjalët e saj, që tani kanë më shumë nerv e tendosje sesa ngrohtësi, po i dëgjon e tërë salla. Buzëqeshin të gjithë sa janë aty; klientët e mërzitur nga vonesa por që nuk po i ankohen më kabinistes; vetë kabinistja, pa folur për shoqet e Elsës, që aty te dera, pak si të turpëruara, avash-avash po i kthejnë kurrizin sallës. Klientët e rinj, sapo hyjnë, e vënë re kënaqësinë e këtij përgjimi të përbashkët e nuk duan ta prishin, po lëshojnë pa zhurmë kërkесat e tyre e ulen të dëgjojnë edhe vetë. Këtë bën edhe një çift i porsamartuar, që u futën nga porta quditërisht ngjitur e ngjeshur, sikur që jashtë dikush t'i ketë kërcënuar t'i ndajë e t'i përqajë përfundimisht. Pacipësia e këtij afrimi trupor, që bëhet më shumë për sytë e të tjerëve se për kënaqësinë e vet, këtë herë nuk bëri kurrfarë përshtypjeje. Salla e la mënjanë duke e ndëshkuar me indiferentizëm praninë e të porsaardhurve, që jo shumë ditë më parë kishin bërë të kryer bashkimin e shumëpritur.

Në një kabinë telefonike, diçka më e hershme

nga ky bashkim, diçka më pak e sigurt, diçka më e copëzuar, më e palidhur, tërhiqte ku e ku më tepër.

— Tosi!... Tosi!... Tosi! Fol vetëm ti, se unë të dëgjoj fare kulluar... S'ka gjë... Nesër po flas unë më shumë... Ti-ti!... Kot që të cirrem unë... Kërkon të dëgjosh zërin tim?... Nesër, zërin tim! Në paça zë, nesër!... Fu-fu! Nesër!... Në-e-së-ë-rë! Ke të fala nga Alba dhe Lula! I kam këtu... Eee. Të fala... Tosi, po iki... Përse të mora prapë sot?! Kisha një gjë tepër të rëndësishme për të të thënë... Tepër-tepër-tepër!

Dhe, për t'i thënë këtë gjë të rëndësishme, vajza e ul zërin. Duhet të jetë diçka më e fshehtë, më intime akoma, që kurrsesi nuk mund të thuhet me zë të lartë.

Po linja qindrakilometërshe vazhdon të shfaqë tekat e veta dhe Elsa shtrëngohet, si gjithnjë, të përsëritë:

— Ja pra, kjo ishte gjëja e rëndësishme: *Më ka marrë malli!* E paktë të duket?!!... Tosi!... Të thashë gjënë e rëndësishme: *Më ka marrë malli!*... Po ç'ti bëj unë telefonit?!

Vajza hap derën dhe, ashtu siç është, me telefon në vesh, u tund kokën shoqeve gjithë pikëllim.

— Ç'm'u desh që i thashë është e rëndësishme!  
Pastaj mbyll kabinën përsëri.

— Po ç'faj kam unë?! Po ta them edhe një herë... Për herë të fundit sonte! E dëgjove, mi-rë! Nuk e dëgjove, s'kam ç'të bëj! Vër vesh!

Studentja mbushet me frymë dhe rrökëzon me tërë fuqinë e zërit që i ka mbetur:

— Më ka ma-rrë ma-lli! Fund! Natën e mirë! Vajza me pallton me push të butë del nga kabina.

Por vetëm shoqet e saj e dinë se ç'erë fryshtë sallë. Njerëzit që rrinë aty e presin me ca buzëqeshje të fshehura e vështrime kureshtare, po të ngrohta e pa të keq. Alba e Lula i veshin fyrat e tyre me nga një pamje të sigurt, serioze dhe udhëheqin shoqen, që duhet të bëjë pagesën.

— Ç'dëborë që bie! — thotë ajo më e imta për ta shitur edhe më tej mospërfilljen e shtirur.

— Sa bën? — pyet Elsa duke hapur çantën. Kabinistja i zgjat faturën me një vështrim mirëdashës dhe i merr Elsës paratë.

Alba dhe Lula mezi po presin që të zhduken nga kjo sallë e nga padurimi nxitojnë drejt derës. Ato do të dalin pastaj aty nën ato moliarda fluturza dëbore e do të kukurisin derisa të mbërrijnë në konvikt. «Më mirë që Elsa nuk kupton se ç'figurë ka bërë sonte këtu!» thotë secila me vete.

Por Elsës i hap punë kabinistja.

— Shoqe, po më thonë nga centrali se personi me të cilin folët nuk do që të largohet nga telefoni. Ankohet se nuk ka dëgjuar një gjë të përtë të rëndësishme.

Elsa mbetet e shikon përreth e hutuar.

— Asgjë, asgjë! — thotë pastaj me ngut.

Do t'i telefonoj përsëri nesër. — E bën të ikë.  
— Po ai nuk largohet, — ngulmon kabinistja,  
— kërkon patjetër shpjegim.

Nga pamja e lodhur, që tregonte pak më parë fytyra e shoqes së shërbimit telefonik, nuk ka mbetur as edhe një gjurmë. Ajo, buzagaz, nuk po ia ndan sytë Elsës.

Studentja, e zënë ngushtë, i afrohet, përkulet sa mundet përmbi banak dhe diç i pëshpërit.

— I thuaj që nuk është e rëndësishme.

Kabinistja përcjell fjalët e vajzës nëpër telat e ngarkuar me dëborë. Pastaj pulit sytë, ul do-rezën e shkrehet në gaz.

— Nuk largohet kurrsesi... C't'i themi?

Elsa me sy u kërkon ndihmë shoqeve. Ato afrohen përsëri, po nuk japid dot udhë. Bile, ajo më e imta, që mban një shall të bardhë, është gati të shpërthejë në të qeshur.

Elsa këtë herë futet brenda banakut dhe në mirëbesim i pëshpërit në vesh kabinistes fjalët e saj të fundit, që ajo e gjora i pati thënë pa e vrarë mendjen, por ja që ato befas na u bënë me kaq rëndësi, sa po mobilizojnë tërë linjat e Veriut.

Kabinistja qesh e tund kokën.

— Dëgjo këtu, — i thotë pastaj shoqes së saj në central me zë të ulët, — i thuaj atij djalit se Elsën e ka marrë malli... Po. Kjo ishte ajo gjëja e rëndësishme... Nuk të dëgjon mirë as ty?... Le t'ia thotë Tropoja... Ti thuaja Tropojës, t'ia thotë Kamit...

Njëra nga shoqet e Elsës nuk duron dot më tej, ia plas gazit e pastaj nxiton ta shuajë e ta mbytë duke mbuluar fytyrën me shall.

— Lula! — e godet me bërryl tjetra. Vetullat i janë tendosur hark e duket sikur do ta përpjegë shoqen me sy.

Elsa bëhet flakë e kuqe dhe nuk do që nuk do ta hedhë vështrimin në sallë. Aty një pensioni stur kurdis orën e xhepit. Dy ushtarakë ndezin cigaret. Një djalë i ri, i mbështetur te banaku, lëviz me çelësa, që i ka shkuar në një unazë të nikeluar. Dy mesogra flasin duke fshehur buzët me pëllëmbë. Ata që shkruajnë telegrame, ngjyrenë më nge penat dhe mbajnë vesh. Të porsamartuarit, që tani po rrinë më natyrshëm, ia kanë lidhur duart njëri-tjetrit dhe po e mbajnë frymën pezull duke ndjekur me ëndje shqetësimin e studentes.

Të gjithë qeshin. Qeshin me Elsën. Por, ama, të gjithë bien dakord se sonte u provua edhe një herë që shpikja e telefonit është e domosdoshme. Thellë-thellë ata të gjithë janë të dëshiruar që fjalët e vajzës, ato fjalë me vlera të jashtëzakonshme duhet të shkojnë aty ku duhet. E ndiejnë ata se është një kohë në dashuri, kur të gjitha bisedat, të gjitha pusullat, çuçuritjet, tokjet e duarve, nisjet, mbërritjet, të gjitha pritjet... janë të një rëndësie monumentale. Përpara tyre bëjnë udhë me respekt të gjitha puthjet e përqafimet e mëvonshme, muajt e mjaltit, netët në shtratin e përbashkët e udhëtimet në shoqërinë e fë-

mijëve. Mbi këto të gjitha erozioni i harresës mund të bëjë kërdinë duke i përgjysmuar, gërryer e fshirë. Po për të parat, rreket më kot, se nuk ka ç'u bën.

— Në rregull, — përfundon kabinetja. — E sqaroi Tropoja. Mund të ikni e qetë.

Elsa bashkohet me shoqet. Me hapa që sa vijnë e përshpejtohen, ato kapërcejnë portën e dalin jashtë.

Jashtë, një pemishte e dendur, e lulëzuar, me trungje të padukshme, tund degët e lëshon përmbi tri shoqet petale të bardha.

1987

# *Një variant i papërdorur*

## *Monolog*

Drejtori i teatrit ndodhet në zyrën e vet.  
Trokët dera.

DREJTORI — Hyr (*Shfaqet Filipi.*), hajde, Filip...  
Të prisja... Kam shumë nevojë për ty.  
(*I zgjat paketën.*) Cigare? (*Filipi e merr, drejtori ia ndez.*) Filip, të merremi vesh si burrat... Të kam thirrur vetëm të ulesh e të më dëgjosh... Nuk dua asnje mendim nga ti. T'i di mendimet... E di që për këtë problem, në thelb, nuk je dakord me mua. Po përbaje veten. Më lër mua, drejtorin e teatrit, të bëj, si i thoni ju aktorët, një monolog. Dëgjo, Filip:

Ti je i paaftë!... Këtë, tashmë, e dinë të gjithë. Kjo nuk ka diskutim! E thonë spektatorët, e thonë regjisoret, e thotë këshilli artistik. Puna është... që ta themi

copë, ne nuk të heqim dot... Bëmë relationin e parë, e paraqitëm në nomenklaturën përkatëse... Ishte gati për t'u aprovuar... U prish. U prish se njëri tha: «Le t'i japim Filipit edhe ca kohë, mbasë shkëlqen!» Ashtu u bë. E pritëm shkëlqimin tënd disa vjet. Hiç... Bëmë shkresën e dytë. Këtë radhë largimi yt nuk diskutohet. Por... phë! U gjend aty, se një baxhanak i kushërit, se një kushëri i baxhanakut tënd, dhe tha, në mes të të gjithëve, që talentet nuk zbulohen kollaj, se as Aleksandër Mojsiu nuk e tregoi dot veten që në fillim. E kjo puna e Mojsiut zuri vend, se Mojsiu nuk është dokushdo, ka peshë ai... Veç me atë, që nuk e paska treguar veten që në fillim, na ka prishur punë sa s'thuhet, se nga ky sebep nuk të heqim dot as ty, as ndonjë tjetër, për t'ua liruar vendin atyre që e meritojnë... Bëmë përcapjen e tretë... Nuk të heqim dot! U tha se duhet të na vijë keq, se Filipi ka pesë vjet në teatër, ja edhe njëzet e pesë të tjerë të mbeten, pastaj del në pension... Të mendojmë për njeriun... Neve, nga njëherë, na dhemb më shumë njeriu, se njerëzit që presin nga ky njeri. Se ky njeri është konkret, ka emër, mbiemër, grua, nënë, baxhanak... Kurse njëz i tjanë njerëz në përgjithësi, me emrin e përbashkët spektatorë, klientë,

pasagjerë, qytetarë... E nuk u pyet për ta.  
U pyet për Filipin... E mbete... Na mbete,  
o Filip! Nuk të heqim dot!... Përpjetë të  
hidhemi ne, kjo punë kështu u nis... Veç  
një njeri e ka në dorë këtë... I v e t m i!...  
Ti... A na ndihmon?... A nuk ikën vetë?!

Filipi, që deri tani nuk ka folur, kërkëses së drejtorit i përgjigjet me një buzëqeshje të ëmbël dhe nxjerr gishtin tregues përpara si për t'u mbrojtur dhe e tund me ëmbëlsi.

Kjo do të thotë: Jo-jo-jo-jo!

1985

# *Shënime të tjera nga bloku*

1

Plot katërmبëdhjetë orë që Mersini po flinte.  
Pastaj Mersini u ngrit, bëri një orë pushim dhe  
ra të flinte përsëri...

2

Nganjëherë, kush punon mirë, shpërblehet  
duke e ngarkuar me një punë më të rëndë. Kush  
nuk punon, dënohet duke e lënë të qetë.

3

Nga fajet e përrallave për fëmijë:  
«Dyzetkëmbëshi po e shihtë pisk: Atij ia kishin  
vënë këmbët në një këpucë.»

Mblesi është ai njeri që sjell e merr mesazhet e dashurisë së zjarrtë e të pakufishme që ushqejnë për njëri-tjetrin dy njerëz që nuk janë njohur akoma.

— Ah, mor burrë, ti nuk do që t'ia dish pér shijet e mia!... T'u luta që stofin pér fustan të ma blije ngjyrë tulle. Ti e hodhe kërkësën time prapa kurrizit. Nga bojë tulle, ma bleve stof të bardhë!

Burri zihet ngushtë.

— Bojë tulle!... Po ja, tulla të bardha ka plot...

Treni ka ndaluar në stacion. Pér të tretën herë dëgjohen rregullat nga eltoparlanti:

«Prindërit që kanë fëmijë me moshë mbi pesë vjeç nuk mund t'i marrin me vete pa pagesë, por duhet t'i pajisin ata me biletë me gjysmë çmimi...»

«Përmbi pesë vjeç, me gjysmë çmimi...»

Brenda në vagon një tetë përkëdhel një fëmijë që është ulur përbri mamit të vet.

— Sa vajzë e bukur që qenkeee!... Sa vjeçë je, të këqen teta?

— Përjashta jam gjashtë vjeç e gjysmë, kurse këtu në tren nuk i kam mbushur akoma pesë!...

Ngjitur me ne, në kabinën e plazhit numër katërbëdhjetë, pushon një çift që grindet vazhdimisht. Për të mbuluar zhurmën e zënkave të tyre, ata e kanë gjetur: ndezin radion. Kur aca-rohen shumë, e ngrenë më shumë e të sharat nuk dëgjohen.

Njëherë në mes të natës ne u ngritëm të llahtarisur.

Në kabinën katërbëdhjetë, në kupë të qieillit buçiste një këngë dashurie. Mend po na shurdhonte:

*Sa të dua ty, moj, sa të dua ty!*

*Sa të dua ty, moj, sa nëna evlanë!*

Fëmija trevjeçar i afrohet një shisheje boshe. Në të është ngjitur etiketa «Raki rrushi».

— Mami, — thotë fëmija, — kjo shishe paska erën e babit.

## Përfaqësimania

(Kjo është një bisedë midis një dramaturgu që ka dhënë disa prova të pasigurta, — ne po e quajmë Reshat, — dhe një kritiku, — hajd ta quajmë Merqez. Kritiku në fjalë, meqenëse për dramaturgjinë shkruhet pak, ofrohet dhe mbush, nganjëherë, në ndonjë gazetë, ndonjë kolonë që duhet mbushur me probleme teatri. Sa të presim kritikët e mirënjohur! Kritiku ynë merr vesh datat e provave të përgjithshme të spektaklevë, drama, koncerte apo variete qofshin, dhe gjendet i pari në sallë. Nuk diskuton, por vë vesh, dëgjon e mban shënimë. Pastaj, kur shkruan, në përgjithësi nuk hap telashe. Flet mirë për ata që është folur mirë e shan ata që janë sharë...)

RESHATI — Si t'u duk boceli i dramës që të dërgova? Së shpejti dua të ulem ta shkruaj dhe...

MERQEZI — Hm, po! Shtytja e brendshme që ke, më pëlqen. Dhe tema. Shtjella është pikante... Mmm... (*Shtrëngon ballin me gishta.*) Ma rikujo pak fillin! (*Duke u shfajësuar.*) Se lexojmë shumë e na ngatërrohen. Vetëm sot kam lexuar tri drama!

RESHATI — Është ai mjeku në atë qytetin... Që ka nënën në shtëpi... Që mezi e pret...

MERQEZI — Lëre! M'u kujtua.

RESHATI — Si të duket?

MERQEZI — Ç'të të them? (*Mendueshëm*) Ja, do të të them ndonjë fjalë sa për të të hapur horizont... (*Mendueshëm përsëri*) Del aty ndonjë mjek që punon në fshat?

RESHATI — Jo. (*Pauzë*) Ç'më duhet??

MERQEZI — Po duhet, se krijohet përshtypja e gabuar se të gjithë mjekët i kemi në qytet. Mjek është apo mjeke?

RESHATI — Mjek pra!

MERQEZI — (*i preokupuar*) Po a nuk të shqetëson fakti që s'na del as edhe një mjeke? Femra që kanë studiuar për mjekësi ne kemi plot. E ato shërbejnë kudo. Nuk të shqetëson?

RESHATI — Aspak.

MERQEZI — Ti qofsh! (*Pauzë*) Po nëna e mjekut, përse merakoset për djalin?

RESHATI — Se vjen vonë ai... shkon nëpër vizita... Edhe në mes të natës.

MERQEZI — Gjë e bukur! Një akt pa bujë. Një heroizëm gradual, i heshtur... Veç më

shqetëson ajo nëna. Ah, nënë, nënë!

RESHATI — Ç'ke me nënë?

MERQEZI — A nuk të duket se do të krijohet përshtypja që nënët tonë merakosen e si shumë për djemtë?

RESHATI — Jo. (Përtypet) Kjo është vetëm një nënë... Ka të tjera jeta.

MERQEZI — I fut dot ato të tjerat?

RESHATI — Jo. Të gjitha të tjerat nuk i fut dot.

MERQEZI — Shiko, mbas i fut. Të kemi sa më shumë nënë. Tjetër... Ç'profesion ka ajo vajza që do të martohet me mjekun?

RESHATI — Rrobaqepëse.

MERQEZI — Hm... Mirë por... Ku di unë!... Del se rrobaqepëset tonë janë të martuara me mjekë.

RESHATI — Jooooo! S'është ashtu!

MERQEZI — Nuk është... Po këtë e dimë unë e ti. Ç'shkruhet në letër, mbetet. Dramën e shohin të gjithë. Ke personazhe të tjera? M'i kujto një çikë.

RESHATI — Posi! Kam njërin aty që më bezdis çiftin në plazh...

MERQEZI — Ç'profesion ka ky personazh?

RESHATI — Hiç. Pa profesion.

MERQEZI — I papunë?! Ti e di se te ne nuk ka të papunë.

RESHATI — Jo, ai punën e ka, po them se nuk më duhet.

MERQEZI — Sa sipërfaqësisht gjykon! Po kjo do të të përcaktojë se si do të veprojë ky njeri, se çfarë botëkuptimi do të ketë.

- RESHATI — (Kuturu) Ja, po e vë tornitor.
- MERQEZI — E ç'thotë ky tornitori?
- RESHATI — Asgjë. Më nevojitet aty që të bezdis çiftin tim.
- MERQEZI — Tornitorët tanë nuk bezdisin.
- RESHATI — (Paksa nervoz) O po rri aty... shtri-rë. Nuk i ngacmon. Po prania e tij i bezdis. Se është afër, aty diku në rërë... nën një çadër shkurt: s'do të merrem me të. E kam figurant.
- MERQEZI — Figurant?! Një tornitor figurant?! Ti s'je në vete! Ti duhet ta vendosësh atë në qendër të dramës e rrëth tij të sillet e gjithë drama.
- RESHATI — Si të sillet drama rrëth tij?!
- MERQEZI — Ku e di unë! Kush po e shkruan dramën, unë apo ti?! Unë po të hap horizont.
- RESHATI — Tornitori im nuk flet.
- MERQEZI — Ai duhet të flasë me forcë. Vëri një tekst të fuqishëm.
- RESHATI — O po e hoqa fare tornitorin! Më erdhi në majë të hundës. E hoqa.
- MERQEZI — Je i pavendosur. Në këtë punë duhet këmbëngulje! Ja e hoqe tornitorin Kush do ta bezdisë çiftin tënd?
- RESHATI — Askush. Nuk do të vë asnjë.
- MERQEZI — Mëkat, se ai është episod i bukur!
- Dy të dashuruarit duan të bisedojnë, dikush i bezdis... Vër, vër ndonjë aty.

RESHATI — Cilin tē vë?

MERQEZI — Ku di unë!... Po tē qe drama ime...

RESHATI — Nuk po vë. Çifti le tē këndoje. Plazh  
është...

MERQEZI — Mirë. Çfarë kënge do tē këndoje çif-  
ti? Duhet tē jetë duet, patjetër.

RESHATI — Sigurisht. Derisa janë dy!

MERQEZI — Duhet tē kesh edhe ndonjë solo, se  
del sikur... (Prerë) Të ketë solo. Dhe men-  
dimi im është tē jenë këngë tipike. Ja,  
p.sh., q'këngë mund tē jetë?

RESHATI — E muzikës së lehtë.

MERQEZI — Domosdo. Ashtu shkon. Por... le tē  
marrin dhe ndonjë popullore. Qoftë dhe e  
përpunuar. Kënga tē jetë për dashurinë,  
po ti fut edhe një këngë për punën. Tema-  
tikën e fshatit e ke vetë parasysh. Motivet  
tē jenë nga tē tëra krahinat e vendit. Të  
përfaqësohen trevat... Ajo që do ta mbu-  
shte atmosferën fuqishëm, është një kën-  
gë korale. Me këtë ta çelje.

RESHATI — Korale?!

MERQEZI — Pse?! Plazh është? Ata nuk janë ve-  
tëm atje. Fute pa drujtje. Fute, dëgjomë  
mua!

RESHATI — (Duke fshirë djersët.) Kështu ngatë-  
rrohem keq.

MERQEZI — Pse?

RESHATI — Pastaj kjo do tē kërkonte dhe një  
këngë për fëmijë.

MERQEZI — Le tē kërkojë.

*Pauzë. Reshati bie në mendime.*

RESHATI — Po sikur të fut edhe një valle?

MERQEZI — Kjo do ta larmizonte shumë.

RESHATI — Po a nuk më zgjatet pa masë drama?

MERQEZI — Zgjatet vërtet, por ama përfaqëso-hesh mirë.

RESHATI — (*I dëshpëruar*) Po drama, drama??!

MERQEZI — O po lëre dramën, se na çmende!

Me një koncert e hedh lumin shkëlqye-shëm. Kur s'di ta bësh dramën, ç'i hyn asaj pune??!

RESHATI — (*I dorëzuar*) Mirë thua, s'po e bëj.

MERQEZI — (*I zhgënjiyer krejtësisht*) Pah, sa vullnet të dobët që ke! E sheh? U tërroqe. E pra, ndihma ime nuk të mungoi. Të hapa e të hapa horizont, po ti... (*Duke e parë që pas Reshatin që po largohet, tund kokën.*) Ç'të presë dramaturgja nga të tillë njerëz!

## Bërtitje në trekëndësh

Përgjegjësi i degës ushqimore, Neço Plasa, hyri në dyqan pa u ndier, por, kur pa se ç'po ndodhte aty, u tromaks:

Një klient i vëtmuar, aspak i shkathët, me sa dukej; kishte përbysur përpara banakut çantën e ushqimeye të blera dhe, më shumë i hutuar se sa i dëshpëruar, e shikonte shitësen me sytë e një fajtori.

Ajo nuk e pa shefin e vet. I qe vërsulur klientit me ca të shara që nuk kishte kandar t'i mbante:

— T'u thafshin duart, t'u thafshin! Ku e ke mendjen?! Yh, i humbur!

Dhe, pasi e shtyu me shkelm portëzën e banakut, u derdh me këtë anë në sallë duke vazhduar të shfrynte:

— I humbur, i humbur! Më të humbur nga ti nuk më kanë zënë sytë.

Klienti, i përkulur përmbi bërlokun e ushqij-

meve të porsablera, nuk dinte ç'të zinte më parë.

— Më qenka këputur doreza e çantës! — bërtiste ai i mekur. — Oh, më paska plasur shishja e vajit!

— Të plastë koka! Duhet të laj edhe dyqanin tani!

Një njollë e madhe vaji po vizatohej mbi dysheme. Si një rreth i madh i lyrtë, ajo zgjerohej e zgjerohej.

— Yh, i lënë!... Hajde, luaji duart! Duartharë! Buf!

Neço plasa nuk po u besonte veshëve. Me hap të vendosur ai u afrua në vendin e ngjarjes. Klienti e vuri re i pari dhe nuk lëvizi, kurse shitësja, sa e pa, u turbullua. U ngrit në këmbë e zbehëtë, me buzët që nisën t'i dridheshin.

— Shoku përgjegjës!... Urdhëroni!

— Kam ardhur me kohë dhe i dëgjova që të gjitha, — ia ktheu Neçoja, që mezi po e mbante veten.

— Shikoni se si ndodhi... — mundohej të shpjetonte shitësja.

— Të keni turp! — ia preu Neçoja. — Kujt i bërtitni ashtu ju?!

— Të më kuptioni, shoku Neço, ky shoku këtu...

— Aaaa!... U kujtuat, më së fundi, ta quani shok? Se deri tani çfarë nuk i thatë: duartharë, buf, i humbur...

Neçoja e la për një çast punonjësen e tij dhe iu kthye klientit të hutuar:

— Më falni që po i përsërit këto, eh! — Dhe,

pasi nuk mori ndonjë miratim nga fytyra e budallallepsur e njeriut me çantë të përmbysur, iu vërsul përsëri shitëses: — Kujt i bërtitni ju? Sa herë ju kemi porositur që me klientët të silleni mirë? T'i prisni me buzë në gaz e t'i përcillni me... me... Kjo është alfa e tregtisë!

— Unë... gjithmonë... për mua nuk ka asnë ankesë, — belbëzonte gruaja, e zënë në faj. — Ja, pyesni, po të doni... Por, ky që shihni...

Përgjegjësi nuk donte të dëgjonte asnë nga shfajësimet e saj.

— Nesër në mëngjes të paraqitesh në zyrë, tek unë!

— Shoku përgjegjës...

— Asnë fjalë! Sa përshtypje të gabuara që paskemi për ca nga punonjësit tanë!. Hyn në një njësi ushqimore dhe dëgjon «buf», dëgjon «duartharë», «i lënë», dëgjon «të plastë koka»...

Eprori i kërkoi edhe një herë klientit të falur për përsëritjen e atyre fjalëve aspak të hijshme dhe vendosi t'i jepte fund kësaj skene banale.

— Turp të keni! Nesër, në zyrë!

Neçoja i ktheu krahët shitëses dhe u nis të dilte, por ajo, me druatje, e zuri nga mënga.

— Më falni, t'ju jap një sqarim të vogël... Ky shoku... klienti... nuk është thjesht klient... është burri im.

Kjo në thelb nuk ndryshonte asgjë. Megjithatë Neçoja ndjeu një sëmbim në stomak.

— Burri?!

Përgjegjësi, i turbulluar, vështroi klientin e

gjorë, që kishte aq kohë që po rrinte i nemitur dhe vuri re që fytyra e burrit tani e kishte humbur hutimin dhe, për çudi, ishte ashpërsuar. Turbullimi i Neços atij i kishte dhënë zemër. Ai u ngrit në këmbë dhe nuk e la përgjegjësin e gruas ta merrte veten.

— Eee, burri! — përsëriti ai. — Tani t'ju pyes unë: Kujt i bërtitni ashtu ju?

— Nuk kuptoja, — belbëzoi përgjegjësi.

— Çfarë nuk kupton, more! Me ç'të drejtë i bërtet asaj?! Le të jesh përgjegjës, qofsh shëndoshë! Dënoje, gjobite, bëj ç'të thotë rregulli... Oj, i bërtet tjetrës sikur... Ka burrë ajo! Ka kush i del zot!

Ka ca njerëz, që marrin zemër e trimërohen nga forca e zërit të vet. Neçoja nuk po e mblidhët dot veten.

— Ju... zot?! Po ajo ju bërtiti, ju quajti...

— Le të më bërtasë! Më ka burrë!

— O po le të bërtasë, meqë ke qejf ti, — filloi ta merrte veten Neçoja, — po këtu unë të kam klient e do të marr në mbrojtje.

Shitësja e kthente fytyrën e trembur me një shprehje lutëse sa te njëri te tjetri.

— Unë nuk dua të më marrësh në mbrojtje, — thoshte i shoqi.

— E po unë do të mbroj! — ngulte këmbë përgjegjësi.

— Shoku përgjegjës! — i lutej gruaja Neços. — Spiro! — qortonte të shoqin.

— Rri, moj, ti! — i ulëriu i shoqi. — Më quaj si

të duash. Të kam thënë gjë unë?... Por, unë këtu, ai të m'i bërtasë gruas! Nuk duroj... Kam dinjitet unë!...

Dyqani nisi të mbushej me klientë të tjerë. Neçoja po e ndiente veten ngushtë. Kjo ngjarje befas u bë e pavolitshme për të.

— Or shok, këtu në dyqan unë nuk dua të dëgjoj fjalë të ashpra. Unë të marr në mbrojtje.

— Më hëngri me këtë mbrojtje ky! Nuk dua mbrojtje! — përsëriste burri.

Pa u thelluar aspak, klientët që po i qarkonin, nisën ta shikonin me antipati përgjegjësin. Familja për ta ishte më e ndjeshme. Neçoja e kuptoi këtë dhe nxitoi ta mbyllte.

— Ja ku po ju jap fjalën, — i tha prerazi burrit, — për këtë rast nuk do të marr asnje masë! Dëgjove?! Asnjë masë! Natën e mirë!

Përgjegjësi i degës ushqimore çau turmën e doli nga dera. Kureshtarët pyesnin njëri-tjetrin, po që të gjithë ishin ndodhur aty vetëm në fund. Kureshtjen e tyre nuk po e ngopte as shitësja e as i shoqi. Ky i fundit akoma i mbante sytë nga dera dhe turfullonte:

— Tuhaf njeri! Vjen e fut hundët në punët e tjetrit! Pa pikë turpi vjen e të fut zjarrin në familje!...

## *Dy vajza na presin rrugën*

Mbështetur në xhamillëkun e dyqanit, me duart mbi rripin e mesit, në një sfond të jeshiluar kastravecësh, ka zënë vend djaloshi parazit Lesko Bulluri. Pas pak, me sy të fryrë nga gjumi i pasdites, vjen e mbështetet bri tij edhe Bashkim Tata, i cili, për të marrë një pamje moderne, thith hera-herës njërën nga dhëmballët e sipërmë.

— Erdhe, Baçi? — Lëskos i pëlqen ta trashëzërin më shumë nga ç'e ka.

Është ora kur qyteti punëtor gjallërohet përsëri nga njerëzit që lënë punën.

Dy të njohurit tanë shohin vajzat.

— A kaluan ato?

— Jo akoma,

— Aha! — Baçi thith dhëmballën. — Nthë!

Pastaj nxjerrin paketat. Secili të vetën. Kuti «Arbëria» të stërpërdorura. Bashkimi në të sot ka pesë cigare. Të ndryshme. Një «Partizani», që

ia ka vjedhur të atit, një «Porti» nga paketa e harruar e vëllait të madh, dy të dredhura nga duart e gjyshit dhe një «Tarabosh». Kjo është dhuratë e gjyshes. Ia vlen të ndizet në prani të gocave.

— Baçi, futu e na e ndiz në kafe! — jep urdhër Lesko Bulluri.

Lëvizjet e tyre janë të ngathëta, moderne. Bashkimi hyn në kafe duke thithur dhëmballën: «Nthë, nthë!»

— Me leje, shoko? — dhe djaloshi ngel shtang me cigaren majë më majë me profesorin e gjuhës shqipe.

— Bashkim! Ku je, more djalë! Paske filluar duhanin?! E po domosdo, u rrite! Tani je në punë... lexova për ju në gazetë... Ua morët dorën punëve të bujqësisë?

Bashkimi meket. Duhet një gënjeshtër me foljen «marr» në kohën e kryer e thjeshtë, veta e parë, shumës...

— Ia morëm, profesor, — përgjigjet Bashkimi.

— Ju lumtë! Lodheni?

«Mënyra dëftore, koha e tashme, veta e parë, shumës!» — thotë me vete djali.

— Lodhemi.

— Kanë ardhur të gjithë atje? A ka ndonjë që i ka bërë bisht?

Gënjeshtra tani duhet në formë ndajfoljeje.

— Pa përjashtim.

— Ndize. E paske me të dredhur. Tamam si nga fshati.

Bashkimi nxjerr një pasthirrmë të turbullt, fa-

lënderon dhe me cigaren e ndezur shkon te Leskoja.

Babai, profesori, vëllai, shokët... Të gjithë e vënë në pozitë të vështirë Bashkimin. Nthë! (Dhëmballa)

— S'po vijnë hala ato, Baçi... Pah, si na vështruani dje, eh? Sot do t'i ndalojmë.

— Do t'i ndalojmë, — thotë Baçi. — Nthë!

— Veç ti mos merr kot me to. Bëj si të bëj unë.

— Dakooord! Nthë!

Ç'ti bësh! Leskoja ka stazh. Dhjetë punëra ka refuzuar deri tanë.

Pa mbaruar marrëveshja e çunave, dy vajza duken tutje me sytë e ngulur përmbi ta.

— Po vijnë, Baçi!

Janë po ato dy vajza që përditë, shkak e pa shkak, u sillën rrrotull e, me sa duket, duan të njihen me ta.

— Këtej i kanë sytë, — i thotë Baçi duke thithur cigaren e gjyshit e duke shtrirë mbi bark pulovrin e vëllait.

Duket që vajzat po bisedojnë për ta, sepse besfas njëra nga ato merr guximin:

— Me leje? A mund të bisedojmë pak?

Kulmi! Pa pikë zori, eh?! Çunat shkelin cigaret, afrohen dhe përkulin kokat. Lesko Bulluri rrëmbejn iniciativën:

— Për ju po bisedonim... Kishim shumë dëshirë të njiheshim. — Dhe, duke zgjatur dorën, paraqit veten: — Lesko Bulluri, arkitekt!

«Bubuuu, ia veshi kot!» — thotë Baçi me vete.

— Kurse shoku është Bashkim Tata, pedagog stazhier i gjuhës frënge, — vazhdon «arkitekti», duke projektuar aty pér aty një gënjeshtër në kurriz të Bashkimit, i cili nga frëngjishtja di vetëm fjalët «*inoksidabël*», «*lëvevu*», dhe «*asejuvu*»!

— Aha! — thotë ajo me gërshtet. — Po intérsanf, pse rrini gjithë ditën bashkë, në këtë vend? Një arkitekt dhe një pedagog i frëngjishës?!

«Arkitekti» ngec. Sheh nga «pedagogu». Ky nxjerr paketën. Me gisht shtyn «Portin», shtyn «Partizanin» dhe vë në buzë «Taraboshin». Pastaj kujtohet që nuk ka shkrepëse dhe fut përsëri cigaren në paketë.

«Inoksidabël!» shan me vete.

Tjetri nuk dorëzohet.

— Pse vijmë këtu?! Po ja, po mendojmë të projektojmë ndërtesën e re të shkollës së gjuhës frënge.

Fjalën ia merr Baçi:

— Nthë! Shkojmë t'ju jap nga një bozë dhe, po pati, po pi edhe unë një fërnet.

— Pse bozë?! — thotë Lesko Bulluri. — Unë kam në plan t'ju jap nga një birrë. Shkojmë këtej?

Gjithnjë i çuditshëm ky Leskoja. Ku i gjeti paratë?!

Po gocat nuk pranojnë.

— Shkojmë më mirë këtej, — thonë ato. — Në komitet të rinisë.

Leskos i hollohet zëri.

— Ju... punoni në komitet të rinisë??!

— Jo, ne punojmë në ndërtim. Jemi në kontrollin shoqëror të rinisë. Jemi mobilizuar në aksionet kundër rrugaçërisë e parazitizmit.

«Arkitektit» nis t'i vijë vërdallë kati i sipërm. «Francezi» tanë vërtet nuk po e kuption shqipen.

— Ne ju njohim mirë, — thotë biondja. — Ejanë të shkojmë tok.

«Arkitekti» ia mbath me vrap. Bashkimit i vjen zor. Psherëtin dhe shkon tok me to.

Në komitet shokët e shohin me keqardhje.

— Ju jeni i vëllai i Adrian Tatës, eh? — pyet dikush.

— Po, — përgjigjet Baçi. — Ku e dini ju?

— Të njohim nga pulovri.

I flasin rëndë. Për rrugën pa krye. Për rrugën e keqe. Për Leskon. Për rrugaçin Lesko Buluri, të cilin parazitizmi e ka çuar deri në vjedhës xhepash.

Bashkimit sikur i bie tavani. Edhe ai rrinte me të! I ngrihen mornicat.

Del nga komiteti si i shushatur. Në shtëpi gjen një atmosferë shumë luftarake.

— Të jap pesë ditë afat! — i thotë babai. — Me shokët!

— S'ka nevojë për pesë ditë, — ia kthen Bashkimi. — Që nesër!...

## *Telat për violinë*

Të them se kam bërë një padrejtësi, nuk është tamam ashtu... E megjithatë, net të tëra nuk më ka zënë gjumi.

C'të kisha bërë, o Andon Ledhi, që më nxive qershorin, më hidhërove me të afërmit, më nevrite bar-lulishtet, detin, telefonin e zilen e apartamentit tim të vjetër, atë zile që imiton kaq bukur zërin e kanarinës? Pse, o Andon, më shtyve zgjerimin, po më lë edhe ca muaj më shumë në atë apartament të ngushtë, me një baba në ngarkim, një grua e një djalë të vockël?

Pse, o Andon Ledhi, më shpure deri aty e tanë më bren ndërgjegjja dhe e ndiej fajtor?!...

Në një ditë të bukur qershor, në shtëpinë time, ndërsa dëgjoja e ridëgjoja në magnetofon

pesazhe orkestrale nga simfoni të pavdekshme, u hap dera e dhomës e babai më tha se kishte ardhur vëllai im i madh, Rushani. Po Rushani nuk priti, mënjanoi babanë dhe u fut drejt e në dhomën ku isha unë.

— Dëgjo, Muço, — më tha, — do të bësh çmos të pranohet në konservator djali i një mikut tim.

Bashkëshoqërimi muzikor i kësaj kërkese ishte fare i papërshtatshëm. Unë mblojha supet.

— Po këtë e ka në dorë komisioni i pranimit. Unë nuk bëj pjesë në komision.

— Je caktuar kryetar, — më tha. — I kemi marrë vesh të gjitha.

Këtu magnetofoni sillte në veshët tanë ca akorde madhore, monumentale, dhe unë tendosa vëmendjen të mos më kalonte ky pasazh.

— Andon Ledhi quhet, dëgjon? Andon Ledhi... Ledhi Andon. Është biri i doktor Kozmait, atij mijekut të zemrës. — Dhe aty për aty iu kthye baba: — Eh, baba, ti je vizituar ndonjëherë tek ai?

— E ç'dua të vizitojem? — ia priti babai me përcim. — Unë nga zemra jam top.

— Ah, nuk i dihet zemrës! — Dhe Rushani vendosi vetë, prerë: — Do të vemi ndonjë ditë për një kontroll.

Unë ndala magnetofonin dhe i përhumbur vështrova në sy Rushanin.

— Andon Kozma Ledhi! — theksoi im vëlla dhe u ngrit e iku.

Kur mbetëm vetëm, babai pa nga unë, pastaj vuri dorën në gjoks, nga ana e majtë.

— Phë! — tha ai duke qeshur, — Po zemra ime ç'hyn këtu? Pyet ky motori im pér doktor!...

\* \* \*

Im vëlla, Rushani, ishte i pari... I dyti u bë Koçi, kushëriri i parë i gruas, një tip i shkathët, i hedhur, si janë përgjithësisht kamerierët e lokaleve të kategorisë së parë. Ai më mori në telefon:

— Nesër, — më tha, — të pres në lokal. Kam një bisedë tepër të rëndësishme. Zëmë një tavolinë të qetë dhe bisedojmë më nge. Kam ditën e pushimit.

I vajta. Koçi porositi kafet dhe, pasi pimë gllënjkat e para, vuri duart përmbi filxhan, zgjati kokën përpara dhe më pa drejt në sy:

— Muço, dua të më bësh një nder. Kurrë s'të kam rënë në qafë. Kurrë s'të jam lutur. Ps't as gjë. Tani dua... Mos më pyet si e qysh e pse!... Mbyll sytë e ma bëj!

— Pa të shohim, — i thashë.

— Oh, fillove ti me të shohim e s'të shohim! Thuaj s'ta bëj e pikë muhabeti!

Koçi u mërzit e piu dy gllënjkë të tjera.

— E po hë, — i thashë, — thuaje, të shkretën! C'do nga unë?

— Do ma bësh? — dhe Koçit i ndritën sytë.

— Po... varet, a e bëj dot!

— E bën ti, e bën! Kam një njeri, dua të ma futësh në shkollë. Për muzikë.

«Bobo... — mendova, — filluan këto kërkesa të bezdisshme!» Kaq kohë isha lutur të mos më përfshinin në komisionin e pranimit, por ,në fund të fundit, më bindnin se pjesëmarrja në komision ishte një detyrë e rëndësishme.

— Do ta bëj! — i thashë. — Ka marrë fund!

— Më qafsh! Nuk do të ta harroj. Nuk besoja kurrë se do të thoshe «po» me të parën.

Unë ia shtrëngova dorën me një lëvizje disi teatrale.

— E them dhe e bëj! Është ndonjë çikë i talentuar?

— Nuk marr vesh nga ato gjëra unë! — tha Koçi i bezdisur. — Ti je profesor.

Profesorziu! Të thonë profesor e të pengojnë të bësh detyrën e profesorit...

— Mirë, — i thashë, — po u binda që është i talentuar, do ta tund. Bile-bile, të them, zëre të mbaruar.

Po Koçi nuk ngopet me lugë të zbrazët.

— E në mos qoftë aq... i zoti? — pyeti duke rrudhur vetullat, i merakosur.

Unë vazhdoja ta pija qetë kafen.

— Po të mos jetë, nuk kam ç'i bëj. — Dhe, kur pashë që ai u mërzit, nxitova: — Ama, po të jetë i talentuar, vendin e ka të sigurt.

— Po ajo s'do mend! — Shtyu filxhanin e zbraszur Koçi. — Po të jetë i talentuar, ai do të hyjë... Kjo ia bën muuu! Ku qëndron atëherë nderi që do të më bësh??

— Asgjëkundi! — ia ktheva. — Bile mund të mos më thuash fare falemnderit. Unë nuk do të mërzitem.

Ai u prek.

— Tallesh me mua ti, apo si e ke hallin?! Unë flas seriozisht, ti më hedh degë më degë.

— Për se do të japë prova?

— Për violinë. Ama është djalë i mrekullueshëm. Xhanan djalë. I vetëm. Prindërit lënë kokën për të. Është mësues në një shkollë fshati. Tre vjet u bënë. Dite për ditë, nga dy orë rrugë me bicikletë. Ti e kuption...

— Është përgatitur ndonjë çikë?

— Po di unë! — Koçi ngriti supet. — Më lë tabakaja mua? Duhet të jetë. Ja, do t'i vemi në shtëpi, ta shohim bashkë ndonjë ditë. I ati na pret me kënaqësi.

— Ah, jo, jo. Nuk vij, — nxitova t'i thosha unë. Koçi u prek, po nuk e bëri veten.

— Vetëm në qoftë budalla të mos jetë përgatitur. Sidoqoftë... shpresat te ti.

— Aaaa... — nisa unë.

— Hë, o Muço, më qafsh, mos u bëj kaq buzëmbledhur dhe ti! — Këtu Koçi m'u afrua më shumë, shkeli syrin e djathëtë dhe më tha gati duke pëshpëritur: — Po të jetë i aftë, kjo të lehtëson e duket sikur e fute ti. Po të mos jetë... po të mos jetë... shtyje ca ti, se, me sa marr vesh unë, nuk bëhet kiameti! Sos është piano e madhe e do bjerë në sy! Violina-violin! Me shokë. Kur i bien njëzet veta njëherësh, giu-viu-giu-viuuu, merret vesh i rashë keq unë apo i re ti!

Unë qesha. Ca tipave si Koçi as nuk u mërzi-  
tesh dot. Pale të marrësh përsipër t'u mbushësh  
mendjen se sa e shëmtuar është kjo lloj pune që  
janë zotuar ta mbarojnë. Nuk binden kollaj dhe  
të qepen më keq.

- Emrin, — i thashë për të mos e zgjatur më.
- Andon Ledhi.

Ja ku më doli për herë të dytë emri i tij.

— Pa prit, — thashë, — për këtë Andonin më  
ka folur Rushani.

Koçi e kapi fluturimthi.

— Ja, e sheh? Unë s'dua gjë. Të lutem, bëja  
nderin vëllait tënd! Po nuk ia bëre vëllait, haram  
qumështi, i themi ne! Ka më të afërt se vëllai?!  
Rushani i pari, Koçi i dyti.

U ngrita të ikja.

— Xha Ismeti si është? — pyeti Koçi për ba-  
banë.

— Mirë.

— E takova dje... I thashë ta merrja e ta shpija  
te doktor Kozmai që t'i bëjë një kontroll zemrës.  
Nuk deshi. Sikur do të harxhojë paratë! Ka një  
vetësiguri të tepruar ai xha Ismeti yt, po pleqë-  
risë nuk i dihet.

Më hipën nervat.

— Babanë mos ma ngacmoni! — i thashë. —  
Këtë djalin e doktorit do ta kemi kujdes e pikë!

\*     \*

Rushani i pari, Koçi i dyti... Pastaj nuk e mbaj mend radhën. Për Andon Ledhin më kapnin në rrugë, në institut, në bibliotekë. Më vinin letra. Nga afër e nga larg. Për Andonin punonin postierët e binin zilet, ajo e telefonit për njerëzit që ishin larg, ajo e portës për ata që ishin afër. Orë e pa orë më zgjonin, pasdreke e në mes të natës e më thoshin që duhej ta kisha kujdes Andon Ledhin!... Andon Ledhin!

Iku qetësia. Kur binte zilja e telefonit, unë nuk e ngrija më.

— Unë s'jam këtu, — i thosha Marikës, duke e ftuar atë që të ngrinte receptorin.

— As unë s'jam! — thosh Marika.

— Kur s'jeni ju të dy, unë s'jam e s'jam, — na e priste babai.

E ne vërtiteshim nëpër shtëpi, ndërsa zilja e telefonit vazhdonte e binte orë të tëra. Por ne as ziles së portës nuk i përgjigjeshim më. Fiknim edhe dritat e apartamentit e rrinim në errësirë, që vizitori të kujtonte se nuk ndodheshim aty. Nuk bënim zë fare. Veç herë pas here vinim gishtat mbi buzë dhe këshillonim njëri-tjetrin:

— Shhsht!...

— Tëmën, ç'u bëmë si në kohë të gjermanit!

— shfrynte babai. — Ç'bëhet këtu?! Po bombardojnë aleatët?!

Vërtet, gjendja u bë e padurueshme. Shefi i

strehimit, që s'para më përfillte kur i shkoja për punë të zgjerimit, tani kishte filluar të më buzë-qeshte. Një ditë, bile, më arriti në rrugë e më futi krahun.

— Duku nesër, — më tha. — Çështja jote po përparon. Do të të trajtojmë.

E falënderova me zjarr.

— Interesohem për një njeri timin, — tha, kur po ndaheshim, — Andon Ledhi quhet... Andon Le...

Vendosa që të nesërmen të mos i shkoja. Ishte e kotë. Pa mbaruar Andoni konkurrimin e sidomos pa fituar ai, nga ky shef unë nuk do të merrja zgjerim. Tani edhe unë duhej të prisja me shpresë që ai Andoni të ishte i zoti, të ishte virtuoz në instrument e të na imponohej si komision.

Me këto mendime u ktheva në shtëpi, po Marikën nuk e shqetësova. Ajo kishte shtruar drekën e po na priste.

— Babai ku është? — pyeta unë.

— Tani duhet të kthehet, — më shpjegoi ime shoqe. — E shpuri Koçi te një mik i tij për t'i bërë një kontroll zemrës.

Ja, kishin arritur ta bindnin plakun e gjorë! Aty për aty më erdhi ta zija supierën prej porcelani e ta përplasja përdhe.

— Babanë, moj grua! — iu çora asaj. — Po ma marrin më qafë! Po kjo poshtërsi kështu! Boboo! Të shkretin baba, ku ma futën ai Koçi yt me shokë!

Marika kapsalliste sytë.

— Nuk e kuptoj, ku e futën babanë? Ç'e gjeti?  
— pyeste ajo.

— Po ai nuk eshtë i sëmurë!

— Aq më mirë, more Muçi! Kur nuk eshtë,  
nuk eshtë. Mjekët nuk sëmurin, por shërojnë.

Por asgjë nuk më ngushëllonte mua.

— I mjeri baba! — thosha. — I mjeri baba!

Atë çast, im bir Artani, që s'po kuptonte se  
ku e kishim konfliktin ne prindërit e tij, me sy  
nga dritarja, bërtiti:

— Gjyshi!

Tej, matanë sheshit, pamë babanë. Ai po vi  
nte duke u çapitur ngadalë, por ne, që nga kati  
i pestë, nuk arrinim dot të lexonim rezultatin e  
vizitës. Tok me Marikën i zbritëm shkallët gati  
duke vrapuar. U poqëm me plakun në hyrje të  
pallatit. Unë vloja nga tèrbimi.

— Hë, baba, — e pyeta, — me siguri të nxori  
të sëmurë?

Babai na shkeli syrin dhe u përgjigj me krenari:

— Hiç fare! Bile tha se kam një zemër që du  
het të ma kenë zili jo pleqtë, por edhe moshat  
nga pesëdhjetë e poshtë!

Marika psherëtiu e lehtesar dhe më pa me  
inat.

— E sheh, — ma bëri në vesh, — se desh më  
përpive të gjallë!

Nisëm të ngjitnim shkallët të qiruar nga an  
kthi. Veç, për çudi, babai na mbetej prapa. Në  
çdo tri shkallë ai ndalej dhe bënte pushim.

— Baba, ndien lódhje?! Ti, që përditë i ngjit shkallët me vrap e dy nga dy, ç'ke tani?!

Babai buzëqeshte e fshinte djersët.

— I kam ngjitur ashtu se kam qenë budalla. Nuk kam moshë për ato akrobacira unë. Ku i dihet? Dhe atë apartamentin e ri, që do të marrësh, na e zgjidh nja dy-tri kate më poshtë.

Jo, jo, diç duhej të kish ndodhur aty tek ai specialisti i famshëm.

— Baba, thuaj të drejtën, ç'të tha mjeku? Mos po na fsheh gjë?

Babai mohonte. Duke u ngjitur e duke pushuar shkallë më shkallë, ai na tregoi se doktori kishte ngelur shumë i kënaqur nga vizita. Doktor Kozmai i kishte lënë babait përshtypjen e një njeriu të rrallë, sidomos nga sjellja e kujdesi për të sëmurët. Ai i qeraste të sëmurët e tij me kafe dhe i zbriste për krahu deri në fund të shkallëve të klinikës. Ai qe ndarë me babanë duke e përgëzuar edhe një herë për gjendjen e zemrës, për ta ruajtur këtë gjendje, e pati këshilluar që të pushonte shpesh, të mos bënte lëvizje të ngarkuara, t'u ruhej emocioneve të forta, të linte duhanin dhe të mbahej patjetër nën një kontroll të rreptë.

Pikë e zezë! Edhe kjo na duhej!...

Të gjitha këto këshilla babai pati kohë të na i tregonte ca nga ca, se na u desh plot gjysmë ore derisa u ngjitëm në shtëpinë tonë. Babai nuk deshi të hante, pasi nuk ndihej mirë me oreks dhe na kërkoi të falur se do të shtrihej ca që të pushonte.

U fut në dhomën e vet dhe pas pak thirri Mrikën. Ajo i vajti pranë dhe doli që nga dhoma e plakut për të marrë orën e saj mbi bufe.

Unë e hetova me sy. Ajo ishte bërë helm e pikë.

— Nuk e gjen dot pulsin, — tha ajo. — Doktori e ka porositur ta kontrollojë çdo dy orë...

Jo vetëm babai, por edhe ne të tjerët kishim filluar të mos ndiheshim mirë.

— Ti, Muçi, diç ke, — më thosh gruaja një mbrëmje. — Nuk ke qenë kaq nervoz më parë.

— Nuk kam absolutisht asgjë! — i thashë duke qeshur.

Ishim duke pirë në një bar-lulishte. Mbrëmja qe e bukur, qelli i pastër, i spërkatur me yje të ndritshme.

— Ti dhe natën në gjumi përpinqesh e gjemon.

— Gjëmoj?!

— Po, po, gjemon thellë.

Qesha me këtë përcaktim të padëgjuar dhe me buzën në gaz i bëra shenjë kamerierit të vinte që të shlyenim llogarinë.

Ai erdhi me buzagaz se unë.

— Janë të paguara, — më tha.

Unë e vështrova në sy, duke pandehur se ta llej.

— Po, po, vërtet janë të paguara. Ngrehuni dhe shkoni të qetë.

Po më merrej fryma.

— Kush të shkojë i qetë? — e pyeta dhe një herë.

— Ju, — tha ai, buzagaz si gjithnjë.

Gruaja më pa me frikë. Unë zieja i téri.

— Dëgjo, shok i dashur! Më bëj llogarinë! Dua të paguaj!

— Në asnjë mënyrë! — ma ktheu ai. — Unë i mora një herë paratë. Nga doktor Kozmai.

Unë u ngrita me rrëmbim. Shishet boshe të birrës u tundën e çokitën njëra-tjetrën.

— Ku është ai? — thashë dhe, pa pritur të ma dëftonte kamerieri, hodha sytë përreth.

Të gjithë hanin e pinin të qetë. Dukeshin të lumtur e të patronditur. Ua kisha zili qetësinë.

Kamerieri përkuli kokën dhe ashtu, i qeshur, iku me nxitim diku. Po dridhesha. Ndjeva llërën e freskët të gruas, që më shtrëngoi krahun.

— Muçi, eja! — më tha ajo ngadalë, duke u munduar të më hiqte që andej.

Ishte e padurueshme ajo ndjenjë, nxora paratë, bëra llogarinë me mend, e mbështolla kartëmonedhën fishek dhe e ngula në grykën e një shisheje të zbrazur.

— Ikim! — i thashë gruas.

Më shtiu hidhësinë në shpirt ky njeri. Më helmoi. Po më bënte mizantrop. Sapo shihja të më buzëqeshnin, tkurresha. Dhe ndonjë shërbim që më bëhej, ashtu siç ia bëjmë njëri-tjetrit përditë, me shpirt të pastër, tanë e prisja me një lloj frike. Nuk falënderoja por prisja a do të më

kérkonin tē ndihmoja nē konkurs atë, Andonin.

Një ditë dikush më liroi vendin nē autobusin urban. Unë nuk u ula, por e pashë nē sy.

— Uluni, — përsëriti ai me mirësjellje.

— Hë, — i thashë, duke tundur kokën, — keni ndonjë kérkesë pér tē më bërë?

Bashkudhëtari u habit.

— Asnjë kérkesë, — tha si pa tē keq. — Ju më dukeni i lodhur e pikë. Thashë t'jua liroj vendin. Aq më tepër që unë do tē zbres nē stacionin tjeter.

Ja ç'telashe po më sillte puna e këtij Andonit! Kush ishte ky Andon? Si ishte? E përfytyroja tē shkurtër, flokëzi, me sy gjysmë tē mbyllur, dhel-parak... Duart duhej t'i kishte tē mëdha e krahët leshatorë.

Kisha nevojë tē çlodhesha nga kjo fushatë fantastike që kish hapur i ati i tij, pér tē fituar votën time. Nuk më pëlqente aq deti, sa më pëlqente shkëputja, largimi e qetësia pér ca kohë.

Pér konkursin kishte ende kohë, prandaj do tē bëja mirë tē dëgjoja gruan e tē shkoja me fëmijët nē plazh, larg Koçit e Rushanit. Larg Andonit!...

Në vargun e kabinave tē plazhit Kozmai kishte dy tē njobur. Njëri ma përmendi çështjen e tij ditën e pestë, tjetri tē shtatën. Të parin e

kisha në të majtë, ngjitur, tjetrin, tri kabina më tej, në të djathtë.

Ata kishin qenë vërtet të pamëshirshëm. Ma kujtonin violinistin Andon nga tri-katër herë në ditë, kur shtriheshim nën çadra, kur u blinim akullore fëmijëve, kur luanim «pesëkatëshin», ku shpesh ma linin në dorë derrin-maç, që më dukej si fotografi e Andon Ledhit, me sytë gjysmë të mbyllur e me llërët e zeza leshtore.

Aq e padurueshme ishte kjo për mua, saqë shpesh ndahesha nga fqinjët e mi, pa i ftuar futesha në det, duke u munduar të lahesha sa më larg tyre. Por ata nuk më ndaheshin e, si dy kacatorpedinierë, që shoqërojnë kryqëzorin, më vinin nga të dyja anët — njëri me krol e tjetri me shpinë.

— I ati i Andonit, Kozmai, ka punuar në spital, tok me kunatin tim, — nisi njëherë njëri syresh, ndërsa notonim drejt bregut, të lodhur nga deti.

— I ati i Andonit...

Nuk durova më.

— Ju lutem, — i thashë, — mjaft më! Durimi ka një kufi. Unë kaq e kam kufirin. Ja ku po jua them sot: atë të atin e Andonit eurrej. Bile dhe Andonin eurrej. I thoni të mos më dalë përparrë, se do të bëj ndonjë të pabërë. Dhe ju më lini rehat! Dëgjuat? Më lini rehat!

Dhe një t'u kthyer vërtik e ia mbajta tej, nga thellësia. Nervozizmi ua shtoi gjallërinë krahëve të mi të lodhur dhe unë çaja e çaja valëzat e leh-

ta, duke iu larguar dy shokëve që më bezdisnin. Pastaj ngrita kokën e, si pashë që ata po dilnin në rërë, bëra të kthehesha. Këtu më lanë fuqitë dhe ula këmbët të çlodhesha. Piva ujë. U kollita dhe u zhyta nja tri herë, dhe kjo punë do të kishte mbaruar ters, po të mos kalonte andej motoskafi i ndihmës së shpejtë, që, si dukej, e kishte pikasur që larg se ç'lloj notari isha.

U kacavara në të e me muskuj të stërholluar u ngjita lart.

— Desh u mbyta, — thashë duke gulçuar. — Më lanë fuqitë.

— Të vura re, — ma ktheu piloti i motoskafit, një burrë i thinjur, me një kanotierë të bardhë, që dukej pak e ngushtë për krahët e tij të shëndetshëm.

— Piva ca ujë... Të falem nderit!

— S'ka gjë, s'ka gjë, — dhe piloti më vështron te ngrohtë e me simpati. — Ju merreni me muzikë?

— Po, — ia ktheva, e... e... e... pastaj?

— Kam dhe unë një djalë...

«Babai i Andonit, — thashë dhe me një të ngritur e bëlldum prapë në det. — Në djall motoskafi! Nuk e dua!»

Po plakushi më zuri nga thembra e këmbës dhe më ngjiti përsëri në bord. Dukej tepër i nxehur.

— Mos luajte mendsh? Eh, ç'pate?!

— S'kam më nevojë, — ia ktheva.

— Po nuk të lë unë, — bërtiti thinjoshi i fu-

qishëm. — Pa më thuaj njëherë, ç'pate? Ç'të bëra? Ç'të thashë?

Unë ula kokën. Ai i dha gaz motorit pa më thënë asnje fjalë.

— Ju mos ju quajnë Kozma? — e pyeta me druajtje.

— E pse duhet të më quajnë Kozma? Phë, çfarë pyetje!

Unë u lirova.

— Ç'deshët të më thoshit për djalin?

Fytyra e tij u zbut, pastaj u bë e menduar.

— Më doli nga mendja tani. Se ti desh më ike nga duart... S'më kujtohet.

— Për djalin... për muzikën...

— Ah, po! — u kujtua detari. — Kam një djalë që dontë të futej në shkollë për muzikë. I binte pianos. Pyeta mirë e mirë. Ata që kishin haber nga kjo punë, domosdo. Ata mblidhnin supet. «Çka, — thanë, — edhe shtyhet.» Aha! Me të shtyrë s'e lashë unë. Sa të hiqet zvarrë e të ketë zili shokët e talentuar, më mirë një zanat tjeter dhe pianos le t'i bjerë për qejf... S'e lashë. Qau ca, por ama gjeti vendin e vet. — Plaku dukej i kënaqur. — Kam djalë të mirë, — tha dhe geshi.

Unë e preka lehtë në gju. Me drojë. Me respekt. Me dashuri.

172

Kutia e postës në portën e apartamentit ishte e mbushur dëng me letra e gazeta të grumbulluara në dy javët e mungesës sonë.

I ndamë letrat e mira nga të ligat. Të ligat, kuptohet, në një cep a në krye të rreshtit mbanin emrin e njojur, emrin që përmendja në gjumë. Unë i prisja ato. Ditët e konkurrimit po afronin.

Secili nga ne bëri planin e punës që e priste. Artani do të griste pusullat e bezdissime. Babai do të shkonte në poliklinikë për një kontroll pas periudhës që kishte kaluar rrëptësisht nën tendën e kabinës së plazhit dhe Marika do t'ë pastronte shtëpinë nga pluhurat. Unë duhej të paraqitesha urgjent në mbledhjen e komisionit të pranimit të studentëve për konservator dhe pastaj menjëherë në zyrën e strehimit në lagje. Midis letrave Marika kishte gjetur një shënim të shefit të strehimit dhe ngulte këmbë që të shkoja më parë atje. Por unë nuk u paraqita për strehimin, veçse pas mbledhjes që bëmë në Drejtorinë e Muzikës në ministri. Aty shoku Vasil na njoftoi (atë që Rushani ma pati njoftuar një muaj e ca më parë) se ne do të përbëним jurinë pranuese. Unë isha caktuar kryetar i jurisë së harqeve. (Pikë për pikë siç ma kishte komunikuar Rushani.) Vasili na paralajmëroi të ishim të përgatitur për presionet që do të kishim

dhe për kujdesin që do të bënim në mënyrë që  
në konservator të hynin vetëm ata që e merito-  
nin. Ku ta dinte Vasili i gjorë se ç'kisha hequr  
unë tërë atë muaj! Doja njëherë t'i qaja hallin,  
po në fund të fundit nuk kishte ndodhur asgjë:  
Furtuna pati shpérthyer e unë do të vazhdoja  
ta përballoja. Veç kësaj, nuk doja ta zgjatja më  
këtë mbledhje. Më prisnin në zyrën e strehimit.

Shefi më priti krahëhapur.

— Je në projekt! — më tha menjëherë, pasi  
më uli. — Dhe kjo është një gjë e madhe, apo  
jo?

E falënderova duke ia shtrënguar dorën me  
të dyja të miat.

— A të pëlqejnë pallatet e reja në Rrugën e  
Postës?

Unë nuk flisja dot nga mirënjojja, që më  
kish lidhur fort gjoksin dhe gjuhën.

— Por, ama, të kuptohemi, se mos ti e quan  
punë të përfunduar!

Këtu u ftoha i téri.

— Ky është vetëm projekt, — tha goja e she-  
fit, — ... «që do të realizohet veç po të fitojë ai  
violinisti që të kam thënë», — thoshin sytë e tij.

Unë e vështroja pa folur.

— Shpresojmë t'ia dalim mbanë, — tha përsëri  
goja e shefit.

«Ju duhet ta pranonit atë Andonin», më kuj-  
tonin sytë e tij.

— Do të takohemi përsëri, — tha goja. —  
«... pas konkurrimit», plotësonin sytë.

Dufin e zbraza në shtëpi. Ata prisnin lajmin e madh, kurse unë u vajta i ngrysur si kohë më shi.

— Nuk dua zgjerim! Nuk e dua nderin e tij! Nuk e dua! — i bërtitja Marikës. — Dhe mos kujtojë ai burokriti se ka në dorë fatin tim! — Dhe sillesha vërdallë nëpër shtëpi. Babai, Marika dhe Artani më ndiqnin me sy të trembur. — Është ajo rrugica e tij me dredha... por ka dhe një rrugë tjetër të madhe, me dritë, që të shpie në shtëpinë e re! Memuri! Bravaxhiu! Mos më kujton ai ndonjë këpucëlëpirës?! Jam artist unë!

— Muçi! — rrihte të më qetësonte Marika.

— Bobo, më iku djali! — ia bënte babai, me dorën në zemër.

— Babi, të lutem, qetësohu! — më përgjërohej djali.

Por unë nuk përbahesha. Duhej të isha zbrazur në sy të shefit, por, e pranoj se, për dreq, jam ca i butë, e nuk kam shpretkë për skandale. Prandaj i bërtitja Marikës:

— Ç'bëhet, xhanëm?! «Aman na fut në orkestrë një kallp, që e ka veshin shollë opingel!» «Aman, na bëj matematikan një mendjefyell që dyedyja i del pesë!» «Na bëj doktor një nallban!» «Aman, na e nxirr aktor këtë gagaçin!»... A do ta pengojmë këtë palopunë, apo do të rrimë duarkryq?

U desh gjysmë ore që të më kalonte tèrbimi. Marika m'u ul afër.

— Të drejta i ke të tëra, Muçi, por, kur me-

ndon se puna e shtëpisë mund të zgjatet, bëje një së myllur për atë Andonin...

— Më lër, Marika, me gjithë Andon tan! Ku dreqin vanë e më çaktuan në juri! Më nxinë ditët! Më sëmurën babanë!...

Babai më qetësonte nga ana e vet:

— S'kanë faj ata, Muço! Unë paskam qenë i sëmurë vërtet, po nuk e kisha ditur!

Marika më hodhi dorën në qafë.

— Mështy kemi qenë e jemi, Muçi, po tan, ti e shesh... Bëje përnë, për qetësinë tënde, për plakun e sëmurë! Se mos do ta pranosh në orkestrën tënde! Ky të jetë i pari dhe i fundit!

E tërë familja shikonte me shpresë nga unë. U dorëzova.

— Në dreq të vejë! — thashë dhe, kokulur, i dërrmuar, u nisa drejt dhomës së gjumit. Përplasa derën pas vetes dhe u plandosa mbi krevat. Kozma Ledhi kishte fituar.

Në këtë mendim, tërbimi m'u kthye përsëri. Një t'u ngritur vrik nga krevati dhe ia beha prapë në kuzhinë.

— Jo! — ia bëra me ashk. — Jo, jo e jo! Kaq ta bëjnë dhëmbin, nuk u hap udhë! Le t'u hapin të tjerët!

Dhe u sula të vishja këpucët.

— Që të jem i qetë, do të shkoj te shku Vasil. Do t'i them, të paktën të caktojë kryetar ju rie ndonjë tjetër.

Marika me babanë më ndoqën të më kthenin, por nuk më zunë dot.

Vasili po zbriste shkallët e ministrisë.

— Në Institutin e Arteve po shkoj, — më tha duke më futur krahun e duke më marrë me vete drejt veturës që po e priste. — Po nuk pate ndonjë kundërshtim, shkojmë bashkë dhe e konsumojmë bisedën rrugës. — U futëm në makinë. — Në fakt, dhe unë kisha diçka me ty, — më tha Vasili pasi u rehatuam në ndenjësen e pasme. Unë e prita që të vazhdonte. — Kemi të dhëna se njerëzit e interesuar punojnë në rrugë të tertiorta. Stop këtyre! Një stop të madh, bile!... Aty duhet të gjejnë vend vetëm të talentuarit... Ja, p.sh., flitet shumë për një talent të vërtetë, njëfarë Andon Ledhi... Eh, ke dëgjuar?

Unë tunda kokën.

— Ai vërtet duhet të jetë shumë i talentuar, shoku Vasil!

Vasili u gjallërua.

— Eh? E ke parë?

— Jo, po flasin shumë. — Dhe i vura dorën në sup shoferit. — Mbaje. Do të zgres. Zbrita dhe nisa të ecja në këmbë. Vetura më arriti dhe Vasili nxori kokën nga xhami.

— Ti sikur kishe për të më thënë diçka, — u kujtua ai.

— Asgjë, — e qetësova. — Ja, për këtë Ledhin e kisha.

— Ashtu?! Aq më mirë. Nesër fillon konkursi?

— Nesër.

— Dalshi faqebardhë! — tha Vasili dhe vetura e shtoi shpejtësinë.

Ndieja një lehtësim të çuditshëm. Vasili i pati dhënë fund lëkundjes sime. Mora frymël thellë dhe vazhdova rrugën.

Fundi i historisë me Andonin tani...

Ai u paraqit përpara komisionit që ditën e parë. Iшин provuar shtatë veta para tij. Sekretaria qëroi zërin dhe lajmëroi:

— Andon Ledhi!

Ngrita kokën dhe ngula vështrimin te dera. Ja, tani do të hynte ai. Hyri. Ishte një djalë i hollë, biond, me sy të mëdhenj bojë qielli, me një pamje naive, me një buzëqeshje të druajtur.

Domethënë ky ishte Andoni. Ai Andoni i famshëm. Ç'kisha hequr unë përtë!

Ai u përqendrua dhe ngriti harkun. Unë ia ngula sytë. Vetëm me sy e vndiqja Andonin. Veshët nuk më punonin më. E shikoja dhe më vinte inat që nuk ishte ashtu, leshtor, si e pata përfytyruar. Harkun e lëvizte me shkathtësi dhe elegancë, por unë nuk dëgjoja asnje tingull violine. Vetëm shikoja. Mbi harkun e tij kishin hipur e po rrinin në gjunjë, me duar të zgjatura nga komisioni, tërë miqtë e tij: im vëlla, Rushani, kamerier Kogi, shefi i strehimit, shoku Vasil dhe fqinjët e mi të plazhit, me rroba banje. Binin që të dyja zilet: e telefonit dhe e portës. Trokitnin

postierët. Të gjithë më pengonin ta dëgjoja e ta vlerësoja si duhej.

Pashë që djaloshi mbaroi ekzekutimin dhe na buzëqeshi me turp.

— Jeni i lirë, — i thashë unë si kryetar.

Andoni përshëndeti e doli.

Kur votuam për të, ndodhi diçka e çuditshme.

U krijua një gjendje barazie. Katër anëtarë ishin për pranimin e tij e katër jo. Nuk kishim votuar unë dhe Llazari, prandaj votat tona vendimtare priteshin me interesim.

— I pakalueshëm, — tha Llazari, pasi uli kokën dhe u mendua pak. — Le të përgatitet përsëri vitin tjetër. Ta dëgjojmë edhe një herë pas një viti. I pakalueshëm! — përsëriti me një pikëllim të pashpjegueshëm!

— Ashtu them dhe unë, — ia bëra unë më duf, — i pakalueshëm.

Mbaroi kjo punë. Andon Ledhi nuk e fitoi konkursin.

\*

\*

\*

Po kthehetëm në shtëpi tok me Llazarin. Që të dy ecnim të menduar.

— Ai Ledhi nuk ishte keq, — tha Llazari.

— Nuk e kam idenë, — thashë hapur. — Nuk e dëgjova.

— Ai ishte përgatitur kënaqshëm.

— Po atëherë, — e pyeta, — përse nuk ia dhe pëlqimin?

Ai shfryu e nuk foli.

— Le të vijë vitin tjetër, — tha pastaj. — Me siguri do të fitojë. Humbi një vit. Për fajin e tij. Mbase vë mend. — Dhe befas e ndali hapin. — Dëgjo, Muço, — më tha. — Ti ke qenë rehat e nuk ma kuption dot gjendjen time. Ky Andoni me të atin më torturuan një muaj plot, duke më futur njerëz. Ti as e merr dot me mend se q'bezdi është! Ja, tani, një vit do të më brejë ndërgjegjja. Pthtu! Ta marrë dreqi! Vetë e kanë fajin! Hm!

1981-1987

## Motive plegërishte

Natë. Vonë. Mund të jetë ora dy. Mbështetje dhe tre. Xhezoja vendos të zgjojë të shoqen, që po fle për shtatë palë qejfe.

— Reso!... Resmie!

Resmia vazhdon të flejë. Gërrhet dhe fle.

— Reso! Resmie, moj! — e ngre më tej zërin plaku.

Resmia zgjohet e trembur.

— Hë! — Dhe ngrihet. — Xhezo, ç'ke? Ç'ka ndodhur? Ke gjë? Si je?

Sytë e gruas çakarriten me llahtarë.

— Shtrihu, moj, shtrihu, — e qetëson i shoqi!

— Shtrihu, se s'ka gjë!

— Jo po ti se ç'ke. E zeza unë!

Xhezoja e zë për krahu,

— Shtri-hu!

Gruaja e vë kokën në jastëk me fytyrë nga i shoqi.

— Si është puna?!

Xhezoja e ujdis mbulesën.

— Ja, desha tē tē pyes diçka: Mban inend ti, si ia quajnë djalin Veledinit, farmacistit?

Resmia është akoma e alarmuar.

— Ka vdekur? Ç'i ndodhi?

— Asgjë, moj, nuk i ka ndodhur. Ai me siguri tani fle pér bukuri. Po unë desha ta dija se si e quajnë. S'po e sjell dot në mend.

— E ç't'u kujtua i biri i Veledinit?

— Po ku di unë nga vajti e m'u kujtua! — pështyn Xhezoja. — Që ia dhjefsha témën! M'u kujtua Veledini e s'po i gjeja dot emrin tē birit. Mirëpo në gojë e kam e hë ta gjej... U bënë tri orë e gjysmë fiks! Hë ta gjej e hë ta gjej! S'më zë gjumi. Thuaje!

— Gaz...

— Hë, Gazmend! — ia merr nga goja së shoqes Xhezoja. — Pthtu, tē marrtë lumi, more Gazmend!

Dhe plaku futet dalëngadalë nën jorgan. Mbulohet duke turfulluar.

— Ç'fat i ndyrë! Vete e më fanitet në tru emri i tē birit tē Veledinit. Se pak halle ka truri im... Hm, tamam Gazmend!... Plaç, more Gazmend!

Dhe plaku psherëtin i kënaqur. Pas dy minutash e zë gjumi e në tëndërr sheh një lumë... në vapë... kur qe i ri... lanin kuajt!

1984

## *Aksidenti*

Makina u përbys më mes të ditës, në një rrugë të gjerë fushore pa asnjë kthesë. Pertefi ishte shumë i sigurt që pas dy orësh, e shumta tri, do të vdiste e megjithatë habitej se ç'mendime idiote paskëshin njerëzit para se të ndërronin jetë. Ai habitej se si mund t'i vërtitej në tru një mendim kaq i padenjë për një pragvdekje, një mendim kaq i parëndësishëm e banal siç ishte futbolli. Solli nëpër mend që atë ditë ishte e premte. Të dielën skuadra e tij do të ndeshej me «Partizanin» dhe këtë Pertefi mezi e kishte pritur... Por ja, nuk do ta shihte. Pas një muaji fillonte Kampionati Botëror. As atë nuk do ta shihte.

Në këto çaste nuk kishte asnjë dhembje. Mbasse goditja, mbasse mpirja e hutimi... Mbasse arrin një gjendje kur nervat nuk përcjellin asgjë e dhembja zhvlerësohet përpara mynxyrës që po troket. Ai ndiente sirenën e alarmit të makinës me

të cilën po e shpinin në spital dhe kjo ishte e vjetmja dhembje që i godiste veshët. E hoqi mendjen nga skuadra e futbollit dhe e shpuri tek e shoqja.

Ai nuk e kishte parë asnjëherë me të zeza Dianën... Po Tori? Tori i vogël nuk do ta shihte më të atin... Pertefi ishte i bindur se vdekja e tij do ta lidhte edhe më shumë Torin me mamanë. Diana me siguri nuk do të martohej. Me siguri. Me siguri! Por... ku i dihej? Po sikur të martohej? Eh?... Me kë do të martohej vallë? Në mjegullnajën e çasteve të fundit ai nuk formonte dot një fytyrë për burrin e ardhshëm të së shqes... Nuk e dinte cili do të qe ai dhe Pertefi ishte i pafuqishëm që ta urrente. Dhe i shpëtuan lotët.

— Po qan, — tha me pëshpërimë njëri nga ata që u gjendën në vendin e aksidentit e që tanë po e shoqeronin për në spital. — E çuditshme! Pa ndjenja dhe qan!

— Unë kam parë shumë të vdekur që qajnë, — ia ktheu dikush aty. — Gjëndrat e lotëve funksionojnë edhe më pas. Kështu ndodh edhe me mjekrën, i zoti vdes, por ajo vazhdon të rritet.

— Unë për herë të parë shoh nga afër një të vdekur, — tha përsëri i pari. Tjetri nuk foli, por u përkul mbi fatkeqin. Pertefi ndjeu peshën e kokës së tij në gjoks.

— Nuk ka vdekur akoma. Zemra i rreh normalisht, megjithëse ka humbur shumë gjak.

Gjaku e trembte dhe Pertefin. «Po Xhelaja ku  
është? — mendoi. — Po më shoqëron apo ka  
mbetur te vendi ku ndodhi hataja? Ai, gomari,  
me siguri ruan materialet e furnizimit.»

Dhe Xhelaja ishte fajtori. Po Pertefi nuk do  
ta pikte më, që ta pështynte në surrat për atë  
dreq gazetë, e cila ishte bërë shkak... Xhelaja  
me siguri do të vinte në varrim, po sa pará bë-  
nte... Nuk do të ishte vendi. Le që Pertefi do  
të ishte i vdekur dhe i mbyllur nga të katër anët.

— Ah, Xhelo, Xhelo! — murmuriti dhe e ndie-  
nte që duhej ta falte shokun. Të vdekurit janë  
shpirtmëdhenj. Ata hyjnë në një dimension tje-  
tër dhe nuk merren me vogëlsira.

Pertefi ishte i bindur se varrimi do të bëhej  
të nesërmen. Sot ishte e pamundur. Përgatitjet  
nuk bëheshin dot aq kollaj. Pastaj kishin edhe  
njerëz larg e duheshin thirrur që të gjithë. Po  
hajd ta përbledhësh në të tilla befasira! «Ç'do  
të harrojnë ndonjë e do të na turpërojnë!» —  
mendoi me një pikëllim të pafuqishëm.

Shoqëruesit diç folën përsëri dhe atëherë Pertefi  
ndjeu zërin e Xhelos që paskësh qenë aty.

— Pushoni, more shokë! Pushoni! Ore, neve  
na ka gjetur hataja, kurse ju... Si nuk mendoni?!  
Djalë i ri, more, që ç'të thuash!... Ah, moj vdek-  
je! Ah, po nuk mban radhë, kjo e shkretë, or,  
jo!

Xhelaja po qante.

— Ju jeni shoferi? — e pyetën.

— Jo, jo, unë jam furnitori. Shoferi është ky i ziu, — sqaroi Xhelaja.

— Kishte pirë?

— Nuk e di. Ky thoshte jo, po ec e zëri besë!

«Është qelbanik! Dyshon», mendoi Pertefi i pafuqishëm dhe u vu të sillte ndër mënd sa kohë kishte pa pirë. Të dielën mbusheshin dy javë.

— Ndodhi sa hap e mbyll sytë... U furnizuam në magazinat e Durrësit. Kishim për të marrë tutkall, tela bakri, bojëra... Në Kavajë qëndruam e morëm gozhdë... — nisi e po rrëfente Xhelaja.

— Ecnit me shpejtësi?

— Kam frikë se po. Policia Rrugore do të bëjë matjet, po kam frikë se po.

Pertefi u kujtua se pati marrë disa vërejtje të forta për shpejtësi, po tani nuk do të kishte më punë me policinë. Ja, së paku, vdekja do t'ia kursente këto formalitete.

— Unë po lexoja gazeten «Sporti», — vazhdoi Xhelaja. — Ky, me sa duket, kishte zili dhe e shtonte shpejtësinë, që të kishte dridhje e unë të mos lexoja dot... Por unë nuk hoqa dorë. Ky, herë pas here, i hidhte nga një sy fakes që lexoja unë. Kur po shihja klasifikimin, ky u zgjat nga unë e u gjendëm të dy në kanal. Unë, shëndoshë e mirë, ama i mbuluar nga gozhdët e nga tutkalli. Na ishte çarë një thes... Ky, siç e shini...

— Ju paskeni shpëtuar për mrekulli.

— Me ca të gërvishtura e një goditje në bri-

një. Ja, tani mezi marr frymë... Po këto janë vogëlsira kur mendon se... tjetri e pagoi me jetën.

Sirena e makinës që shpinte të aksidentuarin në spital, të shurdhonte. Me siguri po hynte në qytet, se boritë e makinave që vinin përkundruall ishin më të shpeshta.

— Ishte djalë i mrekullueshëm! — psherëtiu Xheloxja.

Kjo ia zbuti zemërimin Pertefit.

— Xhelo, — murmuriti ai, — Xhelo!

— Po të thërret! — tha njëri nga shoqëruesit që mundi ta dëgjonte. Në zërin e tij ndiheshin nota gjëzimi, shprese. — Afrohu!

Xheloxja afroi veshin te buza e të plagosurit.

— Dianën... — tha Pertefi me zë të ngjirur,  
— Dianën, mos e lini të hyjë në spital... Le të  
më mbajë mend ashtu...

Shoku nxori shaminë dhe mbyti ngashërimin.

— Xhelo! — vazhdoi të shpenzonte frymë Per-  
tefi. Ndofta këto ishin energjitet e fundit. — Dia...  
nës...

Dhe nuk fliste dot më. Xheloxja u llahtarisi.

— Po e marrtë dreqi këtë karrakatinën tuaj!  
— ulériu. — Nuk ecën dot më shpejt kjo?! — Dhe  
furnitori nisi ta qëllonte kabinën me grushte.

— Shpejt! Shpejt! — i thanë shokët shoferit,  
që nxori kokën.

Pertefit i erdhën përsëri fuqitë.

Dianës... i thuaj se e kam dashur shumë...  
Po të vdiste ajo, unë... nuk... Diana!... Dia... na!

— Ç'hotë? — e pyetën Xhelon.

— Të shoqen... s'e heq nga goja! — tha duke qarë Xhelojë dhe me të dyja duart ngjishte shaminë mbi hundën dhe mbi sytë e tij. Iu afroa përsëri shokut që po jepte shpirt, por ai, derisa mbërritën në spital, nuk e hapi më gojën.

Në spital çdo gjë u përgatit me shpejtësi rrufeje. Vigu i priste te shkallët. Kërcitnin dyert, vraponin infermieret. Dikush jepte udhëzime të prera, të shpejta dhe autoritare.

— Shpejt, sallën e operacionit!

— Ndihamoni doktor Skënderin!

Xhelojë rrëmbeu i vetëm njërën anë të vigut. Dhembja në brinjë, nga pesha e shokut të plagosur, iu bë edhe më e mprehtë, por ai nuk pyeste më. Infermieret që mbanin anën tjetër të vigut, bënin përpara, më shumë të shtyra nga ky buall i fuqishëm se nga hapat e veta.

— Mos e tronditni! Se mos i provokoni ndonjë hemorragji të re. Ai enët e gjakut i ka të hapura.

— S'besoj të ketë më gjak për të nxjerrë ky!

— Oksigjeni është gati!

Pertefi i dëgjonte të gjitha dhe u rrëmbush nga mirënjojja e madhe. Kujdesi që tregonin përtë, e prekte pa masë. Ai kishte dëshirë që t'i shikonte ata që po luftonin për jetën e tij, t'u shikonte fytyrat e dashura, fytyrat e fundit para se të zhytej në atë paloerrësirë që e priste. Por nuk mund t'i hapte sytë. Një gjak i trashë, si pelte, ia kishte pllakosur kapakët dhe, me sa dukej, i kishte ngrirë në gropat e syve.

Karrocëzën e shtynë me shpejtësi nëpër një korridor, e kthyen majtas e djathjas, pastaj e futën në sallën e operacionit, të cilën Pertefi e ndjeu me të vetmen flegër të hundës që i kishte mbetur e lirë.

Dera e sallës u mbyll dhe Xheloxa mbeti aty në korridor, i vetmuar. U ul në bisht, mbështeti kurrizin pas murit të patinuar dhe mbuloi ftyrën me shaminë që i ishte bërë qull prej kohësh. Nuk i kujtohej fare se si erdhën infermieret, e morën, i mjekuan gjërvishtjet, i bënë dhe atij, sipas rregullit, një radiografi aty ku ndiente dhembje. Mendjen e kishte në sallën e operacionit dhe këmbët e shpunë përsëri aty.

Te dera nuk po u besonte veshëve: në sallën e operacionit dëgjoi të qeshura! A thua qeshin vërtet? Nuk ishte çudi. Ajo që neve na duket e llahtarshme, për njerëzit e profesionit është normale, e përditshme. Por dyshimet iu hoqën menjëherë, sa pa doktor Skënderin, që doli duke hequr gojëzën e bardhë.

— Doktor, ka shpresa? — iu vërsul përballë Xheloxa.

— Shumë bile! — tha mjeku. — Ai shoku yt s'ka asgjë. Asnjë goditje. Asnjë plagë. As edhe një gjërvishtje. Është llangosur me një bojë të kuqe. Kishit bojë në makinë?

— Një kuintal e gjysmë! — tha Xheloxa. — Zmalto!

— Ja, do të jetë çarëndonjë kuti nga ato. Përpinquni të gjeni pak benzinë.

Xhelaja e gjeti Pertefin në këmbë, mu në mes të parasallës.

Lëvizte për të shpirë këmbët, ndërsa infermieret e ndiqnin me sy të qeshur.

— Na ngrive gjakun, more malukat! — ia bëri Xhelaja dhe u hodh ta përqafonte.

— Ju ngriva gjakun unë, apo ma ngritë ju?! — e shtyu shoku, që mezi kishte pritur të shfrynte. — Ik, ore, se ne çmendët! Ju pshursha ato sirenat e fenerët e ndezur! Jo «vdiq», jo «mbroi»... Jo «ta shpiem me frymë»... E po, thashë unë, këta e dinë më mirë. Na turpëruat!...

Xhelaja qante dhe qeshte nga lumturia e madhe. Pertefi, që duhej të ishte më i lumtur, nuk qeshte aspak. Tani për të mbetej përpara Policia Rrugore dhe drejtoria e ndërmarrjes.

Dhe ashtu po dilnin nga spitali. Xhelaja, i lehtësuar, që gati të fluturonte me ata lot gëzimi ende të patharë; Pertefi, i turpëruar, duke sharë nëpër dhëmbë.

Te shkallët i ktheu një infermieri që mbante në dorë një format ende të lagur të radiografisë.

— Hej, shok, — i tha Xhelos. — Ju do t'ju mbajmë. Keni katër brinjë të thyera. Ja! — Dhe i zgjati radiografinë.

Xhelaja u zbeh. Bëri të mbahej, por u këput i téri.

Vigu doli përsëri. Ishte po ai vig që Xhelaja, para gjysmë ore e pati mbajtur peshë dhe e pati

shtyrë si i marrë. Por ato çaste ai s'dinte gjendjen e brinjëve të veta.

Pacientin e posazbular e shtrinë dhe Pertefi ia ktheu aty për aty borxhin shokut, që qe zverdhur e mezi merrte frymë. I jepte kurajë dhe e shante:

— Bëhu burrë!... Hajvan! Se ti na e bërë këtë përslesh!

1987



P E R M B A J T J A

Këshilla për fëmijët e moshave 5 deri 55 vjeç .....	3
Lyerja e stolave në park .....	7
Nga blloku i shënimeve .....	23
Pyetjet .....	27
Ditë që kujtoj e ditë që harroj .....	31
Po ato që thamë dje?! .....	45
Një kërkesë e zjarrtë .....	53
Alma rrjedh nga majmuni .....	63
Mbi shilarësin e fantazisë .....	66
Futboll, futboll! .....	77
Endje nëpër arat e të tjerëve .....	82
Ulja e hundës .....	90
Prindër në provë .....	100
Sëmundja e palloit .....	104
Manual për drejtore teatrorsh .....	112
Nuk të njohim, o kryetar .....	116
A ta pranoj humbjen? .....	122
Diçka e rëndësishme .....	126

Një variant i papërdorur .....	135
Shënimë të tjera nga blloku .....	138
Përfaqësimania .....	141
Bërtitje në trekëndësh .....	147
Dy vajza na presin rrugën .....	152
Telat për violinë .....	157
Motive pleqërishte .....	184
Aksidenti .....	183

Kulla, P.

Këshilla për fëmijë nga 5-55 vjeç.  
Tregime e skica. [Red.: V. Koreshi]. T.,  
«Naim Frashëri», 1988.

196 f.

(B.m.): dhe

(B.v.): 891.983-32

+ 891.983-4

K 98

Tirazhi 4000 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re  
Tiranë 1988